REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. Rregj. Them 4991 Nr. Vendimi 44
Datë regjistrimi 17.05.2022
Datë ri-shortimi 03.02.2023

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e përbërë prej

KRYESUESE - ELONA MIHALI
ANËTAR - ASTRIT KALAJA
ANËTARE - IRIDA KACERJA

më datë 03.03.2023 ora 11:15 përfundoi shqyrtimin në seancë gjyqësore të çështjes civile që i përket:

Kërkues: **Partia Demokratike e Shqipërisë**, e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, me adresë Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 11. Tiranë, përfaqesuar me "Autorizim" nr. 01 prot date 13.12.2021 nga av. Ivi Kaso, znj. Ledina Mandia dhe z. Oerd Bylykbashi

Objekti: Depozitim ndryshimesh statutore dhe vendimarrje të Kuvendit Kombëtar.

Baza Ligjore: Neni 9 e vijues të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 (i ndryshuar).

Rregjistruar çështja në apel mbi ankimin me:

Ankues: **Partia Demokratike të Shqipërisë**, përfaqësuar nga nënkryetari i

Partisë z. Enkelejd Alibeaj pajisur me autorizimin e kryetarit të partisë të datës 15.09.2021, përfaqësuar nga av. Rezart Kthupi dhe av. Indrit Sefa në bazë të akteve "Autorizim" nr. 15 prot, datë 01.02.2022 të Kryetarit të partisë dhe "Prokurë e Posaçme" nr. 772 rep, nr. 376 kol, datë 25.02.2023 të lëshuar nga z. Enkelejd Alibeaj

Objekt ankimi: Prishjen e Vendimit nr. 1346/222 Akti, nr. 3 Vendimi, i datës 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pushimin e gjykimit ose kthimin e çështjes për shqyrtim në të njëjtën gjykatë, por me tjetër trupë gjykuese.

Vëren se:

I. Rrethanat e faktit dhe procedura

Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën me objektin dhe bazën ligjore si më sipër cituar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përfundim të shqyrtimit të kërkesës me vendimin nr. 3 datë 25.03.2022 ka vendosur:

- *"Pranimin e kërkesës së palës kërkuese Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të P.D.SH.*
- *Depozitimin e vendimeve të Kuvendit Kombëtar të PDSH duke regjistruar ndryshimet përkatëse në regjistrin e partive politike:*
  - *Vendimin nr 1. dt.11.12.2021, me anekset bashkëlidhur Statutin e Partisë Demokratike, të Kuvendit Kombëtar të Partisë.*
  - *Vendimin nr 2. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.*
  - *Vendimin nr 3. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike*
  - *Vendimin nr 4. dt. 11.12.2021 te Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.*
  - *Vendimin nr 5. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.*
  - *Vendimin nr 6. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.*
  - *Vendimin nr 7. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.*
- *Kundër ketij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit."*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur **ankim Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj pajisur në autorizimin e datës 15.09.2021 të lëshuar nga**

Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë z. Lulzim Basha. Në ankimin e paraqitur parashtrohen këto shkaqe dhe pretendime:

- Partia Demokratike e Shqipërisë është miratuar me urdhërin nr. 12, datë 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë dhe figuron e regjistruar në Regjistrin e Partive Politike me kryetar z. Lulzim Basha.
- Në datën 10 Nëntor 2021 një grup anëtarësh të Partisë Demokratike, të paidentifikuar në numër, nëpërmjet medias njoftuan se kanë mbledhur një numër nënshkrimesh të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, që kërkojnë thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të PDSH. Në emër të Kryesisë së Partisë dhe si autoriteti përgjegjës statutor për organizimin e partisë, Sekretari i Përgjithshëm i Partise i bëri thirrje anëtarëve që kërkesa e tyre, së bashku me nënshkrimet të depozitohet në Partinë Demokratike, me qëllim ndjekjen e procedurës statutore për thirrjen e Kuvendit Kombëtar. Sipas nenit 43, pika 2 e Statutit të Partisë Demokratike, vendimi për thirrjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e Partisë. Konkretisht, Statuti i Partisë parashikon se: "*Kuvendi Kombëtar mblidhet si rregull çdo katër vjet. Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e PDSH-së, me propozim të Kryetarit të PDSH-së. Kuvendi mund të mblidhet edhe kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar.*" Statuti njeh dy rrugë për të kërkuar marrjen e vendimit për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar. Rruga normale është propozimi i Kryetarit të Partisë. Mirëpo, si për çdo organ kolegjial, Statuti njeh edhe një rrugë tjetër, që synon të garantojë të drejtat e pakicës në një parti politike, që është kërkesa e 1/4 së anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Në këtë rast, kërkesa e një numri të caktuar të anëtarëve të PDSH apo Kuvendit Kombëtar nuk zëvendëson vendimin e Këshillit Kombëtar apo të Kryesisë së Partisë, por zëvendëson aktin e propozimit nga Kryetari i Partisë. Kërkesa e tyre është e pavarur nga vullneti i Kryetarit të Partisë, si rregull e pakundërshtueshme, por që formalisht i nënshtrohet vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar ose Kryesisë së Partisë, për efekt të njohjes dhe njoftimit të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar, njoftimit të Degëve të Partisë, përgatitjes dhe organizimit të mbledhjes së Kuvendit, përcaktimit të anëtarëve me të drejtë vote të Kuvendit, etj.. Termat e përdorura në Statut "propozim" apo "kur e kërkojnë" kanë të njëjtin efekt, atë të nisjes së procedurës për thirrjen e Kuvendin Kombëtar.
- Anëtarët e partisë, të paidentifikuar në numër, refuzuan të dorëzonin kërkesën pranë Partisë Demokratike, duke pretenduar se kërkesat ishin depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike z. Edi Paloka, i cili nuk kishte të drejtë t'i shqyrtonte, por vetëm do të shërbente si depozitues dhe ruajtës i kërkesës. Sipas nenit 44 të Statutit të Partisë Demokratike, Kryetari i Këshillit Kombëtar nuk ka asnjë kompetencë

statutore, as në thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, as në organizimin e partisë, as në ruajtjen apo depozitimin e kërkesave drejtuar Partisë Demokratike. Pika 4 e nenit 44 të Statutit specifikon se Këshilli Kombëtar drejtohet nga Kryetari i Këshillit, i cili zgjidhet në mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit Kombëtar. Pra, e vetmja kompetencë statutore e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH, është drejtimi i mbledhjes së Këshillit Kombëtar. Sa kohë Kryetari i Këshillit Kombëtar është njoftuar për kërkesën e një numri të pacaktuar të anëtarëve të partisë, ai kishte detyrimin statutor, të njoftonte zyrtarisht organet e partisë, si më poshtë:

a) Kryetarin e Partisë, me qëllim që të vihej në lëvizja procedura për thirrjen e mbledhjes së Kryesisë ose Këshillit Kombëtar;
b) Si anëtarë i Kryesisë së Partisë, të njoftonte anëtarët e tjerë të Kryesisë së Partisë;
c) Si drejtues i Këshillit Kombëtar, duhet të njoftonte anëtarët e Këshillit Kombëtar të PDSH, si dhe të inicionte procedurën për të mbledhur Këshillin Kombëtar që të njihej me kërkesën dhe të ndiqte procedurat përkatëse statutore për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar.

- Në mungesë të këtyre veprimeve nga Kryetari i Këshillit Kombëtar dhe në mungesë të vullnetit për depozitimin e kërkesës së pretenduar në Partinë Demokratike, Kryetari i Partisë, njoftoi thirrjen e mbledhjes së Kryesisë së Partisë, për të diskutuar mbi situatën dhe për të vlerësuar mundësinë për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. Konkretisht, me vendimin nr. 139 Prot, datë 15.11.2021 të Kryesisë së Partisë, u vendos thirrja e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, ditën e shtunë, më datë 18 dhjetor 2021, ora 11:00, në Pallatin e Kongreseve, duke caktuar edhe Rendin e Ditës. Sipas Statutit të PDSH, të drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e ka Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së. Në këtë mënyrë, me caktimin e datës për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar për në datën 18 Dhjetor 2021, 1/4 e anëtarëve të Kuvendit iu krijua mundësia statutore që të përfshinin kërkimin e tyre, duke paraqitur kërkesa apo propozime për vendimmarrje në Kuvend. Kjo e drejtë dhe mundësi statutore nuk u shfrytëzua dhe nuk u paraqit asnjë kërkesë apo propozim shtesë nga ato të përcaktuar nga Kryesia e Partisë.
- Me datën 15 Dhjetor 2021, jemi njohur nga media që një grup individësh i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një kërkesë për pasqyrimin në Regjistrin e Partive Politike ndryshime në emër të Partisë Demokratike. Kjo kërkesë është depozituar në datën 15.12.2021 në emër të Partisë Demokratike. Partia Demokratike pasi u njoh me depozitimin e kësaj kërkese nëpërmjet mediës, i është drejtuar me një kërkesë procedurale gjykatës, duke konfirmuar se kjo kërkesë nuk ishte depozituar nga asnjë prej

organeve të saj drejtuese dhe se ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore si dhe me vetë përcaktimet statutore të PD-së. Më konkretisht në datën 24.12.2021 është depozituar shkresa me Nr. 168/1 Prot, datë 22.12.2021 ku gjykatës i bëhet me dije sa më poshtë: "*Disa ish-funksionar të PDSH, kanë keqpërdorur simbolet dhe vulat e Partisë Demokratike, në kundërshtim me Statutin e Partisë dhe legjislacionit në fuqi. Nisur nga njoftimi i bërë nga Gjykata e Tiranës, krijohet dyshimi i arsyeshëm që veprimtaria e tyre, është shtrirë edhe në paraqitjen e akteve të falsifikuara në Gjykatën e Tiranës. Sipas nenit 7 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Per partite politike", ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër. Gjithashtu ju bëj me dije, që shkelja e çdo proçedure në shqyrtimin "kërkesave" të tilla, si dhe mosrespektimi i ketij ndalimi sjell pasoja të rënda në drejtimet e mëposhtme: - Lirinë kushtetuese për t'u organizuar të çdo anëtari të PDSH-së, e cila është garantuar nga neni 46 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë; - Lirinë kushtetuese të vetë PDSH-së për të ushtruar veprimtarinë e saj sipas nenit 9 të Kushtetutës të RSH-së.*

Ndryshimet e fundit në regjistrin e partive politike nga ana e Partisë Demokratike janë bërë me vendimin nr. 10, date 13.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku janë regjistruar edhe ndryshimet në Statut dhe përbërja e organeve drejtuese të Partisë Demokratike. Gjithashtu, me kerkesën nr. 154 Prot., date 13.12.2021 është depozituar kërkesa për pasqyrimin e ndryshimeve të Statutit të PDSH dhe organeve të reja të zgjedhura në Kuvendin Kombëtar të datës 17.7.2021. Në paraqitjen e kërkesës së Partisë Demokratike nr. 154 Prot., date 13.12.2021, janë mbajtur në konsideratë të gjitha çështjet si më poshtë:

Sipas Statutit të Partisë Demokratike dhe akteve nënstatutore, thirrja e Kuvendit Kombëtar të PDSH (neni 43 i Statutit), kalon nëpërmjet kësaj procedure:

1. Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e PDSH-së.

2. Vendimi merret:

a) me propozim përgjithshëm të Kryetarit të PDSH-së (rregulli i përgjithshëm)

*b) kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar (raste përjashtimore: Kuvendi mund te mblidhet edhe kur **e kerkojne**...[pra, behet fjale për kërkesë, dhe jo për vendim për thirrjen e Kuvendit, i cili në çdo rast merret ose nga Kryesia e Partisë, ose nga Këshilli Kombëtar i PDSH]).*

3. Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anetare, i cili zgjidhet në fillim të Punimeve të tij, me propozimin e Kryetarit të Partisë.

4. Të drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së.

Në përputhje me Rregulloren e Brendshme "Të funksionimit të organeve qendrore të PDSH", miratuar nga Këshilli Kombëtar i PDSH në vitin 2010, thirrja e Kuvendit Kombëtar të PDSH, kalon edhe nëpërmjet kësaj procedure:

1. *Kërkesat për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë duhet t'i dërgohen Kryesisë me shkrim (neni 5 i Rregullores).*
2. *Kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes të Kuvendit Kombëtar e njofton Kryesia e PDSH-së mbi bazën e kërkesave (neni 3 i Rregullores).*
3. *Thirrja për t'u mbajtur Kuvendi u njoftohet degëve me shkrim (neni 4 i Rregullores).*

Sipas Statutit të Partisë Demokratike (neni 60 i Statutit), ndryshimet në Statutin e Partisë, kalojnë nëpërmjet kësaj procedure:

1. *Propozimi i ndryshimeve bëhet nga Kryesia e Partisë ose një e katërteta e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.*
2. *Për përgatitjen e ndryshimeve në Statut ngrihet dhe funksion Komisioni i Përhershëm i Statutit. Komisioni i Përhershëm i Statutit përbëhet nga 7 anëtarë titullarë dhe dy anëtarë ndihmës, dhe caktohet nga Kryesia e Partisë.*
3. *Propozimi miratohet nga Kuvendi i Partisë me shumicën e të gjithë të anëtarëve të tij.*

Sipas Statutit të Partisë Demokratike, shkarkimi i Kryetarit të Partisë bëhet mbi bazën e një mocioni mosbesimi të miratuar nga më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar.

Sipas Statutit të Partisë, shkarkimi i Sekretarit të Përgjithshëm, nënkryetarëve dhe anëtarëve të Kryesisë, nuk është kompetencë e Kuvendit Kombetar, por eshte kompetence e Keshillit Kombetar te PDSH.

Sipas statutit të Partisë Demokratike, asnjë grupim i papërkufizueshëm nuk kanë tagra përfaqësimi nga Partia Demokratike e Shqipërisë në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" të ndryshuar dhe me anë të kësaj kërkese, ju drejtohemi për tju informuar se nuk kemi depozituar asnjë kërkesë dhe çdo pretendim i ndryshëm duhet të pushohet. Nëse një grup personash të paautorizuar kanë pretendime të çfarëdolloj natyre, sjell në vemendje se ato duhen shqyrtuar dhe vendosur në gjykim themeli me palë paditëse dhe palë të paditur në zbatim të nenit 154 të Kodit te Procedurës Civile dhe jo nëpërmjet një procedure regjistrimi, e cila vihet në lëvizje vetëm nga organet e autorizuara të partisë politike. Rrjedhimisht, edhe për këtë shkak, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.

Për sa i përket përfaqësimit po i referohemi dhe dispozitave të nenit 92 të Kodit të Procedurës Civile në të cilën parashikohet se: "Personat juridike marrin pjesë në gjykim me anë të atij që i përfaqëson, sipas dispozitave ligjore". Në zbatim të kësaj dispozite po i referohemi dhe përcaktimeve të nenit 65 të Kodit Civil në të cilën parashikohet ndër të tjera se "Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari caktohen me prokurë".

Në rastin konkret, për tagrat e përfaqësimit duhet t'i referohemi nenit 14 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: "Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në

regjistrimet e mëparshme. Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve".

Për ta qartësuar më tej këtë dispozitë ligjore, i referohemi dhe Statutit të PDSH-së i cili është miratuar në datën 17.07.2021, që më konkretisht nenit 46 i tij që parashikon se:"1. Kryetari i Partisë kryeson organet qendrore të Partisë dhe siguron zbatimin e vendimeve të tyre. Ai përfaqëson Partinë në të gjitha veprimtaritë publike e politike, te brendshme dhe ndërkombëtare."

Për sa referuam më sipër rezulton se ky grupim personash që i janë drejtuar gjykatës nuk kanë asnjë tagër përfaqësimi si persona të autorizuar për të përfaqësuar PDSH-në dhe për të bërë kërkesa të tilla. Rrjedhimisht kjo kërkesë nuk duhet të merret në shqyrtim nga ana e kësaj gjykate pasi kërkuesi nuk ka legjitimitet aktiv.

Gjithashtu kjo kërkesë është nga ato kërkesa që gjykohen pa prezencën e palëve dhe ndjekin të njëjtën procedurë me atë të gjykimit të posaçëm të vërtetimit të faktit pasi gjykata vihet në lëvizje vetëm me kërkesë. Në këto kushte, gjykata duhet t'i referohet nenit 392 të K.Pr.Civile që parashikon se: "Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuesit dhe nje personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme".

Për sa më sipër si dhe në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 Per partitë politike" i ndryshuar, ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër.

Duke qenë se dispozitat ligjore të referuara më lart ju ndalojnë të merrni në shqyrtim këtë kërkesë kërkojmë nga ana juaj që të vendosni pushimin e saj si një kërkesë e pabazuar në ligj. Nëse ky grupim personash pretendojnë cënimin e të drejtave ligjore dhe procedurale ata do të duhet që t'i drejtohen gjykatës me padi themeli me anë të së cilës të kërkojnë rivendosjen e të drejtave të pretenduara në një proces të rregullt ligjor"

- Paraqitja e kësaj kërkese në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga organi përgjegjës sipas ligjit dhe Statutit për përfaqësimin e partisë politike "Partia Demokratike e Shqipërisë", e vendoste Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përpara dy çështjeve:
    a) Konfirmimit se për shqyrtimin e kërkesës, një palë tjetër e interesuar ka shfaqur pretendime mbi vërtetësinë e kërkesës dhe cilësinë e përfaqësimit;
    b) Konfirmimit se gjatë shqyrtimit të kërkesës, është paraqitur një kërkesë tjetër që provon lindjen e një konflikti midis kërkuesit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit.
- Në këtë kuadër, Gjykata e Shkallës së Parë kishte detyrimin ligjor të zbatonte nenet 193 dhe 392 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi. Sekretari njofton atë me letërthirrje. Kërkesa me nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021 e Partisë Demokratike të

Shqipërisë, dërguar nga organi përfaqësues Kryetari i Partisë, sipas regjistrit të partive politike, provon qartë se për shqyrtimin e kërkesës kishte palë të treta që tërhiqnin interesa të ligjshëm dhe në këtë rast vetë organet legjitime të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Për këtë shkak, Gjykata e Shkallës së Parë në zbatim të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, ka patur detyrimin të therrasë gjatë shqyrtimit të kërkesës "Partinë Demokratike të Shqipërisë" përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Lulzim Basha. Mirëpo, shqyrtimi i kërkesës u realizua nga Gjykata e Shkallës së Parë pa njoftuar dhe pa praninë e palës së interesuar me qëllimin e vetëm për t'i mohuar të drejtat dhe për të dhënë një vendim në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore dhe në kundërshtim të hapur me përcaktimet e ligjit 8580/2000 "Për Partite Politike". Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me kërkesën nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021 e Partisë Demokratike të Shqipërisë.

- Nëpërmjet medias jemi njohur se në kundërshtim me nenet 193 dhe 392 të Kodit të Procedurës Civile si dhe në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8580/2000 "Për partitë politike", Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me anë të vendimit me nr. 1346/222 akti nr. 3 vendimi datë 25.03.2022 ka vendosur: "*1. Pranimin e kerkeses se pales kerkuese Partia Demokratike e Shqiperise, perfaqesuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të P.D.SH. 2.Depozitimin e vendimeve te kuvendit Kombetar te PDSH duke rregjistruar ndryshimet perkatese ne regjistrin e partive politike: - Vendimin nr 1. dt.11.12.2021, me anekset bashkëlidhur Statutin e Partisë Demokratike, të Kuvendit Kombëtar të Partisë; - Vendimin nr 2. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; - Vendimin nr 3. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; - Vendimin nr 4. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; - Vendimin nr 5. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; - Vendimin nr 6. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; - Vendimin nr 7. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. 3. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim sipas ligjit.*"
- Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është disponuar në kundërshtim me nenet 193 dhe 392 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe me dispozitat e ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike". Ankimi bazohet në nenin 15 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" dhe nenet 442/a dhe 443 i Kodit të Proçedurës Civile.

- **<u>Së pari</u>, lidhur me legjitimimin e ankuesit, nga faktet e përshkruara më sipër, Partia Demokratike legjitimohet në cilësinë e ankuesit, për të paraqitur këtë ankim dhe për t'u pranuar ky i fundit, në të dyja aspektet e legjitimimit, *atë substancial dhe atë procedural*,** sipas shpjegimeve më poshtë:

- *Në aspektin substancial-* Kërkesa e disa individëve që u mbiquajtën "Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit" u paraqit në gjykatë në emër të Partisë Demokratike. Pra, në

analizë të fundit, subjekti i cili ka qënë palë në këtë gjykim, është vetëm një, është Partia Demokratike e Shqipërisë. Edhe vendimi i gjykatës që kundërshtohet me këtë ankim i adresohet subjektit juridik Partia Demokratike e Shqipërisë. Vendimi që është dhënë dhe që kundërshtohet me ankim, siç është e qartë nuk ka marë formë të prerë. Kjo do të thotë që asnjë efekt juridik i këtij vendimi nuk ka ardhur. Ndër këto efekte, përfshihen edhe ato që kanë të bëjnë me të drejtën e përfaqësimit të subjektit Partia Demokratike. Me fjalë të tjera, e drejta e përfaqësimit të Partisë Demokratike, iu përket organeve drejtuese të saj, dhe se i ashtuquajturi "Komision i Përkohshëm Rithemelimi" nuk ka marrë asnjë tagër përfaqësimi, së paku, derisa kjo çështje të zgjidhet në themel. Ngjarja që ka ndodhur, pra paraqitja e një kërkese në gjykatë për regjistrim ndryshimesh staturore, zhvillimi i një procesi gjyqësor, e më pas dhënia e vendimit, nuk ka ndryshuar të drejtën e përfaqësimit të organeve drejtuese klasike të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë. Ky subjekt përfaqësohet nga një organ statutor siç është Kryetari i Partisë. Deri në momentin e paraqitjes së ankimit, kjo e drejtë e organit të mësipërm të partisë, nuk ka ndryshuar. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, që pretendon ta ndryshojë këtë situatë, në vetvete nuk ka formë të prerë. Për këtë shkak, legjitimimi i subjektit Partia Demokratike, është i plotë, për të paraqitur ankim ndaj një vendimi gjyqësor që cënon drejtperdrejt atë. Këtë legjitimim e mbart sipas statutit pikërisht organi statutor e që është Kryetari i Partisë.

- *Në aspektin procedural.* Legjitimimi në paraqitjen e këtij ankimi bazohet edhe në aspektin procedural. Që të paraqesësh një ankim ndaj një vendimi gjyqësor, duhet të kesh qenë palë në këtë proces apo të kesh bërë kërkesë për të marrë pjesë në proces. Është kjo një nga premisat bazë, që të legjitimon për të kundërshtuar vendimin në fjalë.
- Neni 14 i ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike" parashikon se dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme. Ndërkohë që neni 15 i po të njëjtit ligj nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike" parashikon se: "*Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës.*". Në rastin konkret, ligji parashikon se edhe vendimi i gjykatës për regjistrim mund të ankimohet, pavarësisht se ky është një gjykim pa palë kundërshtare dhe është gjykim njohës. Njohja e ankimit nga ligji, për rastet e vendimit të regjistrimit, është pikërisht mundësia që palë të tjera, që kanë pretendime dhe interes të ligjshëm, që duhet të ishin thirrur në proces, dhe që cënohen nga vendimi i paligjshëm i regjistrimit, të ushtrojnë të drejtën e akimit duke shmangur pasojat e kundërligjshme që mund të vijnë nga zbatimi i vendimit të regjistrimit.

- Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari i saj, me shkresën nr. nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021, ka njoftuar zyrtarisht gjykatën: "*se ky grupim personash që i janë drejtuar gjykatës nuk kanë asnjë tagër përfaqësimi si persona të autorizuar për të përfaqësuar PDSH-në dhe për të bërë kërkesa të tilla. Rrjedhimisht kjo kërkesë nuk duhet të merret në shqyrtim nga ana e kësaj gjykate pasi kërkuesi nuk ka legjitimitet aktiv. Gjithashtu kjo kërkesë është nga ato kërkesa që gjykohen pa prezencën e palëve dhe ndjekin të njëjtën procedurë me atë të gjykimit të posaçëm të vërtetimit të faktit pasi gjykata vihet në lëvizje vetëm me kërkesë. Në këto kushte gjykata duhet t'i referohet nenit 392 të K.Pr.Civile që parashikon se: "Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuesit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme". Duke qene se dispozitat ligjore të referuara më lart ju ndalojnë të merrni në shqyrtim këtë kërkesë kërkojmë nga ana juaj që të vendosni pushimin e saj si një kërkesë e pabazuar në ligj. Nëse ky grupim personash pretendojnë cënimin e të drejtave ligjore dhe procedurale ata do të duhet që t'i drejtohen gjykatës me padi themeli me anë të së cilës të kërkojnë rivendosjen e te drejtave të pretenduara në një proces të rregullt ligjor.*"
- Në këtë mënyrë, Partia Demokratike e Shqipërisë, me paraqitjen e kërkesës nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021, është bërë pjesëmarrëse në gjykim dhe kërkesa e saj për pushimin e çështjes, duhet të ishte marrë në shqyrtim, se bashku me kërkesën kryesore, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Siç rezulton e provuar, edhe nga arsyetimi i vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të injorojë, duke mos marrë në shqyrtim këtë kërkesë, duke mos arsyetuar refuzimin e kësaj kërkese, në kundërshtim me nenin 193 dhe 392 të Kodit të Procedurës Civile. Pra, Gjykata, në mënyrë të kundërligjshme, na ka mohuar, të drejtën që në proces të paraqisnim shpjegimet tona, edhe pse është paraqitur kërkesë procedurale nga ana jonë. Pikërisht kjo kërkesë e jona, na bën pjesë të procesit, thënë me fjalë të tjera, na legjitimon neve si subjekt që ka të drejtë për të paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.
- Për të dyja arsyet e mësipërme, pra si ajo në aspektin substancial e si ajo në aspektin procedural, Partia Demokratike e Shqipërisë, legjitimohet të paraqesë këtë ankim, për të parashtruar kundërshtimet e veta ndaj vendimit të gjykatës, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e saj të ligjshme. Vendimi i gjykatës është dhënë më datë 25 Mars 2022 dhe për pasojë është brenda afatit 15 ditor të ushtrimit të të drejtës së ankimit, sipas nenit 15 të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partite politike" dhe nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile.

- **<u>Së dyti</u>, vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është në kundërshtim me nenet 193 dhe 392 të Kodit të Procedurës Civile.**

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është njohur me kërkesën nr. 168/1 Prot., date 22.12.2021 të Partisë Demokratike të Shqipërisë, gjatë shqyrtimit të çështjes civile me nr. 1346/222 Regj. Themeltar që i përket: *Kërkues- Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të P.D.SH, me adresë Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 11, Tiranë, përfaqësuar me autorizim me nr. 01 prot date 13.12.2021 nga Ivi Kaso; dhe me Objekt- Depozitim ndryshimesh statutore dhe vendimarrje të Kuvendit Kombetar.* Nga shqyrtimi i kërkesës nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021, qartësisht konstatohet se jemi përpara një konflikti mes palëve për të drejtat civile që kanë lidhje me vërtetimin e faktit. Ky është shkak i mjaftueshëm ligjor, që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të konstatonte se gjendej përpara detyrimit për zbatimin e nenit 392 të Kodit të Procedurës Civile, për shkak se ndodhej përpara një gjykimi të posaçëm të vërtetimit të faktit dhe sipas kësaj dispozite ligjore: "*Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuesit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vertetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave te përgjithshme*".
- Nga ana tjetër, kërkesa nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021, provonte ligjërisht për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor se një "person i trete" kishte interes të ligjshëm për çështjen. Kjo nënkupton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka patur detyrimin ligjor, që në përputhje me nenin 193 Kodit të Procedurës Civile, ku specifikohet se: "*Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/e te ketij Kodi. Sekretari njofton atë me letër thirrje*", të thërriste në procesin e shqyrtimit të kërkesës kryesore, në cilësinë e "personit të tretë", Partinë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari i saj, që sipas Statutit dhe vetë regjistrit të partive politike është edhe organi përfaqësues i partisë përkatëse politike në marrëdhënie me të tretët, përfshirë këtu gjykatën. Gjykata është njohur me këtë interes të ligjshëm të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përpara caktimit të seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të Kodit të Procedurës Civile. Konkretisht, gjykata është njohur me kërkesën në datën 24 Dhjetor 2021, ndërkohë që urdhri për caktimin e seancës gjyqësore është nxjerr në datën 23 mars 2022.
- Në këto kushte, rezulton e provuar se vendimi gjyqësor nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është disponuar në kundërshtim me nenet 193 dhe 392 të Kodit te Procedurës Civile, për dy arsye:
    a) nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka arsyetuar pranimin apo rrëzimin e kërkesës procedurale nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021 të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Në këtë rast, gjykata në përputhje me ligjin, duhet të kishte marrë në shqyrtim kërkesën, të kishte konstatuar konfliktin dhe për pasojë të vendoste pushimin e shqyrtimit të kërkesës në çështjen civile Nr. 1346/222 Regj. Themeltar.

b) duke injoruar detyrimin ligjor sipas nenit 193, gjatë shqyrtimit të kërkesës, nuk ka thirrur si palë të tretë, që ka interes të ligjshëm në çështje, Partinë Demokratike të Shqipërisë, të përfaqësuar nga Kryetari i saj, si organi përfaqësues në marrëdhënie me të tretët i një partie politike. Paraqitja e kërkesës procedurale nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021, përbën njohje të gjykatës me faktin që një person i tretë, rezulton se ka interes në çështje.

- **<u>Së treti,</u> vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është në kundërshtim me shkronjën "a" të nenit 297 dhe nenin 298 të Kodit të Procedurës Civile.**

- Shkronja "a" e paragrafit të parë të nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "*Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative*". Në përputhje me këtë dispozitë ligjore, në vendimin nr. 3, date 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi objekt ankimimi, specifikohet se: "*Ne funksion të vazhdimit të shqyrtimit të kërkesës, Gjykata kërkoi tërheqjen e praktikës së dosjes së regjistrimit fillestar të Partisë Demokratike, dosje e regjistruar me Urdhrin Nr.12, datë 19.12.1990 të Ministrisë së Drejtësisë pranë Zyrës së OJF-së. Me shkresën date 28.12.2021 është kthyer përgjigje se dosja e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë është tërhequr me date 20.12.2021 nga Gjyqtare B. M.. Për efekt të vazhdimit të veprimeve në lidhje me kërkesën, Gjykata ka verifikuar në sistemin elektronik të Gjykatës së Tiranës ecurinë e shqyrtimit të kërkesës të PDSH nga Gjyqtare B. M. e cila kishte caktuar datën 15.02.2022 për zhvillimin e seancës gjyqësore për marrjen në hartim të kërkesës, seance e cila u shty për në datën 18.03.2022. Pas shtyrjes së sipërcituar, në zbatim të dispozitave të neneve 13 dhe 14 te Ligjit 8580 dt. 17.02.2000 "Per Partite Politike" të ndryshuar, me qëllim respektimin e afatit 30 ditor për shqyrtimin e kërkesës,* ***Gjykata vendosi në dhome keshillimi kryesisht pezullimin e gjykimit të çështjes deri në perfundimin e çështjes nga Gjyqtare B. M. dhe tërheqjes së dosjes se regjistrimit fillestar të Partisë Demokratike.*** *Në datën 23.03.2022 pala kerkuese depozitoi kërkesën me nr. 2192 Prot., dt. 23.03.2022 me anë të së ciles, në bazë të nenit 298/paragrafi i dytë të K.Pr.Civile, i kërkonte Gjykatës vazhdimin e gjykimit si rrjedhojë e përfundimit të gjykimit dhe shpalljes së vendimit nga Gjyqtare B. M. në datën 18.03.2022. Në këto kushte Gjykata pas verifikimit të pretendimit të kërkuesit në sistemin elektronik të Gjykatës, vendosi të revokojë vendimin e pezullimit dhe të caktojë seancën gjyqësore brenda një afati sa më të shkurtër me qëllim zbatimin (për sa ishte e mundur) të neneve 13 dhe 14 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 "Për Partite Politike" te ndryshuar.*"
- Rezulton e provuar se në kohën e dorëzimit të kërkesës për rregjistrim ndryshimesh statutore nga "Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit", ndryshimet e fundit në regjistrin e partive politike nga ana e Partisë Demokratike ishin bërë me vendimin nr. 10, datë 13.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku janë regjistruar edhe ndryshimet në

Statut dhe përbërja e organeve drejtuese të Partisë Demokratike. Ndërkohë që me kërkesën nr. 154 Prot., datë 13.12.2021, nga ana e Partisë Demokratike është depozituar kërkesa për pasqyrimin e ndryshimeve të Statutit të PDSH dhe organeve të reja të zgjedhura në Kuvendin e fundit Kombëtar të datës 17.07.2021. Për efekt të shqyrtimit të çështjes ishte e domosdoshme që më parë të përfundonte çështja civile e inicuar me kërkesën nr. 154 prot., datë 13.12.2021, të pasqyrohej në regjistër Statuti i Partisë Demokratike i miratuar në Kuvendin Kombëtar të datës 17 Korrik 2021 dhe më pas mund të vijohej me shqyrtimin e kërkesës për çështjen civile Nr. 1346/222 Regj. Themeltar. Ky ishte edhe qëndrimi fillestar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që në dhomë këshillimi kishte vendosur pezullimin e gjykimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pretendon se në datë 23.03.2022 ka marrë një kërkesë nga ana e palës kërkuese për vazhdimin e gjykimit, nisur nga fakti se çështja civile për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të Korrik 2021 kishte përfunduar. Gjykata pretendon se për këtë fakt ka bërë verifikimin në sistemin elektronik të gjykatës. Është e vërtetë që ky shqyrtim kishte përfunduar, por lehtësisht për gjykatën ishte e provuar se vendimi i gjykatës për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të Kuvendit të Korrik 2021 nuk ishte arsyetuar ende, vendimi gjyqësor nuk kishte marrë formë të prerë, për rrjedhojë për efekt të ligjit nuk ishte pasqyruar në regjistrin e partive politike, ashtu dhe Statuti i datës 17 Korrik 2021 nuk ishte pasqyruar dhe depozituar ende. Për efekt të zbatimit të ligjit, që të bëhet pasqyrimi përkatës në regjistër, vendimi i gjykatës për regjistrim duhet të arsyetohet dhe të jetë bërë i ekzekutueshëm, pra të ketë marrë formë të prerë. Ky moment në kuptim të nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohet edhe si momenti i zgjidhjes së një çështje tjetër civile.

- Rezulton e provuar se Partia Demokratike, në përputhje me nenin 15 të ligjit 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të Kuvendit të Korrik 2021 të PDSH. Për këtë arsye, ligjërisht vendimi gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë dhe për pasojë nuk mund të jetë i depozitueshëm dhe i pasqyrueshëm në regjistrin e partive politike. Me anë të shkresës së datës 24.03.2022, Partia Demokratike e Shqipërisë ka vënë në dijeni për këtë fakt trupën gjykuese që shqyrtonte kërkesën për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të Dhjetor 2021 dhe Kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i sqaruar se ndaj vendimit të datës 18.03.2022 për regjistrimin e ndryshimeve statutore të Korrik 2021 është kryer ankim dhe si i tillë ai nuk mund të vazhdonte me shqyrtimin gjyqësor, për sa kohë që në regjistrin e partive politike nuk janë pasqyruar ndryshimet statutore të datës 17.07.2021 të miratuara në Kuvendin Kombëtar të kësaj date. Për pasojë, çështja civile që përbënte shkakun e pezullimit të shqyrtimit gjyqësor nuk është zgjidhur ende në kuptim të nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile.

- Pasqyrimi i këtyre ndryshimeve është thelbësor në shqyrtimin e çdo kërkese pasi siç pretendohet dhe në vendimin, i cili po ankimohet nr. 3 dates 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ai pretendohet se është mbështetur pikërisht në përcaktimet statutore, të cilat ende nuk kanë qënë pasqyruar në rregjistrin e partive politike. Pyetja që lind natyrshëm ka të bëj me faktin se:
  a) Ku u referua Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të verifikuar përputhshmërinë ligjore të vendimarrjeve të këtij kuvendi me statutin e miratuar në Kuvendin Kombëtar të datës 17.07.2021 kur ky i fundit nuk është pasqyruar ende në Regjistrin e partive Politike ?
  b) A kishte detyrë ligjore Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të shikonte përputhshmërinë e dispozitave statutore përpara se të jepte vendim për pasqyrimin ose jo të ndryshimeve statutore të Dhjetor 2021 në Regjistrin e Partive Politike ?

- Pasqyrimi i Statutit të një partie politike në gjykatë, nuk bëhet për efekt të hyrjes në fuqi të Statutit, por për faktin e vetëm të njohjes së tij nga të tretët, përfshirë edhe gjykatën. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë edhe pse i është referuar në vendimin e saj të datës 25.03.2022, Statutit të 17 Korrikut 2021, rezulton e provuar se kur është zhvilluar gjykimi ky Statut nuk ishte depozituar ende ligjërisht në regjistrin e partive politike, sa kohë vendimi gjyqësor i regjistrimit nuk është i ekzekutueshëm dhe nuk ka marrë formë të prerë.
- Në këto kushte, gjykata e shkallës së parë ka qenë në pamundësi procedurale, në zbatim të shkronjës "a", të paragrafit të parë, të nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile, për shqyrtimin e çështjes civile Nr. 1346/222 Regj. Themeltar. Për rrjedhojë, vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 është marrë në kundërshtim me nenin 297 dhe 298 të Kodit të Procedurës Civile.

- **<u>Së katërti</u>, vendimi i nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është në kundërshtim me nenet 9 dhe 46 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" i ndryshuar.**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 46 të saj specifikon se "*Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm*". Ndërkohë që neni 9 i Kushtetutës përcakton se: "*Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike*". Partitë politike, përfshirë Partinë Demokratike të Shqipërisë, rregullohen nga ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" i ndryshuar, si dhe sipas Statutit dhe akteve të brendshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e partisë. Respektimi i ligjit dhe Statutit gjatë veprimtarisë së partisë politike, është thelbësore për respektimin e nenit 9 të Kushtetutës, sipas të cilit organizimi i tyre i brendshëm duhet të

përputhet me parimet demokratike. Në këtë kuptim, veprimtaria publike dhe e hapur, në përputhje me kompetencat e organeve të partisë, është thelbësore për të ruajtur karakterin demokratik të një partie politike, si dhe për të shmangur çdo praktikë antidemokratike që rrezikon vetë-ekzistencën e partisë politike, përmes ndërhyrjes së paligjshme të shtetit, përfshirë edhe gjykatën.

A) **Vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vjen në interpretim të gabuar të dispozitave të Statutit të PDSH, si dhe në injorim të organeve vendimmarrëse të partisë, të regjistruar nga vetë gjykata. Vendimi në kundërshtim me ligjin konsideron një tubim të thirrur jashtë rregullave të Statutit si mbledhje të organeve të partisë që sjell efekte ligjore në organizimin dhe funksionimin e partisë.**

- Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë. Për shkak kompetencave të tij, mbledhja e rregullt, sipas përcaktimeve të Statutit dhe akteve nënstatutore, është thelbësore për ruajtjen e karakterit demokratik të partisë politike. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë në zbatim të gabuar të dispozitave te Statutit dhe akteve nënstatutore, ka konsideruar një tubim, pa organizator të datës 11 Dhjetor 2021, si Kuvend Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe për pasojë ka tentuar të prodhojë efekte ligjore, që vendosin në rrezik pluralizimin politik në vend dhe vetë ekzistencën e Partisë Demokratike të Shqipërisë.
- Për të vlerësuar nëse duhen regjistruar aktet e paraqitura për shqyrtim dhe regjistrim, në regjistrin e partive politike, gjykata e shkallës së parë fillimisht duhet të gjykonte mbi kompetencën dhe identitetin (legjitimitetin/ligjshmërinë) e organit që ka nxjerrë aktet objekt shqyrtimi, si dhe mbi ligjshmërinë e mbledhjes së organit në të cilin janë miratuar aktet përkatëse. Ndryshe nga sa përcakton gjykata e shkallës së parë, Statuti dhe "Rregullorja e Brendshme e funksionimit të organeve qendrore të Partisë", ka vetëm një formë për të mundësuar mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, njoftimi i thirrjes me vendim të institucioneve statutore të partisë, që kanë efekt mbi anëtarët e organit apo anëtarët e partisë. Statuti, ashtu si për çdo organ kolegjial, nuk njeh as vetëthirrjen dhe as vetëmbledhjen, ndryshe nga sa ka interpretuar në mënyrë të gabuar gjykata. Këto nocione antistatutore, bien ndesh me rregullat e funksionimit demokratik të një partie politike, që i nënshtrohen parimit të kontrollit dhe balancës brenda partisë. Vetëthirrja apo vetëmbledhja, pa asnjë verifikim nga institucionet e partisë, është anarshi, dhe si e tillë do e bënte funksionimin e partisë, në kundërshtim me parimet demokratike të funksionimit të një partie politike.
- Në fillim, duhet sqaruar se në formën që gjykata ka vepruar, duke konsideruar një tubim, si mbledhje e organit të një partie politike apo në formën sesi ka njohur akte të pavlefshme, të lëshuara nga persona pa asnjë autoritet statutor, si prova me fuqi të plotë

provuese, rrezikohet legjitimiteti dhe ekzistenca e çdo partie politike në Republikën e Shqipërisë. Në interpretimin që gjykata ka kryer, do të mjaftonte që një grup individësh, pa asnjë funksion në një partie politike, të vetëshpalleshin anëtar të organit më të lartë të një partie politike, jashtë çdo kontrolli të institucioneve statutore kompetente të partisë, të prodhonin akte, t'i njihnin vetes të drejtën për tu paraqitur përpara gjykatës, dhe të vendosnin të regjistronin shkrirjen e një partie politike, jashtë vullnetit të anëtarëve të asaj partie apo jashtë vullnetit të institucioneve legjitime të asaj partie politike, që gjykata të urdhëronte regjistrimin për shkrirjen e një partie politike. Kjo do të përbënte ndërhyrjen më flagrante në të drejtën kushtetutese për tu organizuar dhe do të vinte në rrezik vetë pluralizimin politik në vendin tonë, që është një vlerë kushtetuese e njohur nga Preambula e Kushtetutës.

- Statuti i Partisë Demokratike përcakton në nenin 43, pika 2, se si rregull, mbledhja e Kuvendit Kombëtar mblidhet çdo katër vjet. Neni 43 i Statutit të PDSH përcakton se Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i PDSH. Pika 1 e nenit 43 përcakton antarësinë e Kuvendit Kombëtar (anëtarët), që përbëhet nga funksionar të niveleve të ndryshme të PD, si dhe nga një numër përfaqësuesish të organizatave partnere, numri dhe antarësia e të cilëve caktohet rast pas rasti për çdo mbledhje të Kuvendit Kombëtar. Konstatimi i bërë nga gjykata se anëtarësia e Kuvendit Kombëtar në detyrë deri në zgjedhjen dhe konstituimin e Kuvendit të ardhshëm, mbetet e pandryshuar është i pasaktë, për shkak se janë nga njëra mbledhje e Kuvendit Kombëtar, deri në mbledhjen e Kuvendit të rradhës, mund të ndodhin ndryshime në strukturën e partisë, në përputhje me përcaktimet e Statutit (drejtheqje nga funksioni, shkarkime nga funksioni dhe zgjedhje të reja në nivel seksioni apo grupseksioni, kryesie dege apo organet qendrore të partisë).
- Statuti i PDSH përmban rregulla standarte për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar. Zhvillimi i mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, si çdo organ kolegjial, kalon nëpër disa hapa: *1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, 2. Verifikimi i thirrjes së mbledhjes; 3. Verifikimi i kuorumit për vlefshmërinë e mbledhjes; 4. Çelja e punimeve të kuvendit.*
- Ndryshe nga sa përcakton gjykata e shkallës së parë, Statuti i Partisë Demokratike, nuk përcakton dy lloj mbledhjesh të Kuvendit Kombëtar: i) mbledhje zakonshme; ii) mbledhje e jashtëzakonshme, që përcaktohet nga nga mënyra e thirrjes së saj. Statuti i PDSH njeh vetëm një lloj mbledhje: Mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, sipas rregullave të përcaktuara në Statut dhe në aktet nenstatutore. Nga analiza e dispozitave të Statutit të PDSH, konkretisht nenit 43, ku bazohet thirrja e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar vërehet qartësisht se rruga përmes, së cilës kalon mbledhja e Kuvendit Kombëtar është si më poshtë:

  1-Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e PDSH-së.

2-Vendimi merret:

a) me propozim të Kryetarit të PDSH-së (rregulli i përgjithshëm).

b) kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar (rasti përjashtimor: Kuvendi mund të mblidhet edhe kur e kërkojnë...[pra, bëhet fjalë për kërkesë, dhe jo për vendim për thirrjen e Kuvendit, i cili në çdo rast merret ose nga Kryesia e Partisë, ose nga Këshilli Kombetar i PDSH, dhe ti njoftohet rregullisht dhe në rrugë zyrtare anëtarëve të tjerë të organit].

3-Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anëtarë, i cili zgjidhet në fillim të Punimeve të tij, me propozimin e Kryetarit të Partisë.

4-Te drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së.

- Kjo mënyrë është detajuar edhe në Rregulloren e Brendshme "Të funksionimit të organeve qëndrore të PDSH", miratuar nga Këshilli Kombëtar i PDSH në vitin 2010, sipas të cilit thirrja e Kuvendit Kombëtar të PDSH, kalon edhe nëpërmjet kësaj procedure:

  1-Kërkesat për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë duhet t'i dërgohen Kryesisë me shkrim (neni 5 i Rregullores).

  2-Kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes të Kuvendit Kombëtar e njofton Kryesia e PDSH-së mbi bazën e kërkesave (neni 3 i Rregullores).

  3-Thirrja për t'u mbajtur Kuvendi u njoftohet degëve me shkrim (neni 4 i Rregullores).
- Rregullat për thirrjen e Kuvendit Kombëtar përbëjnë një praktikë të konsoliduar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, duke qenë se janë të pandryshuara që nga miratimi i Statutit të PDSH në vitin 2009. Në këtë kuptim, ndryshe nga sa interpreton në mënyrë të gabuar gjykata e shkallës së parë, ka vetëm një mënyrë për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, që është thirrja me vendim të Këshillit Kombëtar ose Kryesisë së Partisë. Ndërkohë që ka dy forma sesi vihet në lëvizje procedura për marrjen e vendimit për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, që janë:

  a) Me kërkesë (propozim) të Kryetarit të Partisë;

  b) Me kërkesë të 1/4 së anëtarëve të partisë ose 1/4 së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar.
- Në këtë rast Statuti ia ka njohur këtyre dy subjekteve të drejtën për të kërkuar thirjen e Kuvendit Kombëtar, nisur nga fakti se ato janë organe përfaqësuese të vullnetit të drejtëpërdrejtë të anëtarëve. Konkretisht, Kryetari i Partisë zgjidhet nga anëtarët e Partisë sipas parimit "një anëtar, një vote", ndërkohë që edhe pjesa dërrmuese e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar (kryetarët e seksioneve dhe grupseksioneve), zgjidhen nga anëtarët po sipas parimit "Nje anëtar, një votë". Në këtë mënyrë gjen zbatim parimi demokratik ligjor i ngritjes dhe funksionimit nga poshtë - lart të partisë, për mjedhojë u njeh

anëtarëve të drejtën që të jenë pjesë aktive në vendimmarrjet e rëndësishme, përmes përfaqësuesve të zgjedhur drejtëpërdrejtë prej tyre.

- Ndryshe nga sa argumenton gjykata e shkallës së parë, në çdo organ kolegjial shtetëror, publik apo jopublik, e drejta e pakicës për të kërkuar thirrjen e mbledhjes, nuk nënkupton vetëthirrjen, por faktin se ajo i nënshtrohet vetëm kontrollit formal, si rregull është e pakundërshtueshme dhe është jashtë vullnetit të shumicës së organit drejtues. Për ilustrim, i njëjti mekanizëm që njeh pushtetin e pakicës, është edhe procedura për thirrjen e komisioneve parlamenare apo ngritjen e komisioneve hetimore nga Kuvendi. Kushtetuta ia njeh të drejtën për të ngritur një komision hetimor 1/4 së anëtarëve të Kuvendit, por Komisioni Hetimor nuk vetëngrihet dhe për ngritjen e tij kërkohet vendim i Kuvendit. Në këtë rast, ngritja apo mbledhja e Komisionit Hetimor nuk varet nga vullneti i shumicës parlamentare, por kërkesa e pakicës i nënshtrohet kontrollit formal të të qënurit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. I njëjti rregull vepron edhe për thirrjen e mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme Parlamentare nga pakica, ku kërkesa është e pakundërshtueshme, por ajo i nështrohet kontrollit formal të autoritetit që cakton mbledhjen e Komisionit, që është Kryesia e Komisionit Parlamentar.
- Edhe në rastin e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të PDSH, kërkesa e 1/4 se anëtarëve të partisë apo 1/4 së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, është e pakundërshtueshme, por i nënshtrohet kontrollit formal nga institucionet e partisë, në dy drejtime:
  a) nëse kërkuesit janë apo jo zyrtarisht anëtar të partisë apo anëtar të Kuvendit Kombëtar të PDSH, dhe nëse numri i kërkuesve është në numrin limit të kërkuar nga Statuti. Vetëm nëse përmbushet ky kusht, bëhet thirrja e mbledhjes së Kuvendit dhe njoftimi zyrtar i anëtarëve të Kuvendit. Pa u verifikuar ky kusht, nuk mund të ketë as thirrje të Kuvendit dhe as njoftim për mbledhjen e Kuvendit.
  b) nëse themeli i kërkesës, është apo jo në përputhje me Statutin dhe është ose jo në kompetencë të Kuvendit Kombëtar sipas Statutit.
- Në rastin konkret, vendimi i organeve të Partisë për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar është i nevojshëm edhe për efekt njoftimi zyrtarisht të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar, degëve të partisë, dhe institucioneve të partisë. Në mungesë të këtij vendimi, publikimit të rregullt të tij nga institucionet e partisë, njoftimit zyrtar të këtij vendimi për degët e partisë dhe anëtarët e Kuvendit, nuk mund të ketë mbledhje e të Kuvendit Kombëtar.
- Gjykata në mënyrë abuzive parashikon një situatë që del jashtë funksionimit demokratik të një partie politike, duke abuzuar në argument se: "*Në kushte ekstreme, organet drejtuese të partisë, mund të mos vlerësojnë si të nevojshme mbledhjen e Kuvendit dhe vendimmarrjen për çështje të caktuara, në kundërshtim me vullnetin e anëtarësisë. Organet vendimmarrëse mund të jenë në konflikt interesi në raport me ushtrimin e nje kompetence të Kuvendit. Të tilla do të ishin ndryshimet statutore që do të zvogëlonin apo ndryshonin kompetencat e organeve që kanë të*

drejtën e thirrjes së zakonshme apo shkarkimi i tyre (psh. kryetarit) nga Kuvendi. Në këto kushte, këto organe do të refuzonin mbledhjen e Kuvendit.".

- Thirrja e organit kolegjial është e detyrueshme kur një kuorum i përcaktuar me aktin përkatës (kushtetutë, ligj, rregullore apo statut), kërkon thirrjen e organit. Në këto kushte, kërkesa nuk mund të refuzohet, jashtë shkaqeve Statutore apo për arsye të paligjshme të konfliktit të interesit, siç abuzon gjykata e shkallës së parë. Në të kundërt, do të ishim përpara shkeljes së Statutit, që i mundëson anëtarëve kërkues të drejtën për të ankimuar vendimin në institucionet përkatëse Statutore apo në rrugë të tjera ligjore. Për pasojë, e drejta e pakicës (1/4 e anëtarëve të Kuvendit) nuk mund të bllokohet për arsye ekstra-statutore nga institucionet e partisë.
- Eshtë e vërtetë që Statuti në nenin 43 nuk e ka përfshirë të drejtën e pakicës për të thirrur kuvendin në të njëjtën fjali ku rregullohet thirrja me propozim të Kryetarit. Kjo për faktin se thirrja nga 1/4 e anëtarëve të Kuvendit është rast përjashtimor dhe jo rregull i përgjithshëm. Nëse analizon me kujdes Statutin, i njejti rregull vlen edhe për mbledhjen e Këshillit Kombëtar të PDSH. Sipas pikes 5 të nenit 44 të Statutit, "*mbledhjen e Këshillit Kombëtar e thërret Kryetari i Partisë ose Kryesia e Partisë. Këshilli Kombëtar mund të mblidhet edhe nëse e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të tij. Në këtë rast, Kryetari thërret mbledhjen jo më vonë se dy javë nga data e depozitimit të kërkesës*". Pra, edhe në këtë rast vendimi për thirrjen e mbledhjes merret nga Kryetari, organi që thërret si rregull mbledhjet e Këshillit Kombëtar dhe Këshilli Kombëtar nuk vetethirret dhe as nuk vetëmblidhet. Pra, mënyra sesi është formuluar Statuti, që më pas është detajuar nga aktet nënstatutore, ndan rregullin e përgjithshëm për thirrjen e një organi të partisë, nga rregulli përjashtimor për thirrjen e tij, por në çdo rast pa shmangur vendimmarrjen e domosdoshme të institucionit të partisë që bën thirrjen e mbledhjes së organit. Vendosja në një fjali të pavarur dhe lidhëza "edhe" qartësojnë pikërisht faktin se thirrja bëhet ose kur propozon kryetari (rregulli i përgjithshëm), ose kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve (si rregull përjashtimor dhe formë alternative për marrjen e vendimit për thirrjen e mbledhjes nga organet përkatëse).
- Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë nuk argumenton sesi bëhet verifikimi nëse anëtarët që kanë kerkuar thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, janë në numërin e kërkuar nga Statuti apo janë vërtetë anëtar të partisë apo anëtarë të Kuvendit Kombëtar. Mungesa e këtij verifikimi paraprak pamundëson thirrjen e mbledhjes së Kuvendit, për shkak se pa këtë verifikim dhe pa u konfirmuar këto dy kushte, nuk mund të investohen në pjesëmarrje anëtarët e tjerë të Kuvendit Kombëtar. Për këtë qëllim, në aktet nënstatutore dhe konkretisht në "Rregulloren e Brendshme të organizimit të organeve qendrore të partisë" specifikohet se në të dyja rastet, qoftë propozimi i Kryetarit, qoftë kërkesa e 1/4 së anëtarëve, i dërgohet me shkrim Kryesisë së Partisë.
- Gjykata e Shkallës së Parë ka argumentuar se: "*për thirrjen e Kuvendit nga 1/4 e anëtarëve ka dy aspekte themelore: 1. Aspekti cilësor- të drejtën e thirrjes e kanë vetëm delegatët, pra ata*

anëtarë që kanë një funksion që sipas statutit i jep ex officio edhe mandatin e delegatit. 2. Aspekti sasior- duhet që thirrjen ta kërkojnë jo më pak se 1/4 e delegatëve. Plotësimi i këtyre kushteve si dhe caktimi i datës në një afat jo më herët se 30 ditë nga momenti i thirrjes dhe caktimi i rendit të ditës, janë kushtet e mjaftueshme për të thirrur Kuvendin." Mirëpo, gjykata nuk jep përgjigje, se kush e bën dhe sesi bëhet verifikimi i përmbushjes së këtyre dy kushteve, me qëllim që të shkohet më pas në thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, njoftimin e thirrjes së Kuvendit Kombëtar apo mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar. Kjo është arsye, pse sipas akteve nën-statutore kërkesa depozitohet pranë Kryesisë së Partisë, me qëllim që strukturat përgjegjëse për organizimin e partisë dhe që kanë akses të plotë mbi të dhënat e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, të bëjnë verifikimet përkatëse.

- Ndryshe nga sa shprehet gjykata e shkallës së parë, që Statuti i PDSH në asnjë dispozitë të tij, nuk parashikon organin të cilit kërkuesit e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, duhet t'i drejtojnë kërkesën për mbledhjen e tij, në rastet kur mbledhja e Kuvendit kërkohet nga anëtarësia, Statuti i Partisë parashikon se është Sekretari i Përgjithshëm autoriteti përgjegjës statutor për organizimin e partisë. Organizimi i partisë, nënkupton edhe marrjen e masave të nevojshme organizative, për organizimin e mbledhjeve të organeve të partisë, përfshirë Kuvendin Kombëtar. Në këtë pikë, vlen të theksohet se organi se ku depozitohet kërkesa parashikohet në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të organeve qendrore të partisë dhe sipas nenit 5 të këtij akti nënstatutor, kërkesa i dërgohet me shkrim Kryesisë së Partisë.
- Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht thekson se formalizimi i këtyre kërkesave dhe përcjellja e tyre pranë Kryetarit të Këshillit Kombëtar, organ ky i cili në bazë të nenit 44 të statutit përcaktohet si organi më i lartë, i cili drejton veprimtarinë politike të partisë në periudhën midis dy Kuvendeve është në vlerësim të gjykatës i ligjshëm dhe i pa kontestueshëm. Në këtë pikë, qëllimisht dhe në shkelje të ligjit, konsideron si organin më të lartë që drejton veprimtarinë politike të partisë, Kryetarin e Këshillit Kombëtar, ku në fakt sipas Statutit, është Këshilli Kombëtar, një organ kolegjial, ku Kryetari i Këshillit ka vetëm një votë. Kryetari i Këshillit Kombëtar nuk ka asnjë kompetencë statutore, përveç drejtimit të mbledhjes së Këshillit, që lidhet me organizimin e partisë, strukturat e partisë apo anëtarësinë e organeve të tjera të partisë.

B) Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ka anashkaluar provat, duke konsideruar mbledhje të Kuvendit Kombëtar të PDSH, një tubim të organizuar nga persona të caktuar jashtë institucioneve të Partisë.

- Gjykata e Shkallës së Parë në mënyrë të gabuar dhe të paligjshme ka marrë të provuar faktin se një grup deputetësh dhe politikanësh të tjerë të Partisë Demokratike, në datën 10 Nëntor 2021 kanë depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PD më

shumë se 4200 formularë kërkesash të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në oren 11.00. Për këtë qëllim, Gjykata e Shkallës së Parë shprehet se ka marrë dhe ka administruar provën nr. 24 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022. Për të provuar pretendimin e saj, Gjykata shprehet se ka analizuar disa prova. Gjykata shprehet se ka verifikuar nëse shtetasit nënshkrues të thirrjes së Kuvendit Kombëtar përfshiheshin në listën emërore të funksionarëve të PDSH të cilët, në momentin e thirrjes së tij, përbënin listën e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Për këtë qëllim gjykata pretendon se ka administruar provat shkresore, konkretisht provën nr. 3, nr. 4 dhe nr. 22, duke dalë në konkluzionin se listat bashkëngjitur këtyre dokumentave përbëjnë listë të plotë zyrtare dhe të detajuar të shtetasve të cilët përbënin Kuvendin Kombëtar të PDSH, në momentin e thirrjes së tij nga anëtarësia.

- Konkretisht gjykata thekson se ka administruar me cilësinë e provës nr. 22 listën e plotë të delegatëve të Kuvendit Kombëtar, përcjellë zyrtarisht Kryetarit të Kuvendit Kombëtar z. Edi Paloka në datë 11.11.2021 nga ana e Degës nr. 3 të Partisë Demokratike Tiranë. *Së pari*, z. Edi Paloka nuk ka qenë Kryetar i Kuvendit Kombëtar, por ka qenë kryetar i Këshillit Kombëtar; *Së dyti*, Dega 3 e Partisë Demokratike Tiranë, nuk është autoriteti statutor për lëshimin e një dokumenti që përmban listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH, për shkak se del jashtë kompetencave të saj dhe për shkak e ka të pamundur sipas organizimit të partisë, që të disponojë listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH.
- Gjykata e Shkallës së Parë në mënyrë të gabuar shprehet se lista e plotë emërore e delegatëve që perbejnë Kuvendin Kombëtar të PDSH, e përcjell me shkresë zyrtare të kësaj Dege të PDSH ka qenë shkarkuar nga një aplikacion "Blu System", që gjykata e ka cilësuar si aplikacion zyrtar i PDSH, pa shpjeguar se nga e ka marrë zyrtarisht këtë informacion. Ky pretendim i gjykatës është i pavërtetë, për disa arsye: *Së pari*, sipas nenit 32 të Statutit te Partisë, Dega e PDSH-së formohet apo shkrihet me vendim të Kryesisë së PDSH, ajo funksionon përgjithësisht në bazë të njësive të qeverisjes lokale apo çdo ndarje tjetër administrative territoriale të përshtatshme dhe përbëhet nga grup-seksionet dhe seksionet e aty ndodhura. Nga ky përcaktim statutor del qartë që një Degë partie, nuk shtrin veprimtarinë e saj në degët e tjera të partisë dhe ushtron veprimtarinë e vet politike vetëm brenda territorit të degës. Për këtë qëllim, përcaktimi i listës së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH nuk përfshihet brenda kompetencave të një dege të Partisë; *Së dyti*, asnjë degë partie, nuk ka akses apo mundësi, të njoh, dijë apo prodhojë, listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Asnjë degë partie nuk ka akses në asnjë sistem elektronik zyrtar të partisë, që t'i mundësojë njohjen me të dhënat apo listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Për pasojë, nëse në shkresën e Degës 3 Tiranë, është specifikuar një fakt i tillë, ai është i pavërtetë, është një informacion i rremë, e për

pasojë akti që ka marrë në konsideratë gjykata, përveçse absolutisht i pavlefshëm është edhe i falsifikuar; *Së treti*, Partia Demokratike e Shqipërisë nuk disponon asnjë aplikacion zyrtar, që përmban të dhëna të tilla dhe që i mundëson Degëve të Partisë akses në të dhënat e një Dege tjetër partie.

- Qartësisht gjykata ka njohur si provë, një akt absolutisht të pavlefshëm, që është prodhuar nga një autoritet që sipas ligjit nuk e ka në kompetencë. Për pasojë, lista e anëtarëve të Kuvendit që ka marrë si të mirëqenë gjykata e shkallës së parë, nuk përbën listën zyrtare të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Për pasojë, pretendimi i gjykatës se nga verifikimi i kryer nëpërmjet krahasimit të emrave dhe funksioneve të nënshkruesve të thirrjes së Kuvendit Kombëtar me listat e sipërcituara rezulton se nënshkruesit e formularëve të kërkesave të thirrjes së Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 janë anëtarë/delegatë të këtij organi, për shkak të funksionit që gjithsecili prej tyre mban, është i pambështetur në prova dhe bazohet në një rrethanë të rremë, të krijuar në kundërshtim me ligjin dhe Statutin, nga një organ jo kompetent.
- Nga ana tjetër, gjykata shprehet se ka administruar si provë shkresat e FRPD dhe LDG, mbi anëtarët e Kuvendit që janë përfaqësues të tyre. Sipas Statutit, anetar të Kuvendit Kombëtar të PDSH janë edhe jo më shumë se 5 % e anetarëve të Kuvendit Kombëtar, përfaqësues të FRPD dhe LDG. Nisur nga fakti që numri i përfaqësuesve mund të jetë nga 0.1%-5% (për shkak se Statuti specifikon "jo më shumë se") është Sekretari i Përgjithshëm autoriteti përgjegjës statutor, për organizimin e partisë, që për çdo mbledhje te Kuvendit cakton kuotat përfaqësuese të FRPD dhe LDG dhe njofton këta të fundit. Më pas, lista e përfaqësuesve i përcillet Sekretarit të Përgjithshëm, që i përfshin ato në listën e anëtarëve të Kuvendit, për atë mbledhje të Kuvendit Kombëtar, duke i pajisur me mandatin e anëtarit. Kjo është një praktikë e konsoliduar dhe e dokumentuar në çdo mbledhje të Kuvendit Kombëtar. Në rastin konkret, asnjë autoritet statutor nuk ka përcaktuar kuotën e përfaqësimit të FRPD dhe LDG dhe as ka pajisur me mandat anëtari asnjë përfaqësues të FRPD dhe LDG, për shkak se nuk ka patur asnjë mbledhje të Kuvendit Kombëtar të PDSH në 11 Dhjetor 2021 dhe asnjë njoftim për një mbledhje të tillë.
- Gjithashtu gjykata e shkallës së parë shtrembëron faktet kur referon se kërkesa nga ana e 1/4 së anëtarëve përcakton dhe datën 11.12.2021 për kryerjen e punimeve të këtij kuvendi. Ky është një fakt publik dhe i vërtetuar me anë të provave shkresore që një datë e tillë nuk është plotësuar në asnjë formularë të firmosur nga këta persona që pretendojnë se janë anëtarë të Kuvendit Kombëtar të PDSH, që vendi, data dhe ora janë caktuar pas plotësimit të një kërkese të tillë, në mënyrë individuale dhe personale në facebook nga shtetasi Sali Berisha.
- Nga ana tjetër, mbetet e paqartë sesi ka arritur gjykata të vërtetojë nënshkrimet e kërkuesve, që pretendon se janë më shumë se 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, në

kushtet kur kërkesat nuk janë nënshkruar prarë një institucioni të partisë, nuk janë mbledhur nën përgjegjësinë e një grupi të caktuar personash të identifikueshëm dhe as nuk janë mbajtur përpara një noteri publik.

- Gjithashtu, pamjet filmike që gjykata pretendon se ka administruar nuk pasqyrojnë që sistemi elektronik skanon përputhjen mes identitetit të anëtarit të Kuvendit dhe personit që paraqitet në Kuvend.
- **Përsa më sipër, konkluzioni i gjykatës së shkallës së parë se Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike është thirrur në mënyrë të ligjshme nga një numër 25 anëtarësh/delegatësh më i madh se 1/4 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, nuk mbështetet në ligj, statut dhe në prova.**
- Gjykata e shkallës së parë anashkalon faktin, sesi janë njoftuar institucionet e partisë për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, si janë njoftuar Kryetari i Partisë, anëtarët e Kryesisë së Partisë, anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë dhe Degët e Partisë. Sipas gjykatës së shkallës së parë të dhënat u bënë të njohura për të gjithë publikun me mjetet e informimit publik, njoftime në televizione kombëtare, konferenca shtypi, portale e rrjete sociale. Pra sipas gjykatës së shkallës së parë, institucionet e partisë, degët e partisë dhe anëtarët e Kuvendit Kombëtar, duhet të ndjekin domosdoshmërisht televizionet kombëtare, konferencat e shtypit dhe rrjetet sociale, që të njihen me faktin se po mblidhet organi më i lartë vendimmarrës i partisë së tyre. Gjykata nuk ka administruar asnjë provë që dëshmon se institucionet e partisë, dëgët e partisë apo anëtarët e Kuvendit Kombëtar, të jenë njoftuar zyrtarisht me shkrim, siç është praktika e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar dhe siç parashikon neni 4 i Rregullores së Brendshme të Partisë. Pra për gjykatën konsiderohet njoftim i mbledhjes, një njoftim i dhënë në rrjetet sociale, nga kushdo, pa e patur këtë autoritet me statut apo pa patur tagër përfaqësimi në një nga organet e partisë.
- Nga ana tjetër, në mungesë të listës së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH nga një autoritet kompetent sipas Statutit, edhe konkluzioni i gjykatës sipas të cilit: " *Kuvendi Kombëtar i PDSH është mbledhur në mënyrë të ligjshme dhe në ambientet e stadiumit "Air Albania", ku janë zhvilluar punimet e tij, në pjesën e dedikuar të delegatëve të Kuvendit, kanë marrë pjesë 4935 delegatë, prezenca fizike e të cilëve ka bërë që Kuvendi të ketë kuorumin e nevojshëm që ky organ të konsiderohet i mbledhur dhe të mbajë punime e të marrë vendime në mënyrë të ligjshme në përputhje me dispozitat statutore*", është i pabazuar në prova dhe në ligj.
- Sipas Statutit të Partisë, nenit 43 i tij: "*Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anëtarë, i cili zgjidhet në fillim të punimeve të tij, me propozim të Kryetarit të Partisë*". Edhe nga vendimi gjyqësor objekt ankimi, rezulton e provuar se Kryetari i Partisë, për shkak se nuk ka patur asnjë njoftim, kërkesë apo vendim, për thirrjen e Kuvendit Kombëtar në datën 11 Dhjetor, nuk ka bërë asnjë propozim për Komisionin e Drejtimit

të Punimeve. Edhe pse Statuti nuk parashikon caktimin e Komisionit pa propozim të Kryetarit, për gjykatën ka mjaftuar një provë, për ta konsideruar të ezauruar, pa marrë në shqyrtim provat e plota mbi këtë çështje.

- Gjykata sqaron se ka administruar provën nr. 5 "Njoftim për ushtrimin e detyrimeve statutore për mbarëvajtjen e Kuvendit Kombëtar" drejtuar z.Lulzim Basha nga një grup deputetësh përfaqësues të anëtarëve, të cilët thërrasin Kuvendin Kombëtar, si dhe mandatin postar bashkëlidhur. Së pari, gykata gabon kur i cilëson 10 deputetët si përfaqësues të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, sa kohë ato nuk kanë patur tagër përfaqësimi të këtyre anëtarëve. Është e vërtetë që më datën 09.12.2021, 10 anëtarë të Kuvendit Kombëtar, për shkak të cilësisë së tyre si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë i kanë paraqitur Kryetarit të Partisë njoftimin përkatës të protokolluar me nr. 150 prot., datë 09.12.2021. Mirëpo, ndryshe nga sa shprehet gjykata e shkallës së parë, Kryetari i Partisë nuk ka qënë në kushtet e mosushtrimit të kësaj përgjegjësie statutore nëpërmjet mungesës së një përgjigje shkresore. Me shkresën nr. 150/1 Prot., datë 09.12.2021, marrë në dorëzim nëpërmjet zyrës së protokollit nga z. Edi Paloka, në emër të njoftuesve, Kryetari i Partisë, pasi ka konstatuar se 10 anëtarë të Kuvendit Kombëtar, nuk është numër i mjaftueshëm për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, sepse nuk përbën e numrit të anëtarëve të Kuvendit. Pra qartësisht, Kryetari i Partisë jo vetëm ka kthyer përgjigje, jo vetëm nuk ka shfaqur mungesë vullneti për të ushtruar kompetencat e tij statutore, por ka konfirmuar se nuk ka asnjë njoftim zyrtar, asnjë kërkesë të depozituar në Partinë Demokratike për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, dhe se njoftimi i vetem 10 anëtarëve të Kuvendit Kombëtar është i pamjaftueshëm në kuptim të kuorumit të kërkuar nga nenit 43 i Statutit të Partisë, duke konfirmuar se do të ushtrojë përgjegjësitë e tij statutore në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, për të cilin ka dijeni dhe që është njoftuar sipas rregullave të Statutit.
- **Për pasojë, konstatimi i gjykatës së shkallës së parë në vendimin e ankimuar, se propozimi nga Kryetari i Këshillit Kombëtar, në kundërshtim me nenin 43 të Statutit, është i pranueshëm, është i pambështetur në ligj dhe prova.**

C) **Vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka anashkuar rregullat procedurale statutore për miratimin e ndryshimeve në Statut dhe që janë të domosdoshme për të vendosur regjistrimin e tyre në gjykatë.**

- Nga ana tjetër, Gjykata e shkallës së parë në vendimin e ankimuar pretendon se ka verifikuar procedurën dhe mënyrën e marrjes së vendimeve për të cilat kërkohet regjistrimi i tyre, veçanërisht i Vendimit nr.1 dt. 11.12.2021 i cili miraton Statutin e ri të PDSH dhe më pas edhe 6 vendimarrjet e tjera në vijim. Sipas gjykatës rezulton nga procesverbali i mbledhjes se punimeve të Kuvendit Kombëtar, se Komisioni drejtimit të

punimeve të Kuvendit, administroi një kërkesë të paraqitur në përputhje me nenet 43, dhe 60 te Statutit të PDSH-së, si më poshtë: "*Kërkesë dhe draft Statutin (ndryshime në Statut) e propozuar nga 1/4 e anëtarëve të Keshillit Kombëtar të PDSH, (firmat mbështetëse të 138 anëtarëve të Këshillit Kombëtar sipas provave nr. 2 dhe nr.6) dhe të mbështetura nga 15% e anëtarësisë së Kuvendit Kombëtar (firmat sipas provave nr.7), i cili u regjistrua nga Komisioni me nr. 1, datë 11.12.2021 në proces-verbalin e punimeve të Kuvendit*".

- Gjykata në vendimin e ankimuar qëllimisht ka anashkaluar citimin e dispozitave statutore të sipërcituara. Sipas nenit 60 të Statutit të Partisë përcaktohet se: "*Statuti mund të rishikohet nga Kuvendi i Partisë me shumicën e të gjithë të anëtarëve të tij sipas propozimeve të Kryesisë së Partisë, së një të katërtës së anëtarëve të Këshillit Kombëtar.* ***Për përgatitjen e ndryshimeve në Statut ngrihet dhe funksionon Komisioni i Përhershëm i Statutit,*** *i cili është përgjegjës edhe për interpretimin e dispozitave të Statutit.* ***Komisioni i Përhershëm i Statutit përbëhet nga 7 anëtarë titullarë dhe dy anëtarë ndihmës, dhe caktohet nga Kryesia e Partisë.***" Sipas kësaj dispozite, ndryshimet në Statutin e Partisë, kalojnë nëpërmjet kësaj procedure: "*4. Propozimi i ndryshimeve bëhet nga Kryesia e Partisë ose një e katërta e anetarëve të Këshillit Kombëtar. 5. Për përgatitjen e ndryshimeve në Statut ngrihet dhe funksion Komisioni i Perhershëm i Statutit. Komisioni i Përhershëm i Statutit përbëhet nga 7 anetarë titullarë dhe 2 anëtarë ndihmës, dhe caktohet nga Kryesia e Partisë. 6. Propozimi miratohet nga Kuvendi i Partisë me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.*" Për këtë qëllim, për përgatitjen e ndryshimeve në Statut, të propozuar nga 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, duhet të ishte ngritur dhe të funksionontе, Komisioni i Përhershëm Statutor, me vendim të Kryesisë së Partisë. Në rastin konkret, nuk ka patur asnjë kërkesë të tij, dhe për pasojë ndryshimet në Statut nuk janë propozuar, shqyrtuar dhe miratuar në përputhje me nenin 60 te Statutit të PDSH.
- Për pasojë edhe nëse mbledhja e Kuvendit Kombëtar do të ishte e vlefshme, procedura e ndjekur për miratimin e ndryshimeve në Statut, bie ndesh me Statutin në fuqi dhe garancitë që ai ka parashikuar për të miratuar ndryshime në Statut. Për pasojë, nuk ka ligjërisht asnjë Statut të miratuar, e për mjedhojë asnjë vendimmarrje tjetër që buron prej tij, edhe në rastin që mbledhja do të kishte qenë e vlefshme. Në vendimin e gjykatës së ankimuar pavarësisht praktikës së konsoliduar të gjykatës edhe në raste të ndryshimeve më të hershme në Statutin e PDSH, nuk përmendet, as argumentohet dhe nuk provohet, mungesa e ngritjes së Komisionit të Përhershëm Statutor, me qëllim përgatitjen e ndryshimeve në Statut që i paraqiten për votim Kuvendit Kombëtar.
- Përsa më sipër procedurat e ndjekura për propozimin dhe miratimin e akteve të përmendura në vendimin gjyqësor, janë në shkelje të parashikimeve statutore në fuqi në momentin e nxjerrjes së tyre dhe praktika dokumentare shoqëruese e tyre nuk provon se jemi para një mbledhje dhe vendimmarrje të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Për pasojë, gjykata nuk mund të procedojë me regjistrimin e tyre, për shkak se sjellin efekte ligjore të kundërligjshme në veprimtarinë kushtetuese të një partie politike.

D) **Gjykata ka anashkaluar qëndrimin e institucioneve më të larta të partisë, mbi pretendimin se në 11 Dhjetor 2021 është mbajtur një tubim dhe jo mbledhje e Kuvendit Kombëtar të PDSH, që krijon provën e mjaftueshme, se jemi përpara një konflikti, që nuk mund të zgjidhet në një proces gjyqësor vërtetimi fakti.**

- Gjykata e Shkallës së Parë është njohur zyrtarisht me kërkesën nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021 edhe me qëndrimin e organit më të lartë vendimmarrës të Partisë Demokratike, në periudhat mes kuvendeve dhe konkretisht Këshillit Kombëtar, i cili është shprehur në Rezolutën e datës 12 Dhjetor 2021, se: *"Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike, i mbledhur sot, në 12 dhjetor 2021, në përmbushje të përgjegjësive të veta politike dhe statutore, si organi më i lartë i Partisë Demokratike midis dy Kuvendeve. Diskutoi mbi situatën shqetësuese të krijuar nga lëvizja e zotit Sali Berisha pas pezullimit të tij nga Grupi Parlamentar dhe tubimi i tij permbledhës i dates 11 dhjetor; - Konstatoi se thirrja e këtij tubimi, me pretendimin se po mblidhte një Kuvend të Partisë Demokratike, dhe të ashtuquajturat "vendime" shkelin të gjitha normat e Statutit të PD-së që rregullojnë funksionimin dhe vendimarrjen e saj si institucion politik; Veren se tubimi fallsifikoi dhe përdori simbolet dhe logot e Partisë Demokratike në thyerje flagrante të normave statutore dhe ligjore.....".*
- Në këto kushte, në mungesë të mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, i ashtuquajturi "Komisioni i Rithemelimit i Partisë Demokratike", nuk ka tagër përfaqësimi të Partisë Demokratike dhe nuk legitimohet të vërë në lëvizje gjykatën në një procedurë regjistrimi sipas ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike". Përdorimi nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e ankimuar për analogji i nenit 9 të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike" për legjitimimin e një strukture paralele, pa asnjë lidhje me institucionet legjitime të PDSH, është i pavend dhe i gabuar, sepse Partia Demokratike e Shqipërisë është themeluar dhe regjistruar me urdhërin nr. 12, date 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë dhe figuron e regjistruar në Regjistrin e Partive Politike.
- Përsa më sipër, në mbështetje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", vendimi i gjykatës së shkallës së parë nr. 3, datë 25.03.2021 duhet të prishet, për shkak se kërkesa e pranuar nuk është e bazuar në ligj e në prova. Në përputhje me nenet 9 dhe 46 të Kushtetutës, neneve 9, 10, 11, 14 dhe 15 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", neneve 193 dhe 392 të Kodit të Procedurës Civile, brenda afatit të përcaktuar, kërkojmë: ***"Prishjen e Vendimit me nr. 3 datës 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur: "Pushimin e gjykimit ose kthimin e saj për shqyrtim në të njëjtën gjykatë, por me tjetër trupë gjykuese."***

Kundër ankimit të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj me autorizim të Kryetarit të Partisë, ka ushtruar **apel kundërshtues** **Partia**

Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Në apelin kundërshtues parashtrohen këto shkaqe dhe prapësime:

- Partia Demokratike e Shqipërisë është krijuar sipas Urdhërit Nr. 12 date 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë.
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 16.12.2021 është depozituar kërkesa e palës kërkuese "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit në referim të Ligjit Nr.8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar. Objekt i kërkesës ishte depozitimi i ndryshimeve statutorsipas vendimeve të mara nga Kuvendi i Partisë Demokratike i datës 11.12.2021, Kuvend i cili ishte thirrur referuar parashkimeve statutore nga e anëtarëve/delegatëve të Kuvendit dhe në rastin konkret nga 4,200 (të pranishëm në Kuvend 4,935) delegatë me firmë.
- Shortit elektronik caktoi për të shqyrtuar këtë çështje gjyqtarin Agron Zhukri, i cili pas njohjes paraprake me kërkesën, ka dhënë dorëheqjen nga kjo çështje, dorëheqje e cila nuk është pranuar nga Kryetari i Gjykatës.
- Me vendimin nr. 3 date 25.03.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: "-*Pranimin e kërkesën së palës kërkuese, Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit: -Depozitimin e vendimeve te Kuvendit te PDSH duke rregjistruar ndryshimet përkatës në rregjistrin e partive politike: Vendimin Nr.1 daté 11.12.2021, me anekset bashkëlidhur Statutin e Partisë Demokratike, të Kuvendit Kombetar të Partisë; Vendimin Nr.2 date 11.12.2021, të Kuvendit Kombetar te Partisë Demokratike; Vendimin Nr.3 date 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; Vendimin Nr.4 date 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; Vendimin Nr.5 date 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; Vendimin Nr.6 date 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike; Vendimin Nr.7 date 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.-Kunder ketij vendimi mund te behet ankim sipas ligjit.*
- Kundër këtij vendimi, në kundërshtim me ligjin ka ushtruar ankim deputeti Enkelejd Alibeaj, ankim i cili në kundërshtim me dispozitat ligjore është pranuar me vendimin nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka disponuar mbi këtë ankim.

A) Ankuesi nuk legjitimohet të paraqesë ankim ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- Lidhur me aspektin e legjitimimit të ankuesit, deputetit Alibeaj, verifikimi i parë që Gjykata e Apelit duhet të bëjë në gjykimin e ankimit të paraqitur nga deputeti Enkelejd Alibeaj, ka të bejë me faktin nëse ankuesi legjitimohet të paraqesë ankim apo jo. Ankuesi deputeti Enkelejd Alibeaj pretendon se legjitimohet të ankimojë vendimin nr. 3 datë

25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe provizorisht (derisa Gjykata e Apelit t'a marrë në shqyrtim një pretendim të tillë), por në kundërshtim me ligjin ky pretendim i është pranuar nëpërmjet vendimit nr. 508 datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Ankimi i paraqitur dhe nënshkruar nga deputeti Enkelejd Alibeaj nuk duhet të ishte pranuar për shqyrtim, duke u vendosur "mospranimi i ankimit" sipas nenit 450 të K.Pr.Civile, për shkaqet e mëposhtme:
- **Së pari, Ankimi nuk përmbushte kriteret e përcaktuara në mënyrë rigoroze në ligj.** Konkretisht personi që ka paraqitur ankimin nuk është palë në proces në kuptim të ligjit dhe as nuk është përfaqësues legjitim i ndonjë pale në procesin e shqyrtimit të kërkesës. Ligji procedurial parashikon qartë se çfarë është ankimi dhe në dispozitë parashikohen edhe kriteret minimale që ai duhet të plotësojë Neni 442/a parashikon: "*Ankimi është akti me te cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.*" Përsa më sipër, qartësisht duhet të jesh palë në gjykim/ose shqyrtim kërkese, i cili ka konkluduar me vendimarrje, për të patur mundësinë që të ushtrosh ankim në mënyrë të ligjshme ndaj një vendimi gjyqësor. Rekuiziti thelbësor që parashikon dispozita është pozita proceduriale e ankimuesit në proces, ku vetë ligji e përcakton se duhet të jetë palë ose pjesëmarrës në proces, me çfarëdo cilësie tjetër procedurale. Ne vendimin objekt ankimi qartësisht vërehet se palë në proces është Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, palë e vetme në shqyrtimin gjyqësor të kërkesës.
- Kjo palë është njohur me Vendimin nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më datë 29.03.2022, pasi është njohur me arsyetimin e vendimit, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar i ka komunikuar gjykatës shkresërisht vullnetin për të hequr dorë nga ankimi ndaj këtij vendimi, për shkak se gjykata ka pranuar plotësisht kërkesën e parashtruar asaj. Një kopje e shkresës për heqje dorë nga ankimi është edhe në dosjen gjyqësore përkatëse që i përket vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky fakt i rëndësishëm jo vetëm nuk është marrë parasysh nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në marrjen e vendimit objekt ankimi, por as nuk është përmendur fare sikur të mos kishte ekzistuar kurrë. Ky fakt duhet të ishte marrë parasysh dhe gjykata duhet të kishtë dhënë përgjigje për të, pasi e vendoste rastin për vendimarrje në hipotezën e parashikuar nga legjislatori në nenin 450 gërma "d" të Kodit të Procedurës Civile, ç'ka automatikisht diktonte që vendimi të ishte "Mospranimi i ankimit të deputetit Enkelejd Alibeaj".
- Gjithashtu, rezulton nga përmbajtja e Vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë se në shqyrtimin e kësaj kërkese nuk ka patur palë të tjera me çfarëdo cilesie procedurale. Në referencën që dispozita bën për "pale" ajo i referohet subjekteve

qofshin këta fizike, të cilët përfaqësohen personalisht ose ata juridikë, të cilët përfaqësohen nëpërmjet organeve të tyre legjitime dhe përfaqësuesve të tyre të autorizuar. Në rastin e personave juridikë, palë konsiderohet vetëm ky i fundit, kur organet përfqësuese të tij vendosin të veprojnë në emër dhe për llogari të tij. Nuk mund të konsiderohen pale, në kuptim të ligjit, persona sporadike brenda personave juridikë, të cilët pa patur asnjë kompetencë dhe tagër përfaqësimi të personit juridik vendosin të ndërmarrin aksione dhe veprime juridike në emër dhe për llogari të personit juridik.

- Në rastin objekt shqyrtimi vullneti i personit juridik, Partia Demokratike Shqipërisë, per të mos ushtruar ankim ndaj Vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 është i qarte, legjitim dhe i pakontestueshëm, i shprehur nëpërmjet përfaqësuesit me autorizim të organit të tij më të lartë përfaqësues Komisionit të Rithemelimit. Përsa i përket legjitimitetit të këtij të fundit për të përfaqësuar Partinë Demokratike të Shqipërisë, sqarojmë se ai është mandatuar si i tillë nga Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike i datës 11.12.2021, vendimarrje për të cilën Vendimi nr. 3 datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka disponuar për t'u regjistruar dhe pasqyruar në Regjistrin e Partive Politike. Gjithashtu po ky vendim, në faqen 3 të tij, i ka dedikuar një arsyetim të bollshëm çështjes së legjitimitetit të kërkuesit, Komisionit të Rithemelimit në përfaqësim të PDSH, duke konkluduar në mënyrë të pakontestueshme mbi legjitimitetin e Komisionit të Rithemelimit për të përfaqësuar PDSH. Ky arsyetim mbi legjitimitetin, ashtu sikundër i gjithë vendimi nr. 3 dt. 25.03.2022 është në fuqi dhe ende i pa shfuqizuar nga ndonjë gjykatë më e lartë.
- Praktika gjyqësore është mëse e konsoliduar në pranimin e argumentave të parashtruar me sipër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre ka mbajtur një qëndrim të qartë lidhur jo vetëm mbi çfarë duhet të verifikojë gjykata që ka dhënë vendimin, në rastet kur duhet të disponojë mbi pranueshmërinë e ankimit apo mospranimit të tij, por ka dhënë edhe kritere të qarta se si duhet të procedojë gjykata në këto raste. Si shembull i referohemi vendimit Nr. 11243-00155-00-2021 regj. themeltar, Nr. 00-2021-455 ivendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në arsyetimin e vendimit, ndër të tjera Gjykata e Lartë nënvizon se: "…. 21. *Kolegji vlerëson se není 450 i KPC nuk cenon parimin e respektimit te shkallëve të pushtetit gjyqësor dhe te parimit te gjykatës së caktuar me ligj, përsa kohe kontrolli paraprak i gjykatës që ka dhënë vendimin mbi ankimin është i mirëfilltë mekanik, formal- procedural (me konkretisht verifikohet afati i paraqitjes së ankimit,* ***legjitimiteti procedural i palës që ka bërë ankim*** *etj) dhe nuk lidhet me vlerësimin në themel të shkaqeve të ankimit për të cilin ka kompetencën ekskluzive gjykata më e lartë rishikuese…*"Përsa më sipër, edhe nga qëndrimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë del qartë fakti që kontrolli i gjykatës që ka dhënë vendimin, mbi pranueshmërinë ose jo të ankimit është i një natyre të thjeshtë mekanike formale-proceduriale. Në verifikimin e legjitimitetit te ankuesit gjykata verifikon vetëm legjitimitetin procedural të palës ankuese, pra faktin nëse pala

ka qenë apo jo pjesëmarrëse në proces dhe nuk konsideron asnjë pretendim lidhur me legjitimitetin eventual substancial, pasi ky i fundit është vetëm tagër i gjykatës që jep vendimin dhe i gjykatës më të lartë rishikuese.

- Në rastin konkret nga ana e Gjykatës së Apelit, mund dhe duhet të verifikohet eksluzivisht nëse ankimi është paraqitur nga i njëjti organ përfaqësues i Partisë Demokratike që ka vendosur në lëvizje dhe ka disponuar të drejta me Vendimin nr.3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është Komisioni i Rithemelimit. Duke qënë se si argumentuam më lart, ky organ drejtues i partisë ka shfaqur shkresërisht vullnetin për heqje dorë nga ankimi, çdo ankim i paraqitur nga palë apo persona të tjerë duhet të deklarohet i papranueshëm.
- **Së dyti,** nga përmbajtja e ankimit rezulton se deputeti Alibeaj ngre pretendimin se Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur një kërkesë në sekretarinë gjyqësore me nr. 168/1 Prot. datë 22.12.2021 drejtuar Gjykatës që po shqyrtyonte çështjen civile, me të cilën kanë kërkuar pushimin e gjykimit. Sipas deputetit Alibeaj, me paraqitjen e kësaj kërkese - *e cila nuk eshtë marrë aspak në shqyrtim dhe për të cilën gjykata nuk është shprehur as me vendim të ndërmjetëm e as me vendim përfundimtar - janë bërë palë në proces dhe legjitimohen në paraqitjen e ankimit.* Citohet:"*Pra gjykata, në mënyrë të kundërligjshme na ka mohuar te drejtën që në proces të paraqisnim shpjegimet tona, edhe pse është paraqitur kërkesë proceduriale nga ana jonë. Pikerisht kjo kërkesë jona na bën pjesë të procesit ose tënë me fjale të tjera na legjitimon neve, si subjekt që ka të drejtë për të paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.*"
- Ky pretendim në lidhje me legjitimitetin është sa qesharak aq edhe antiligjor në kuptimin e njohjes dhe zbatimit të standarteve minimale proceduriale. Sipas deputetit Alibeaj çdo individ do të mund të bëhej palë (në kuptimin procedurial te termit) në një gjykim që zhvillohej mes personave të tjerë, mjafton që të paraqiste në sekretarinë gjyqësore një kërkesë të çfarëdoshme dhe do të mund të ushtronte të drejta proceduriale si psh.ankimi ndaj vendimit, thjesht dhe vetëm nga ky fakt. Ky argument mund të qëndronte në rast se Gjykata do t'a kishte marrë në shqyrtim kërkesën që ka paraqitur pala dhe do kishte disponuar në lidhje me të, duke i dhënë njëkohësisht edhe cilësi proceduriale edhe të drejtë ankimi në lidhje me vendimin e ndërmjetëm apo përfundimtar. Por Gjykata as e ka shqyrtuar dhe as është shprehur për këtë kërkesë, pasi siç thamë ajo është paraqitur nga persona, të cilët nuk kishin asnjë lidhje me palën kërkuese, Komisionin e Rithemelimit.
- Ky standart është tashmë i vendosur nga Gjykata e Tiranës dhe përmendim ketu vendimin Nr. 1041 Regi. Themeltar datë 15.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ndër të tjera shprehet: "*pra nuk ka një vendim të posaçëm nga kjo gjykatë për pranimin ose jo te kërkesave të futjes ose jo te tyre si pale ndergjyqësa në këtë proces, në mënyrë që më pas, sipas percaktimeve proceduriale mbi të drejtën e ankimit të parashikuara nga Neni 194/2, të K.Pr.Civile te mund te ushtrohej e drejta e ankimit..*"

- E gjejmë me vend të theksojmë, se po i njëjti standart është mbajtur edhe në gjykimin për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të PDSH të Korrik 2021, kur në vendimin për caktimin e seancës gjyqësore lidhur me kërkesën e paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë për të regjistruar Statutin dhe vendimarrjet e Kuvndit Kombëtar të Korrikut 2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është referuar kërkesës së paraqitur nga Komisioni i Rithemelimit me objekt "pushimin e gjykimit" duke mos e marrë në shqyrtim atë dhe duke mos e referuar në vendimin përfundimtar pikërisht si rrjedhojë e mungesës së cilësisë proceduriale. Për këtë arsye kemi kërkuar përdorimin e të njëjtit standart, në të njëtin rast identik duke mos e legjitimuar z.Alibeaj në paraqitjen e ankimit. Për fat të keq, në mënyrë të pakuptimtë dhe në kundërshtim me ligjin dhe me jurisprudencën e mëparshme, ky standart jo vetëm nuk është mbajtur, por as nuk është referuar nga gjykata në vendimarrjen përfundimtare, Vendimi nr. 508 akti datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- **Së treti,** rezulton nga ankimi i paraqitur se ky i fundit është nënshkruar nga Enkelejd Alibeaj, me cilësinë e nënkryetarit të PDSH. Thelbi i ankimit ka të bëjë me kërkesën për ndryshimin e Vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të gjykatës dhe pushimin e kërkesës. Vendimi objekt ankimi vendos për regjistrimin në Regjistrin e Partive Politike të shtatë vendimeve Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 11.12.2021, ku me vendimin e parë të tij miratohej statuti i ri i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Në të gjithë ankimin, por edhe duke kontestuar nëpërmjet ankimit statutin e PDSH të datës 11.12.2021, ankuesi i referohet dhe njeh si të ligjshëm statutin e PDSH të datës 17 Korrik 2021, statut ky për të cilin është vendosur regjistrimi në Regjistrin e Partive Politike, pavarësisht se më pas, në nonsens të plotë juridik pretendon se statuti i datës 17 Korrik 2121 nuk ka marrë fuqi të plotë ligjore pasi vendimi i gjykatës për regjistrimin e tij është ankimuar. Në këtë qëndrim nuk është e qartë cilësia e ankuesit në raport me Partinë Demokratike, kur nga njëra anë pretendon se statuti i datës 17 korrik 2021 nuk është ende në fuqi, dhe nga ana tjetër e konsideron veten nënkryetar të zgjedhur të partisë, sipas dispozitave të po këtij statuti dhe të mandatuar si të tillë nga organet (Keshilli Kombëtar) që burojnë nga Kuvendi Kombëtar i datës 17 Korrik 2021.
- Theksojmë se z.Alibeaj u zgjodh nënkryetar i Partisë Demokratike nga votimi në Këshillin Kombëtar të dates 30.08.2021. Këshilli Kombëtar që ka zgjedhur z.Alibeaj nënkryetar të Partisë është zgjedhur në Kuvendin Kombëtar të datës 17 Korrik 2021 dhe aktet përkatëse janë regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e datës 18.03.2022, për të cilin vetë z. Alibeaj pretendon se nuk ka prodhuar asnjë efekt. Në rast se do pranohej ky arsyetim i z.Alibeaj që ky Kuvend, vendimarrjet dhe statuti i tij janë ende të paregjistruara, atëherë edhe ankuesi nuk rezulton ende ligjërisht i zgjedhur në asnjë funksion partiak në Partinë Demokratike, aq më pak në atë të nënkryetarit, ndaj ai nuk ka asnjë tagër përfaqësimi ndaj të tretëve. Edhe ky fakt duhet të ishte konstatuar

nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin nr. 508 akti, datë 22.04.2022 dhe të ishte mbajtur parasysh në vendimarrjen e saj, por nga përmbajtja e vendimit rezulton se as nuk është konstatuar dhe as nuk është referuar ne vendim.

- Po të analizojmë këtë statut, duke kërkuar dispozitat mbi organet e përfaqësimit të PDSH në raport me të tretët vërejmë se: Neni 46- Kryetari i Partisë *"1.Kryetari i Partisë kryeson organet qendrore të Partisë dhe siguron zbatimin e vendimeve te tyre. Ai përfaqëson Partinë në të gjitha veprimtaritë publike e politike, të brendshme dhe ndërkombëtare. 2. Kryetari i Partisë zgjidhet me votim të të gjithë anëtareve te PDSH, sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Modalitetet e procesit përcaktohen ne aktet nenstatutore. 3.Kryetari i Partisë ndihmohet nga Nënkryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm. Kryetari i Partisë në varësi të problematikave apo çështjeve specifike mund te ngrejë struktura ndihmëse apo te caktoje koordinatore apo te deleguar, të cilat merren me shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre, apo drejtimin e procesit të ngarkuar. 4 Kryetari i Partise gjate veprimtarise se tij te perditshme i cakton detyra dhe fusha te caktuara përgjegjësie Nënkryetareve te Partise. Ne mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim te tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi, duke përfshirë rastet e dorëheqjes nga detyra të Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar, i cili komandon Nënkryetarin që do të drejtojë Partinë deri në rikthimin e Kryetarit në detyrë apo zgjedhjen e Kryetarit të ri. 5. Kryetari i Partisë në përmbushje të funksioneve të tij dhe garantimit te mbarëvajtjes së punës në parti, nxjerr urdhra dhe udhezime, në baze dhe për zbatim te ketij Statuti, si dhe të vendimeve të organeve drejtuese te Partise."*
- Përsa më sipër, rezulton që sipas Statutit të 17 korrik 2021, PDSH përfaqësohet nga kryetari i saj dhe në kushtet e mungesës së zgjatur ose dorëheqjes së tij nga njëri nga nënkryetarët, i cili komandohet në drejtim të Partisë nga Këshilli Kombëtar. Eshtë fakt publik që ish-Kryetari i PDSH z. Lulzim Basha ka dhënë publikisht dorëheqjen nga pozicioni i Kryetarit të Partisë Demokratike. Edhe sikur statuti i PDSH të mos ishte ndryshuar rrënjësisht në datën 11.12.2021, në rastin konkret, z.Alibeaj nuk është komanduar asnjëherë në pozicionin drejtues të Partisë nga Këshilli Kombëtar. Ankuesi gëzonte cilësinë e nënkryetarit të partisë, dhe edhe sikur të mos ishte shkarkuar nga Kuvendi Kombëtar në datë 11.12.2021, ai do të duhet të konfirmohej si drejtues i PDSH nga Këshilli Kombëtar, në një proces votimi ose votëbesimi të këtij të fundit për të përzgjedhur midis nënkryetarëve të partisë se kush do të jetë nënkryetari që do të drejtojë partinë pas dorëheqjes së Kryetarit të PDSH.
- Jo vetëm që një votëbesim i tillë nuk i është dhënë ankuesit, por Këshilli Kombëtar as që është mbledhur për këtë qëllim dhe as e ka marrë ndonjëherë në shqyrtim këtë çështje. Ankuesi nuk disponon dhe as i vë në dispozicion gjykatës ndonjë provë dokumentare në këtë drejtim. Ankuesi është "komanduar" si kryetar partie vetëm nëpërmjet një deklarate për shtyp të ish sekretarit të përgjithëm të PDSH, i shkarkuar ky i fundit gjithashtu nga Kuvendi Kombëtar i PDSH i datës 11/12/2021. Kjo mënyrë antistatutore komandimi nuk prodhonte asnjë pasojë të ligjshme brenda PDSH, edhe sikur të mos kishte ekzistuar

kurrë Kuvendi Kombëtar i datës 11.12.2021 dhe Vendimi nr. 3 datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ankuesi në këtë rast do të ishte "kryetar i komaduar i PDSH" vetëm për efekt mediatik e emisionesh televiziv, por as për anëtarët e PDSH dhe për asnjë institucion të tretë, aq më pak gjykatën.

- **E thënë më thjesht, i vetmi organ legjitim për përfaqësimin e PDSH në raport me të tretët është Komisioni i Rithemelimit miratuar në Kuvendin Kombëtar të datës 11.12.2021, por edhe në rastin që ky organ të mos ekzistonte ose të mos njihej ligjërisht, PDSH do të ishte në vakum ligjor për përfaqësimin me palët e treta si rrjedhojë e dorëheqjes së kryetarit dhe mosmandatimit të një kryetari të ri *ad interim* nga Këshilli Kombëtar.**
- Përsa më sipër, ankimi rezulton i firmosur nga një person, i cili nuk gëzon absolutisht tagra përfaqësimi të PDSH, me asnjë nga statutet e fundit të saj, as ai objekt i vendimarrjes nr. 3 datës 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, as statuti i 17 korrikut 2021, paraardhës i statutit në fuqi të PDSH.
- Gjithashtu, lidhur me legjitimitetin e ankuesit dhe tagrat e tij të përfaqësimit, në vendimin nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë evidentohet një tjetër shkelje e rëndë pasi, ashtu siç vetë arsytohet në këtë vendim, autorizimi për z. Alibeaj nga ish Kryetari i PDSH Lulzim Basha mban datën 15.09.2021, ndërkohë që kërkesa prej z. Alibeaj paraqitet më datë 04.04.2022, kur ashtu siç është bërë me dije, z. Basha kishte dhënë dorëheqje që më 21.03.2022
- **Së katërti,** Çeshtja e legjitimimit të palës që ankohet ndaj vendimit nr. 3 datë 25.03.2022, deputetit Alibeaj, lidhur me qënien pjesëmarrës më çfarëdo cilësie proceduriale në procesin e regjistrimit të vendimeve të Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021, është zgjidhur me vendimin Nr.191 Regj.Temeltar datë 04.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili rrëzon kërkesën e po kësaj pale për përjashtimin e gjyqtarit Agron Zhukri, pasi këta të fundit nuk janë palë në proces dhe për pasojë nuk legjitimohen. Ky vendim përjashtimi nuk është ankimuar, për rrjedhojë është i formës së prerë dhe vetë ankuesi e ka pranuar duke mos e ankimuar.
- Pra praktikisht me vendimin nr. 508 akti, datë 22.04.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka **disponuar mbi një gjë të gjykuar**, duke i dhënë një zgjidhje të ndryshme dhe për më tepër antiligjore. Pavarësisht se ky fakt, i është bërë me dije gjyqtares nga ana jonë, si dhe vendimi përkatës është ankimuar në dosjen gjyqësore të kësaj gjyqtareje, përsëri jo vetëm ky fakt nuk është marrë në konsideratë në dhënien e vendimit, por as është përmendur fare në të.
- **Së pesti,** vendimi objekt ankimi, i cili pranon ankimin e një pale, e cila nuk ka qenë pjesë në proces në kuadër të shqyrtimit gjyqësor të regjistrimit të Kuvendit Kombëtar dhe vendimarrjeve të tij, të një partie politike, e denatyron krejtësisht natyrën e një shqyrtimi të tillë që është mbi bazë "Kërkese", duke e kthyer ajo pa dëshirën e kërkuesve, të cilët

kanë vënë në lëvizje gjykatën, në një gjyq themeli me pale, ç'ka është karakteristikë e shqyrtimit gjyqësor të "kërkesëpadive". Në dijeninë tonë kjo është e paprecedent, por gjykojmë edhe në kundërshtim me ligjin pasi nuk eshte gjykata ajo që dikton mënyrën se si i adreson një palë kërkesat e veta para saj dhe aq më pak të diktojë objektin e tyre. Ky eksluzivitet i përket vetëm palës apo palëve të cilat i drejtohen gjykatës.

- Theksojmë këtu se jo vetëm ne si kërkues, por edhe pala e cila përfaqësohet nga deputeti Enkelejd Alibeaj, nuk ka patur dhe as shprehur kurrë vullnetin për të bërë një gjyq themeli lidhur me legjitimitetin e organeve drejtuese te PDSH. Ajo pale ka pasur dijeni të plotë të procesit tonë te regjistrimit të vendimeve të Kuvendit Kombëtar të 11.12.2021 dhe kurrë nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për ndërhyrje në shqyrtimin e kërkesës tone dhe aq më pak të na padisnin duke kërkuar të benin gjyq themeli.
- **Për të gjitha arsyet e parashtruara më sipër deputeti Enkelejd Alibeaj nuk legjitimohet në bazë të ligjit të paraqesë ankim ndaj vendimit nr.3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

B) Mbi thelbin e pretendimeve që parashtron përpara Gjykates se Apelit deputeti Alibeaj

- Pavarësisht se mos legjitimimi procedurial i ankuesit Alibeaj përbën një pengesë të pakapërcyeshme për shqyrtimin e ankimit të tij nga Gjykata e Apelit, dhe jemi të bindur se gjykata do t'a konstatojë një element të tillë, gjithsesi më poshtë po shprehemi në mënyrë të përmbledhur lidhur me thelbin e pretendimeve të ngritur nga ankuesi.
- Ankimimi i z. Alibeaj edhe në përmbajtje është i pambështetur në prova dhe në ligj. Kështu sipas tij: "*Në datën 10 nëntor një grup anëtarësh të Partisë Demokratike, të paidentifikuar në numër, nëpërmjet medias njoftuan se kanë mbledhur një numër nënshkrimesh të antarëve të Kuvendit të Kombëtar të PDSH.*" Ky konstatim jo vetëm që është i pavërtetë dhe bie ndesh jo vetëm me parashikimet statutore, por edhe me hapat proceduriale që kanë ndjekur e anëtarëve të Kuvendit të cilët kanë kërkuar thirrjen e Kuvendit Kombëtar të PDHSH-së në një mbledhje të jashtëzakonshme: *Se pari,* numri i anëtarëve që kanë firmosur janë 4,200 delegatë të identifikuar me emër dhe mbiemër; *Së dyti,* anëtarët janë të identifikuar sepse janë e të njëjtës listë si ajo e Kuvendit Kombëtar të datës 17.07.2021; *Së treti,* formularët e firmosur prej 4,200 delegatëve, janë depozituar në zyrat e PDSH-së, pranë Kryetarit të Këshillit Kombëtar z. Paloka, si i vetmi organ i kostituar ligjërisht deri në këtë datë; *Së katërti,* këtë fakt e ka analizuar Gjykata e Shkallës së Parë në vendimin e saj nr. 3, datë 25.03.2022 (shiko paragrafi i fundit faqe 4 dhe paragrafi i parë faqe 5), ku sqaron se sipas nenit 43 të Statutit të datës 17.07.2021, mbledhja e Kuvendit Kombëtar si organi më i lartë i PDSH-së, thirret në 2 mënyra:
    a. Thirrja nga organet drejtuese (forma e zakonshme):
    a. Me vendim të Këshillit Kombëtar, bazuar në propozimin e Kryetarit të Partisë;

b. Me vendim të Kryesisë, bazuar në propozimin e Kryetarit të Partisë.

II-Thirrja nga pakica (forma e jashtëzakonshme):

a. Me kërkesë të 1/4 anëtarëve të Partisë;

b. Me kërkesë të 1/4 të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë.

- Siç lehtësisht vërehet, Kuvendi Kombëtar i PDSH-së, është thirrur në zbatim të parashikimeve statutore dhe dispozitave ligjore në fuqi, ku sipas Nenit 9 e vijues të Ligjit "Per Partite Politike" gjykata nuk ka rol aktiv në emërime apo ndryshime pasi këto janë atribut vetëm i organeve të një force politike, të sanksionuara me ligj. Në këtë kuptim, roli i gjykatës, sipas dispozitave ligjore, është vetëm në ushtrimin e kontrollit formal te ligjshmërisë së ndryshimeve statutore dhe verifikimin e respektimit të ligjit apo statutit në proceset vendimmarrëse, të cilat pasqyrohen në këtë rregjistër.
- Në këtë kuadër, nuk është vendimi gjyqësor që u jep të drejtën organeve të partisë apo të emëruarve në postet partiake për të ushtruar funksionet e tyre, por Gjykata kontrollon dhe çertifikon *a posteriori*, të drejtën e tyre për të ushtruar kompetencat organike dhe statutore që nga momenti i kostituimit.
- Nga ana tjetër, përbën një fakt gjerësisht të njohur por edhe të mbështetur në praktikat ndër vite të partive politike dhe në dispozitat statutore te tyre se, ***vendimet hyjnë në fuqi më miratimin e tyre në organet vendimmarrëse***, kjo e bazuar edhe në Nenin 9 të Ligjit "Për Partite Politike", ku sanksionohet se: "*Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partise mund te kryejnë veprime që janë të nevojshme per organizimin e saj, siç janë, sidomos, thirrja e zhvillimi i mbledhjes se themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike.*"
- Për këtë arsye, bazuar edhe në Nenin 14 te Ligjit Nr.8580 date 17.02.2000 "Për Partitë Politike", ku sanksionohet qartazi se veprimtaria e brendshme organizative e partive politike (ashtu siç ka ndodhur me organet drejtuese të dala nga Kuvendi Kombëtar i datës 17.07.2021 të cilat deri më datë 11.12.2021 nuk ishin depozituar pranë Rregjistrit të partive Politike), ***nuk kushtëzohet nga miratimi dhe rregjistrimi gjyqësor, por ky i fundit nevojitet detyrimisht për çertifikimin e ligjshmërisë në këto procese dhe legjitimin ndaj të tretëve***, veprimet proceduriale dhe statutore që nga thirrja e Kuvendit Kombëtar e deri në depozitimin e tyre pranë Rregjistrit të Partive Politike, nga delegatet fillimisht e deri te Komisioni i Rithemelimit si i vetmi organ drejtues deri në Kuvendin e rradhës, janë të bazuara në dispozitat ligjore në fuqi.
- Kjo ishte baza në legjitimimin që Gjykata e Shkallës së Parë i njohu Komisionit te Rithemelimit qoftë në aspektin formal të depozitimit të kërkesës me objekt: "Ndryshimet statutore të Kuvendit Kombëtar të PDSH-së datë 11.12.2021" e më tej si i vetmi organ drejtues i PDSH-së pasi: - Gjykata ka verifikuar se sipas nenit 43 të Statutit të datës 17.07.2021, organi më i lartë i PDSH-së është Kuvendi Kombëtar; - Gjykata ka verifikuar

se sipas po të njëjtit Statut, cilat janë mënyrat e thirrjes së Kuvendit Kombëtar; - Gjykata ka verifikuar se sipas po të njëjtit Statut, jemi për para thirrjes së Kuvendit Kombëtar në mënyrë të zakonshme apo të jashtëzakonshme; - Gjykata ka verifikuar se sipas po të njëjtit Statut, a janë firmëtarët për thirrjen e Kuvendit Kombëtarë delegatë të tij sipas parashikimeve statutore.

- Po kështu, Gjykata ka legjitimuar edhe anën substanciale të thirrjes së Kuvendit Kombëtar nga e delegatëve të këtij Kuvendi, miratuar në Statutin e PDSH-së me qellim, shmangien e bllokimit të vullnetit të antarësisë nga njëra anë si dhe ruajtjen e një balance për nje kuorum minimal nga ana tjetër dhe me arsyetimin se këto thirrje klasifikohen si thirrje të "jashtëzakonshme".
- Për këtë qëllim argumentojmë se pretendimet e ankimuesit se thirrja e Kuvendit Kombëtar të PDSH është në shkelje të nenit 43 të Statutit, nuk janë të bazuara në prova dhe në ligj pasi në asnjë rast Statuti nuk parashikon se kjo është një çështje e organizimit të Sekretarit të Përgjithshëm apo të ndonjë organi tjetër, por përcakton se 1/4 e delegatëve të Kuvendit Kombetar vetëmblidhen dhe ndërmerren ndryshime statutore, të cilat gjykohen si te arsyeshme nga organi më i lartë vendimarrës i demokratëve.
- Nëse statuti nuk do të kishte këtë mekanizëm zhbllokues, Kuvendi Kombëtar do kishte mënyrën e thirrjes vetëm atë të zakonshme, thirrje e cila edhe nëse do kërkohej nga antarësia do mbetej e bllokuar për interesa të Kryetarit apo Sekretarit të Përgjithshëm. Në këtë qartazi rezulton se statuti garanton të drejtën e pavarur të pakicës për të vënë në lëvizjeorganin suprem të partisë siç është Kuvendi Kombëtar, pa paragjykuar vendimmarrjen e tij.
- Edhe pretendimi se, sipas nenit 44 të Statutit të PDSH-së Kryetari i Këshillit Kombëtar duhej të njoftonte Kryetarin e Partisë dhe Këshillin Kombëtar është i pabazuar pasi: -Nuk ka asnjë parashikim statutor lidhur me këtë procedure të pretenduar; -Disa herë z. Paloka ka bërë thirrje për verifikimin e formularëve, por nuk është pranuar nga ish kryetari Basha dhe ish Sekretari i Përgjithshëm z. Bardhi (edhe me deklarata nëpër media); - Disa herë z. Paloka ka bërë thirrje për ngritjen e një grupi të përbashkët për verifikimin e formularëve dhe vijimin me procedurat e Kuvendit Kombtar, por ka gjetur pengesë të përhershëm pretendimin se nuk ka dy pale në PD dhe se nuk i asnje organ i PD nuk i njeh 4,200 delegatët që kanë firmosur thirrjen e Kuvendit Kombëtar.
- Nëse thirrja për Kuvendin Kombëtar do të ishte e barazuar me thirrjen nga pakica me propozim nga kryetari, duke ia nënshtruar vendimarrjen Këshillit Kombëtar apo Kryesisë, jo vetëm që do të zhbëhej e drejta e pavarur e pakicës, por do t'i nënshtrohej vullnetit të një organi në konflikt eventual interesi që do ta bllokonte, duke bërë që një e drejtë e pakushtëzuar e pakicës t'i nënshtrohej vullnetit bllokues të organeve në konflikt interesi.

- Kontrolli i ligjshmërisë nga Gjykata në procedurat e thirrjes së Kuvendit Kombëtar dhe vendimarrjet e tij, vërteton katërcipërisht se thirrja e Kuvendit Kombëtar dhe vendimet e mara në të janë të bazuara në Statutin e PDSH-së dhe në Ligjin "Për Partitë Politike". Kështu është evidente se sipas parashikimeve statutore, thirrja e Kuvendit Kombëtar është bërë: - Nga 4,200 delegatë apo më shumë se e delegatëve si kufiri minimal i kuorumit; -Thirrja e Kuvendit Kombëtar është bërë jo më vonë se afati i parashikuar sipas statutit, 30 ditë nga data e mbajtjes së tij; -Në thirrjen e Kuvendit Kombëtar është pasqyruar rendi i ditës. Për këtë arsye, ne argumentojmë se thirrja e Kuvendit Kombëtar është bërë duke respektuar dy aspekte themelore: *Aspekti cilësor*, që të drejtën e thirrjes e kanë vetëm delegatët të cilët kanë një funksion që i jepet sipas statutit i jep *ex officio* mandatin e delegatit; *Aspekti sasior*, që të drejtën e thirrjes e kanë jo më pak se 1/4 e delegatëve.
- E çmojmë me vend të theksojmë se procedura e ndjekur për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, e gjen pasqyrimin në parashikimet ligjore, ato statutore si dhe ato të statuteve të kaluara të PDSH-së siç është ai i 29.04.2018, ku sipas nenit 47 pika 4 dhe 6 e tij dëshmojnë një mekanizëm të konsoliduar për mënyrën sesi thirret Kuvendi Kombëtar. Referuar dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën e Komisionit të Rithemelimit për depozitimin e vendimeve të Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, evidentohet qartë se formularët e kërkesës, të firmosur nga 4,200 delegate (më shumë se 1/4 delegatëve sipas përcaktimeve statutore), në përputhje me nenin 43 pika 2 e Statutit të PDSH-së kanë të pasqyruar: - Emër dhe mbiemër; -Degen dhe funksioni mbi bazën e të cilit ka marë mandatin si delegat; -Orën dhe datën e thirrjes së Kuvendit; -Vendin e mbajtjes së punimeve; - Rendin e ditës.
- Të gjitha këto dhe mënyra sesi janë verifikuar pjesëmarrësit në Kuvendin Kombëtar, raporti teknik përkatës, pas verifikimit elektronik, por dhe pamjet e transmetuara nga mediat, tregon se jo vetëm janë ndjekur të gjithë procedurat e thirrjes së Kuvendit Kombëtar, por edhe ato të verifikimit të mandatit të çdo delegati, duke rrëzuar kështu të gjitha pretendimet e ankuesit ilegjitim.
- Kështu, Gjykata në referim të provave të depozituara nga Komisioni i Rithemelimit. (konkretisht prova Nr.9, Nr. 10 dhe Nr.11), vlerësoi se përveç kuorumit prej më shumë se 1/4 e delegatëve, të thirrjes së Kuvendit Kombëtar, orën dhe datën e mbledhjes, thirrja për këtë Kuvend përmbante edhe rendin e ditës, kjo në respektim të nenit 43 pika 2 e Statutit:
    i. Miratimi i ndryshimeve statutore sipas propozimeve konform nenit 43/4 dhe 60 se Statutit të PDSH-së për rivendosjen dhe garantimin e demokracisë në vendimmarrjen në forumet e Partisë Demokratike,
    ii. Analiza e qëndrimeve dhe akteve të kryetarit Basha ndaj parimeve themelore e normave të statutit dhe ndaj forumeve të Partisë Demokratike,

iii. Vendimmarrje sipas ndryshime statutore të propozuara dhe thirrja e referendumit të anëtarëve të Partisë Demokratike për të miratuar vendimet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, Përcaktimi i aksionit politik opozitar të Partisë Demokratike të Shqipërisë;
iv. Te ndryshme.

- Përsa më sipër dëshmon qartë se janë respektuar në mënyrë rigoroze të gjithë parashikimet statutore, duke bërë që pretendimet e ankimuesit të jenë të pabazuara në dispozitat ligjore dhe statutore përkatëse.
- Lidhur me pretendimin se thirrja e Kuvendit Kombëtar është bërë nga disa persona anonimë është e pabazuar pasi, Gjykata përveç anës formale ka kontrolluar edhe anën e përmbajtjes lidhur me legjitimitetin e delegatëve që kanë thirrur Kuvendin Kombëtar, duke kontrolluar 4,200 delegatët sipas formularëve respektivë, funksionin e tyre në degët përkatëse dhe kryqezimin me listën prej 7,646 delegatë gjithsej (lista e përdorur nga PDSH në Kuvendin e datës 17.07.2021), kjo në përputhje me pikën 1 të nenit 43 te Statutit te PDSH-së (provat Nr.3, Nr.4 dhe Nr.22 bashkëlidhur kërkesës), ku bëjnë pjesë listat me delegatët e organizatave partnere si LDG dhe FRPD (prova Nr.3 dhe Nr.4) si dhe listën datë 11.11.2021 (prova Nr.22) administruar nga z. Paloka më datë 11.11.2021, kjo në përputhje me nenin 58 të Statutit të PDSH-së.
- Në këtë kuadër ne çmojmë se Gjykata e Shkallës së Parë ka arritur në konkluzion të drejtë dhe të bazuar në prova dhe në ligj kur ka arsyetuar se: "***Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike është thirrur në mënyrë të ligjshme nga një numër anëtarësh/delegatësh më i madh se numri i përgjithshëm i anëtarëve të tij***".
- Përveç ligjshmërisë dhe menyrës së thirrjes së Kuvendit Kombëtar, Gjykata e Shkallës së Parë ka kontrolluar edhe ligjshmërinë e mbajtjes dhe vendimarrjes së Kuvendit ku sipas provave Nr. 18, Nr.19. dhe Nr.23, është menaxhuar sistemi elektronik i identifikimit të delegatëve (gjithsej 4,935 delegatë), duke hedhur poshtë çdo pretendim të ankimuesit lidhur me numrin e delegatëve dhe anonimatin e tyre, si dhe kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar sipas parashikimeve statutore.
- Nga ana tjetër, Gjykata i ka dhënë një rëndësi të veçantë kontrollit të organit, i cili do drejtonte punimet e Kuvendit Kombëtar, duke argumentuar se sipas nenit 43 te Statutit. paragrafi i fundit, parashikon se: "*Punimet e Kuvendit drejtohen nga nje Komisioni përbërë nga 5 anëtare, i cili zgjidhet në fillim të punimeve të tij me propozim të Kryetarit të Partisë*", duke e parë jo si një e drejtë, por si një ushtrim përgjegjësie nga ana e Kryetarit. Në këtë pikë, Gjykata vlerëson se mosushtrimi i kësaj përgjegjësie nuk e pengon organin më të lartë drejtues të PDSH-së, Kuvendin Kombëtar të zgjedhë një Komision me 5 anëtarë që drejtojnë punimet e Kuvendit, por që në çdo rast Kryetarit t'i garantohet mundësia për të propozuar Komisionin drejtues të punimeve. Në këtë pikë, Gjykata e ka çmuar me vend

proven Nr. 5 (mandati postar bashkëlidhur provës) me objekt: "*Njoftim për ushtrimin e detyrimeve statutore për mbarëvajtjen e Kuvendit Kombëtar*", drejtuar z. Lulzim Basha nga një grup deputetësh si pjesë e delegatëve që kanë thirrur Kuvendin e datës 11.12.2021, e cila nuk është marë në konsideratë nga z. Basha duke legjitimuar kësisoj zgjedhjen e këtij Komisioni nga delegatet të pranishëm në Kuvend, me propozim të Kryetarit të Këshillit Kombëtar në fjalën e hapjes në këtë Kuvend.

- Për të gjitha sa paraqitëm më sipër, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 3 date 25.03.2022 është i bazuar në ligj dhe në prova dhe se ankimi i bërë nga z. Alibeaj: Eshtë bërë nga një person i cili nuk ka asnjë tagër për të ankimuar një vendim të tillë, përsa kohë që nuk ka patur asnjë cilësi procedurial e në këtë proces; Eshtë i pambështetur në dispozitat ligjore dhe provat shkresore. Për këto arsye kërkojme: ***"Mospranimin e ankimit bërë nga z. Enkeled Alibeaj, kundër Vendimit Nr.3 datë 04.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe rrëzimin e tij."***

Nga aktet në dosje rezulton se pranueshmëria e ankimit të ushtuar ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga PDSH përfaqësuar me autorizim të Kryetarit të Partisë nga nënkryetari i Partisë z.Enkelejd Aliabeaj, i është nënshtruar shqyrtimit në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe në përfundim me **vendimin nr. 508 akti datë 22.04.2022**, është disponuar për:

- *"Pranimin e ankimit të palës ankuese, Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Nënkryetari i saj z Enkelejd Alibeaj, ndaj Vendimit Nr. 3, datë 25.03.2022 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- *Kundër vendimit nuk lejohet ankim."*

Kundër vendimit nr. 508 akti datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur **ankim të veçantë** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit. Në këtë ankim të veçantë, përsëriten një pjesë e shkaqeve që u parashtruan më sipër për "apelin kundërshtues", shkaqet që lidhen me mungesën e legjitimimit të ankuesit në ushtrimin e ankimit ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. (shkaqet që renditen në rubrikën "A" të shkaqeve të apelit kundërshtues) Përtej këtyre shkaqeve që janë cituar më sipër, po citohen më tej shkaqet e tjera që parashtrohen në lidhje me ankimimin e vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga ankuesi, me konkretisht:

- Në lidhje me vendimin nr.508 akti datë 22.04.2022 pala ankuese PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit ka kërkuar: Prishjen e vendimit nr. 508 datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqëso Tiranë, duke vendosur "Mospranimin e ankimit të palës ankuese Partia Demokratike e Shqipërisë të përfaqësuar nga nënkryetari z.

Enkelejd Alibeaj ndaj vendimit nr. 3 datë25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është njohur përmes mediave lidhur me vendimarrjen objekt ankimi. Pavarësisht se vendimi nr. 508 dt. 22.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është një vendim, i cili cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesin tonë të ligjshëm, pasi pengon marrjen formë të prerë dhe rrjedhimisht rregjistrimin e Vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas kërkesës së paraqitur nga ana onë, përsëri nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ky vendim ende nuk na është komunikuar zyrtarisht.
- **Përsa i përket legjitimimit për të ankimuar,** ashtu si edhe përshkruar më sipër vendimi objekt ankimi është një vendim që cënon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e ligjshëm të Partisë Demokratike të Shqipërisë, dhe si e tillë, kjo e fundit si subjekti, i cili ka vënë në lëvizje gjykatën në procesin e regjistrimit që ka përfunduar me vendimin nr. 3 datë 25.03.2022, ka legjitimitet të plotë procedurial për të ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.
- Pavarësisht se në dispozitivin e vendimit objekt ankimi gjykata shprehet se "kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim", ne përsëri ushtrojmë të drejtën e ankimit ndaj tij duke konsideruar se:
- **Së pari**, Të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor nuk ta jep apo parandalon gjyqtari nëpërmjet vendimit gjyqësor, por vetë ligji procedurial. Në këtë rast gjyqtari duhet të bëjë, në dispozitivin e vendimit, vetëm transpozim të saktë të dispozitës proceduriale, e cila i jep palës të drejtën e ankimit, gjë e cila nuk ka ndodhur në rastin e vendimit objekt ankimi. Në këtë rast gjykata, jo vetëm që nuk ka interpretuar në mënyrë korrekte nenin 450 të Kodit të Procedurës Civile, por edhe as nuk ka analizuar parashikimin e përmbajtur në nenin 452 të po këtij Kodi i cili parashikon se: "*Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj*". Në këtë rast, ligji nuk parashikon shprehimisht se kjo lloj vendimarrje nuk mund të ankimohet, si rrjedhim edhe vendimi objekt ankimi përpara jush është i ankimueshëm drejtpërdrejt sipas nenit 452 të Kodit të Procedurës Civile.
- **Së dyti**, në kuadër të vendimarrjes së gjykatës, ne si palë kemi kërkuar përjashtimin e gjyqtares nga shqyrtimi i kësaj çështje, kërkesë kjo e rregjistruar me nr. 524 rregjistri themeltar, datë regjistrimi 11.04.2022. Me vendimin nr. 542 dt. 19.04.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me kërkesën për përjashtim ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit.... **Kundër këtij vendimi lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar***". Përsa më sipër në kuadër të ankimimit të vendimit nr. 524 datë 11.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, na lind e drejta të ankimojmë edhe vendimin përfundimtar nr. 508 dt 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Përsa i përket vendimit nr. 542 datë 19.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, te cilin gjithashtu e ankimojmë së bashku me vendimin përfundimtar, ky vendim është i pabazuar në ligj e në prova dhe si i tillë duhet rrëzuar. Gjyqtare Blerina Muca, nuk mund të dispononte mbi ankimin e deputetit Enkelejd Alibeaj, kundër vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shqyrtimi i çështjes civile me nr. 508 akti me objekt: Disponim mbi ankimin "Prishjen e Vendimit nr. 1346/222 akti Nr.3 vendimi dt.25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë " paraqitur nga deputeti Enkelejd Alibeaj" e vendoste Gjyqtaren Blerina Muça në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak se objekti i kërkesës lidhet drejtpërdrejt me vendimdhënien e kësaj gjyqtare në çështjen me nr. 214 akti datë 13.12.2021 me objekt "*Pasqyrimi i ndryshimeve të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe të organeve të reja të zgjedhura në Kuvendin Kombëtar të datës 17/7/2021*", për të cilën është shprehur me vendimin datë 18.03.2022, vendim për të cilin pala kërkuese ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit, pavarësisht se Gjykata vendosi pranimin e plotë të kërkesës sipas objektit të saj.
- Duke iu referuar ankimit të paraqitur vërehet se në të gjithë përmbajtjen e tij, argumenti kryesor i kërkuesit është vendimarrja e datës 18.03.2022 dhe interpretimi i pasojave ligjore të kësaj vendimarrje në raport me vendimarrjen e kundërshtuar nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pranimin e kërkesës së PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të 11 Dhjetor 2021.
- Ndërthurja e këtyre dy proceseve, të cilat u zhvilluan paralelisht, është bërë objekt konflikti politik dhe diskutimesh të njohura mediatike, ndaj Gjykata e Tiranës duhet të kishte përjashtuar nga shorti të dy gjyqtarët e përfshirë në vendimarrjet e mëparshme, për të garantuar transparencën dhe objektivitetin në gjykimin e disponimit të ankimit.
- Në kushtet kur përjashtimi nga shorti nuk ka ndodhur (të paktën për gjyqtare Blerina Muçaj) duhet të kishte qënë vetë gjyqtarja që në zbatim të dispozitave të nenit 72 të K.Pr.Civile, duhet të kishte paraqitur dorëheqjen pranë Kryetarit të Gjykatës për shkak të konfliktit të interesit në lidhje me çështjen në fjalë.
- Gjithashtu, në vijim të argumentave të mësipërme dhe të drejtpërdrejtë lidhur me çështjen shtohet edhe fakti botërisht i njohur që Komisioni i Rithemelimit, ka në përbërjen e tij dhe identifikohet në opinionin publik me ish-Kryetarin e Partisë Demokratike, z Sali Berisha, nje personalitet politik, i cili për një kohë të gjatë ka qënë në qendër të vëmendjes mediatike në kuadër të shkëmbimit të akuzave të ndërsjellta publike me bashkëshortin e Gjyqtares Blerina Muça, kur ky i fundit ka mbajtur pozicione publike, çka e vendos gjyqtaren në kushtet e parashikuara nga neni 72/pika 3 i K.Pr.Civile "*kur ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në një konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve. ose njërin prej përfaqësuesve*"

- Për arsyet e mësipërme gjykata e Tiranës duhet të kishte vendosur "përjashtimin e gjyqtare Blerina Mucaj nga shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 3 dt. 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë"
- Arsyet e mësipërme jo vetëm që nuk janë pranuar me vendimin nr. 542 dt. 19.04.2022 në vendimarrjen e saj, por as nuk janë analizuar dhe nuk u është dhënë përgjigje në vendim pse nuk duhen pranuar. Përsa më sipër, të gjitha këto sa parashtruam e bëjnë vendimarrjen nr. 542 dt. 19.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cënueshme dhe si të tillë për t'u shfuqizuar nga ana e Gjykatës së Apelit.
- **Përsa i përket themelit të vendimit nr.508 datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,** parashtrohen shkaqet që rendisin në lidhje me mungesën e legjitimimit të ankuesit sikurse ato janë renditur më sipër në pjesën e shkaqeve dhe prapësimeve të "apelit kundështues".
- Në përfundim kërkohet: ***"Prishja e vendimit nr. 508 datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur "Mospranimin e ankimit të palës ankuese Partia Demokratike e Shqipërisë të përfaqësuar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj ndaj vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."***

Kërkuesi dhe ankuesi patën mundësinë e debatimit gjyqësisht në lidhje me shkaqet e ankimit dhe apelit kundërshtues, duke parashtruar shpjegime të netejshme në seancë në lidhje me to.

Në kërkesën për rregjistrimin e ndryshimeve statutore, PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit ka parashtruar si më poshtë vijon:

- Në datën 11.12.2021 është mbajtur në ambientet e stadiumit "Air Albania" Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, organi më i lartë vendimarrës i PDSH sipas parashikimeve statutore konkretisht nenit 43 të tij.
- Vendimarja e rëndësishme e këtij kuvendi, përpara se të mereshin vendime të tjera, ishte ajo e miratimit të ndryshimeve statutore, të cilat iu propozuan anëtarëve të Kuvendit Kombëtar nëpërmjet një materiali të plotë, i cili pasi u relatua përpara mbledhjes së Kuvendit, u miratua në parim, nen për nen dhe në tërësi.
- Ndryshimet statutore të cilat hyjnë në fuqi menjëherë për shkak të vullnetit të Kuvendit Kombëtar, ashtu sikurse ka ndodhur në çdo rast ndryshimesh statutore, shërbyen si bazë për një sërë vendimarjesh të mëpasshme, të cilat konkretizuan vullnetin e Kuvendit Kombëtar për një sërë ndryshimesh në funksionimin e organeve qëndrore të partisë, duke pezulluar funksionimin e disa prej tyre, si dhe duke shpallur një proces votimi për shkarkimin e Kryetarit të Partisë. Ky proces shkarkimi, i cili u votua në Kuvend do të ratifikohet nëpërmjet referendumit të anëtarësisë që do të mbahet për këtë qëllim, në të gjitha degët e Partisë Demokratike të Shqipërisë në datën 18.12.2021.

- Pasqyrimi në rregjistrin e partive politike të ndryshimeve që ka pësuar statuti i PDSH si dhe të vendimeve të mëpasshme të miratuara nga Kuvendi Kombëtar i PDSH konsiderohet nga ana jonë i domosdoshëm, pasi është prerogativë dhe i paraprin proceseve të vendimarjeve të tjera të rëndësishme në Partinë Demokratike, siç është ajo lidhur me shkarkimin e kryetarit aktual, shkarkim i cili pas miratimit të tij nga Kuvendi Kombëtar duhet të konfirmohet nga anëtarësia e PD në datë 18.12.2021.
- Në përfundim, kërkuesi kërkon pranimin e kërkesës për rregjistrimin e statutit dhe të vendimeve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, duke rregjistruar ndryshimet përkatëse në rregjistrin e partive politike.
- Bashkëlidhur kërkesës janë paraqitur vendimet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të Kuvendit Kombëtar të PDSH mbajtur më datë 11.12.2021, si dhe autorizimi i Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit të PDSH.

Në përfundim të gjykimit në apel, ankuesi kërkoi, prishjen e vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe pushimin e gjykimit të çështjes ose në alternativë prishjen e vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në përfundim të gjykimit në apel, kërkuesi kërkoi mospranimin e ankimit të ushtruar ndaj vendimit nr 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi pala ankuese nuk legjitimohet në ankimin e ushtruar, në të kundërt rrëzimin e ankimit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

II. Legjislacioni i zbatueshëm

Neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë :
"2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut:
"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve

ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë."

Neni 72 i Kodit të Procedurës Civile:
"Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur:
1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;
2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët ose nga mbrojtësit;
3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;
4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërës apo tjetrës palë;
5. është kujdestar, punëdhënës i njërës prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim;
6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.
Kërkesa për heqjen dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili vendos. Për deklarimin e heqjes dorë të kryetarit të gjykatës së shkallës së parë vendos kryetari i gjykatës së apelit dhe për kërkesën e këtij të fundit vendos kryetari i Gjykatës së Lartë. Përmbajtja e kërkesës u njoftohet palëve."

Neni 73 i Kodit të Procedurës Civile:
"Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit."

Neni 75/1 i Kodit të Procedurës Civile:
"Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në dhomë këshillimi nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar....."

Neni 90 i Kodit të Procedurës Civile:
"Palë në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi. Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe."

Neni 91 i Kodit të Procedurës Civile:
"Zotësia për të vepruar

Kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil personat që ushtrojnë lirisht të drejtat, të cilat duhet të respektohen nga të tjerët. Personat, që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre."

Neni 92 i Kodit të Procedurës Civile:
"Personat juridikë marrin pjesë në gjykim me anë të atij që i përfaqëson, sipas dispozitave ligjore."

Neni 96/c të Kodit të Procedurës Civile:
"Si përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë: c) juristët dhe punonjësit e tjerë të autorizuar të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë;"

Neni 450 i Kodit të Procedurës Civile:
"1. Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin, në dhomë këshillimi, menjëherë pas paraqitjes së ankimit, vendos mospranimin e ankimit kur:
a) është paraqitur jashtë afatit;
b) nuk ndreqen të metat në afatin e caktuar sipas nenit 455 të këtij Kodi;
c) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim;
ç) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;
d) është hequr dorë nga ankimi.
2. Kundër vendimit të mospranimit të ankimit mundet të bëhet ankim i veçantë. 3. Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi."

Neni 450/a të Kodit të Procedurës Civile:
"Gjykata, kur pranon kërkesën, i komunikon kopjen e saj palës tjetër, ndërsa aktet e çështjes bashkë me ankimin, ia dërgon gjykatës së apelit të nesërmen e mbarimit të afatit të ankimit për të gjitha palët ose edhe përpara mbarimit të këtij afati, kur nga të gjitha palët janë paraqitur ankimet."

Neni 452 i Kodit të Procedurës Civile:
"Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj."

Neni 453 i Kodit të Procedurës Civile:
"Nënshkrimi i ankimit
Ankimi që i drejtohet gjykatës së apelit duhet të nënshkruhet nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi i pajisur me prokurë."

Neni 454 i Kodit të Procedurës Civile:
"Përmbajtja e ankimit

Në ankim duhet të tregohen: a) palët ndërgjyqëse; b) vendimi kundër të cilit bëhet ankimi; c) shkaqet për të cilat bëhet ankimi; ç) çfarë kërkohet me ankimin."

Neni 455 i Kodit të Procedurës Civile:
" Dokumentet që i bashkëngjiten ankimit
Bashkë me ankimin duhet të paraqiten:
a) kopje të ankimit dhe të dokumenteve të tjera, aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë;
b) prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës.
Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, si dhe ato të neneve 453 dhe 454 të këtij Kodi, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet."

Neni 465 i Kodit të Procedurës Civile:
"Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel
"1. Gjykata e apelit shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit.
2. Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë.
3. Me kërkesë të palëve ose kryesisht, gjykata e apelit riçel pjesërisht ose tërësisht hetimin gjyqësor.
4. Në gjykimin në apel nuk mund të paraqiten kërkime të reja, të shtohen apo të ndryshohen elementët e padisë, me përjashtim të kërkimit për shpenzimet e gjykimit në apel.
5. Gjykata e apelit mund të pranojë për shqyrtim fakte dhe prova të reja, nëse:
a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, gjatë shqyrtimit të çështjes para gjykatës së shkallës së parë nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja;
b) pala e interesuar i ka kërkuar, por gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me ligjin, nuk i ka marrë këto fakte dhe/ose prova, të cilat kanë rëndësi për çështjen;
c) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja gjatë gjykimit në shkallën e parë.
6. Kjo dispozitë nuk zbatohet për marrjen e pohimit gjyqësor ose jashtëgjyqësor."

Neni 466 i Kodit të Procedurës Civile:
"Vendimi i gjykatës së apelit
Gjykata e apelit pasi shqyrton çështjen vendos:
a) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
b) ndryshimin e vendimit;
c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes;
ç) prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në rastet e parashikuara nga neni 467 i këtij Kodi."

Neni 467 i Kodit të Procedurës Civile:

"Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:

a) gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën;

b) përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt ose vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij, ose është cenuar parimi i paanësisë;

c) gjykata e shkallës së parë ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod;

ç) çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin;

d) nuk është formuar drejt bashkëndërgjyqësia, sipas nenit 162, paragrafi i dytë, i këtij Kodi;

dh) kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit;

e) gjykata e shkallës së parë nuk e ka kryer shqyrtimin gjyqësor të të gjitha kërkimeve lidhur me objektin e mosmarrëveshjeve.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, lejohet rekurs i veçantë.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim është e detyruar t'i përmbahet vendimit të gjykatës së apelit për çdo veprim procedural të vendosur në të.

Me vendim të ndërmjetëm, gjykata mund të mos kryejë veprime të caktuara kur për rrethana të reja të dala në rigjykim, shihen të panevojshme. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë. Në rigjykim nuk mund të ngrihen pavlefshmëritë e vërtetuara në gjykimet e mëparshme, kur vendimet përkatëse nuk janë prishur për to. Në rigjykim gjykata i merr të mirëqena provat e administruara rregullisht në gjykimet e mëparshme, përveç kur vendimi është prishur për shkaqet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "ç", "d" të këtij neni. Në këto raste, gjykata administron sërish provat kur kjo është lënë detyrë nga gjykata më e lartë ose merr prova të reja, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Në rigjykim nuk mund të bëhen pretendime të ndryshme nga ato që janë pranuar në vendimin e gjykatës së apelit, përveç nevojës për realizimin e detyrave të vëna nga ajo gjykatë."

Neni 9 i ligjit "Për partitë politike" :

"Krijimi i partive politike"

"Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent.

Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.

Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos,thirrja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike."

Neni 10 i ligjit "Për partitë politike":
"Pasi mbledhja e anëtarëve themelues të partisë politike të ketë miratuar dokumentet e partisë, programin, statutin, si dhe organet drejtuese të saj, duhet të paraqitet në gjykatë kërkesa për regjistrimin e saj."

Neni 13 i ligjit "Për partitë politike":
"Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji. Në rastin kur dokumentet e partive politike nuk janë të rregullta, gjykata, brenda 20 ditëve e kthen kërkesën për të bërë plotësimet përkatëse."

Neni 14 i ligjit "Për partitë politike":
"Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme. Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve."

Neni 15 i ligjit "Për partitë politike":
"Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës."

III. Vlerësimi në vendimin nr. 508 akti, datë 22.04.2022 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në pjesën arsyetuese të vendimit të gjykatës së shkallës së parë nr. 508 akti, të datës 22.04.2022 me objekt "Disponim ankimi", Gjykata ka vlerësuar se:

*"Subjekti politik **Partia Demokratike e Shqipërisë**, përfaqësuar nga **Nënkryetari i saj z Enkelejd Alibeaj**, në bazë të autorizimit datë 15.09.2021, lëshuar nga Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë z. Lulzim Basha, në datë **04.04.2022** ka ushtruar ankim ndaj vendimit të mësipërm, i cili ka kaluar për disponim pranë kësaj gjykate në datë 11.04.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 450/ç të Kodit të Procedurës Civile.*

*Me kërkesën e datës **12.04.2022**, gjyqtarja e çështjes i parashtroi Zv/Kryetarit të Gjykatës shkaqet ligjore që kushtëzonin heqjen dorë nga gjykimi i disponimit të ankimit. Me Vendimin e datës 12.04.2022, kërkesa nuk u pranua, duke u vlerësuar nga Zv/Kryetari se nuk ekzistojnë shkaqet e përcaktuara në nenet 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile.*

***Partia Demokratike e Shqipërisë**, përfaqësuar nga **Komisioni i Rithemelimit**, në datë 11.04.2022 ka depozituar në Gjykatë kërkesë për përjashtimin e gjyqtares së çështjes nga gjykimi, kërkesë kjo e regjistruar*

me Nr.Regj. Them. 524, datë regjistrimi 11.04.2022. Me Vendimin e datës 19.04.2022, nga gjyqtari i caktuar nëpërmjet procedurave të shortit elektronik, është vendosur rrëzimi i kërkesës.

Në kushtet sa më sipër, konform përcaktimeve të nenit 450 të K.Pr.Civile, nga kjo gjykatë u vijua me marrjen në shqyrtim të elementëve të ankimit të Partisë Demokratike Shqipërisë, përfaqësuar nga Nënkryetari i saj z. Enkelejd Alibeaj, ndaj Vendimit Nr. 3. date 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 43 i Kushtetutës së RSH-së sanksionon rregullin e përgjithshëm të ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë nga kushdo, përveç rasteve përjashtuese të përcaktuara në Kushtetutë, si një e drejtë kjo e lidhur drejtpërdrejt me të drejtën kushtetuese të kujtdo për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat kushtetuese dhe ligjore nëpërmjet një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (neni 42 i Kushtetutes).

Organizimi dhe funksionimi i sistemit gjyqësor, siguron mjetet e nevojshme ligjore për ushtrimin efektiv të të drejtave kushtetuese të çdo individi. Ndërkohë, Kodi i Procedures Civile, përcakton procedurat ligjore për ushtrimin e të drejtës së ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, si dhe realizimin e kontrollit mbi vendimin, nga një shkallë më e lartë gjykimi. Neni 443 i këtij Kodi, përcakton afatin 15 ditor, brënda të cilit pala e interesuar mund të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj një vendimi përfundimtar të shkallës së parë të gjykimit, si dhe afatin 5 ditor për ankime të veçanta. Në kuptim të nenit 444 të K.Pr.Civile, afatet e mësipërme janë të prera dhe fillojnë nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar të gjykatës.

Neni 452 i K.Pr.Civile përcakton:
"Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj."

Në këtë kuadër, neni 452 i K.Pr.Civile reflekton parimin kushtetues të ankimimit në gjykatën e apelit të të gjitha vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi nuk lejohet shprehimisht në ligj.

Neni 454 i këtij Kodi, përcakton si elemente të domosdoshëm të ankimit: -Palët ndërgjyqese; -Vendimi kundër të cilit bëhet ankimi; - Shkaqet për të cilat bëhet ankimi - Çfarë kërkohet me ankimin.

Neni 450 i K.Pr.Civile përcakton:
"Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin, në dhomë këshillimi, menjëherë pas paraqitjes së ankimit, vendos mospranimin e ankimit kur:
a) është paraqitur jashtë afatit.
b) nuk ndreqen të metat në afatin e caktuar. Në këto raste zbatohen rregullat e percaktuara në nenin 157 te ketij Kodi:

c) eshte bere kunder nje vendimi ndaj te cilit muk lejohet ankim:
c) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim
d) eshte hequr dorë nga ankimi.
Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkalle gjykimi. Kundër vendimit për kthimin e ankimit mund të bëhet ankim i veçantë."

Kryesekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kaluar për disponim ankimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë pranë kësaj gjykate, pasi ka vlerësuar se, janë kushtet e nenit 450, gërma "" të Kodit të Procedurës Civile. Në ankim, subjekti PDSH përfaqësohet nga përfaqësues të ndryshëm nga përfaqësuesit e legjitimuar në kërkesën për të cilën gjykata ka dalë me Vendimin Nr. 3, datë 25.03.2022.

Nga PDSH, përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, në datë 08.04.2022, është paraqitur një kërkesë nëpërmjet të cilës, i kërkohet kësaj gjykate të vendosë mospranimin e ankimit, duke parashtruar argumentat ku bazohet kërkesa.

Në zbatim të parimeve kushtetuese të reflektuara në përcaktimet e Kodit të Procedures Civile, duke analizuar aktet e fashikullit gjyqësor, pjesë e të cilit është bërë dhe kërkesa si më sipër e Komisionit të Rithemelimit, Gjykata konstaton se ankimi në shqyrtim duhet të pranohet për sa vijon:

- *Vendimi Nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dispozitivin e tij, ka përcaktuar mes të tjerash, edhe të drejtën e ushtrimit të ankimit ndaj këtij vendimi sipas ligjit. Neni 15 i Ligjit Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Per Partite Politike", i ndryshuar, përcakton afatin 15 ditor të ankimit ndaj vendimeve gjyqësore të regjistrimit të një subjekti politik dhe të pasqyrimit në regjistrin e posaçëm të ndryshimeve thelbësore që ky subjekt pëson, si pasojë e vendimmarrjeve të organeve drejtuese më të larta të tij. Për rrjedhojë, vendimi ndaj të cilit është paraqitur ankimi në shqyrtim, është vendim i ankimueshëm për në Gjykatën e Apelit, brënda afatit 15 ditor;*
- *Subjekti politik Partia Demokratike e Shqiperise, përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, ka pozitën proceduriale të kërkuesit në kërkesën me objekt: Depozitim i akteve dhe vendimeve te dala nga Kuvendi Kombetar i dates 11.12.2021. Ky subjekt, rezulton të jetë i njëjti me subjektin që ka depozituar ankimin ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata për pranimin e kërkesës, pavarësisht përfaqësuesve të ndryshëm të tij. Brenda këtij kuadri. Gjykata vlerëson dhe pranon ekzistencën e interesit të ligjshëm të subjektit politik PDSH, në paraqitjen e ankimit, me qëllim ushtrimin dhe realizimin e të drejtës kushtetuese të kontrollit mbi ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë nga gjykata më e lartë;*
- *Qëndrimi dhe kërkesa për pushimin e gjykimit, paraqitur përpara Gjykatës që ka dhënë Vendimin Nr. 3, datë 25.03.2022 nga PDSH. përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Lulzim Basha, janë bërë pjesë e ankimit në shqyrtim, duke parashtruar në thelb të tyre pretendime mbi legjitimimin e përfaqësuesve të kërkuesit, si dhe mbi pabazueshmërinë në përcaktimet statutore në fuqi të thirrjes dhe organizimit të Kuvendit Kombëtar të këtij subjekti në datë 11.12.2021:*

- *Në vlerësim të kësaj Gjykate, edhe në këtë kuadër interesi i ligjshëm i këtij subjekti politik, pavarësisht përfaqësuesve të paraqitur përpara gjykatës, është ai i ushtrimit të kontrollit të vendimmarrjes së shkallës së parë të gjykimit nga një gjykatë më e lartë, në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në përcaktimet statutore në fuqi, të akteve dhe vendimeve të dala nga organi më i lartë vendimmarrës i Partisë.*
- *Duke analizuar elementët formal të ankimit, Gjykata konstaton se ankimi është paraqitur brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit;*
- *Ankimi është nënshkruar nga zoti Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e Nënkryetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Autorizimi/Akti i Përfaqësimit i datës 15.09.2021, lëshuar nga Kryetari i PDSH-së për zotin Alibeaj. i ka dhënë këtij të fundit tagra të përgjithshme përfaqësimi të subjektit politik PDSH në të gjitha proceset gjyqësore. Ky autorizim përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 72 të K.Pr.Civile;*
- *Po kështu, nënshkrimi i z. Alibeaj në ankimin në shqyrtim, shoqërohet me vulën e subjektit ankues, element ky i domosdoshëm në dhënien e fuqisë juridike, akteve të një subjekti/personi juridik në një proces gjyqësor civil, i cili është i barazvlefshëm me fuqinë juridike të vërtetimit të nënshkrimit të individëve përpara noterit publik: Verifikimi i ligjshmërisë së përfaqësuesve të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë në cilësinë e kërkuesit dhe ankuesit, është në kompetencë funksionale të Gjykatës së Apelit Tiranë, në kuadër të shqyrtimit të Vendimit Nr. 3. Datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Dhomë Këshillimi, Gjykata vlerëson të pranueshëm ankimin e paraqitur ndaj Vendimit Nr. 3, datë 25.03.2022 (Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili, pasi t'i komunikohet kërkuesit PDSH. përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, së bashku me fashikullin e Vendimit të mësipërm, duhet të përcillet pranë Gjykatës së Apelit Tiranë."

IV. Vlerësimi në vendimin nr. 3, datë 25.03.2022 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vlerësuar se:

*"**Në lidhje me legjitimimin e kërkuesit:***

Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga Komisioni i Rithemelimit i Partisë Demokratike, (nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar), organ i cili cilësohet si organi i përkohshëm drejtues i Partisë Demokratike të Shqipërisë, zgjedhur dhe miratuar nga vendimarrjet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 11.12.2021.

Gjykata sqaron se verifikimi i legjitimimit të palëve, në përputhje me nenin 176 të C.Pr.Civile është detyrim thelbësor i procesit civil dhe në përmbushje të këtij detyrimi, Gjykata pasi kreu verifikimin

e aspektit formal te akteve të përfaqësimit, duke i gjetur ato të rregullta dhe në përputhje me ligjin procedurial.

Për sa i përket të drejtës aktive të Komisionit te Rithemelimit për t'iu drejtuar gjykatës si organi drejtues dhe përfaqësues i PDSH, Gjykata thekson se në përputhje me dispozitat e ligjit "Për Partitë Politike", neni 9, 10 e vijues, si dhe bazuar në praktikën gjyqësore të regjistrimeve e ndryshimeve në partitë politike, Gjykata nuk ka rol aktiv në emërimin/ndryshimet apo shkarkimet e organeve drejtuese apo të zgjedhurve në partitë politike, por ushtron vetëm kontrollin formal të ligjshmërisë së ndryshimeve statutore dhe verifikimin e respektimit të kërkesave të ligjit apo të statutit në proceset vendimarrese te cilat pasqyrohen në regjistrin e partive politike.

Thënë ndryshe, nuk është vendimi gjyqësor, që u jep të drejtën organeve të partisë apo të emëruarve në postet partiake për të ushtruar funksionet e tyre, por gjykata kontrollon dhe vertifikon a posteriori, të drejtën e tyre për të ushtruar kompetencat organike dhe statutore që nga momenti i kostituimit.

Sa më sipër përbën një fakt gjerësisht të njohur, të mbështetur në praktikat ndër vite të artive politike (duke përfshirë edhe palën kërkuese), në dispozitat statutore të cilat hyjnë në fuqi menjëherë me miratimet e tyre në forumet vendimarrëse të partisë si edhe mbi të gjitha në vetë disponimet e nenit 9 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 "Për Partite Politike" të ndryshuar i cili shprehet se:

> *"Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë më të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos, thirrja e zhvillimi i mbledhjes se themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejne veprimtari si parti politike"*

Dispozita e sipërcituar e interpretuar për analogji edhe në rastet e regjistrimeve të mëvonshme (sipas nenit 14 te Ligjit nr.8580 dr. 17.02.2000 "Për Partitë Politike" të ndryshuar) - sqaron qartazi, që veprimtaria e brendshme organizative (zgjedhja e organeve drejtuese) e partive politike nuk kushtëzohet nga miratimi dhe regjistrimi gjyqësor, por ky i fundit nevojitet detyrimisht për çertifikimin e ligjshmërisë në këto procese dhe legjitimimin ndaj të tretëve.

Bazuar në sa më sipër, në analizë të rastit objekt shqyrtimi, Komisioni i Rithemelimit legjitimohet në aspektin paraprak formal të paraqitjes së kërkesës dhe vënies në lëvizje të gjykatës, si organ i zgjedhur dhe i emëruar nga Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, por legjitimimi substancial bëhet nga verifikimi material nga ana e gjykatës i ligjshmërisë dhe i respektimit të normave statutore në thirrjen, mbledhjen dhe vendimarrjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021.

Në lidhje me themelin e kërkesës:

Për të vlerësuar nëse duhen regjistruar aktet e paraqitura për shqyrtim dhe regjistrim, në regjistrin e partive politike, gjykata çmon se fillimisht duhet të gjykojë mbi kompetencën e organit që ka

nxjerre aktet objekt shqyrtimi, si dhe mbi ligjshmërinë e mbledhjes së organit në të cilin janë miratuar aktet përkatëse.

a) Si thirret Kuvendi Kombëtar dhe dispozitat e zbatuara

Statuti i miratuar në mbledhjen e 17 Korrikut 2021 përcakton në nenin 43, pika 2, se si rregull, mbledhja e Kuvendit Kombetar mblidhet çdo katër vjet.

Neni 43 i statutit te 17 Korrikut 2021 përcakton se Kuvendi Kombëtar është organi me i lartë vendimmarres i PDSH. Pika 1 e nenit 43 përcakton se antarësia e Kuvendit Kombëtar (delegatët) formohet ex officio, nga funksionarë të niveleve të ndryshme të PD, që bashkë me mandatin e funksionit të zgjedhur apo emëruar, zotërojnë edhe mandatin e delegatit. Ne momentin kur një funksionar i PD, sipas statutit të 17 Korrikut 2021, zgjidhet apo emërohet në funksionin përkatës, marrin automatikisht edhe mandatin e delegatit në Kuvendin Kombëtar. Ky mandat zgjat katër vjet, deri në mbarimin e mandatit të Kuvendit (organit) të radhës. Pra, anëtarësia e Kuvendit Kombëtar në detyrë deri në zgjedhjen dhe konstituimin e Kuvendit të ardhshëm, mbetet e pandryshuar, me përjashtim të delegatëve individuale të cilëve u përfundon parakohe mandati i funksionit për shkak të të cilit zotërojnë mandatin e delegatit të Kuvendit Kombëtar.

Statuti i 17 Korrikut 2021 përmban rregulla standarte për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar. Zhvillimi i mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, si çdo organ kolegjial, kalon nëpër disa hapa:

1. *Thirrja e mbledhjes se Kuvendit Kombëtar,*
2. *Verifikimi i thirrjes së mbledhjes;*
3. *Verifikimi i kuorumit për vlefshmërinë e mbledhjes;*
4. *Celja e punimeve të kuvendit.*

Nga analiza e dispozitave të statutit i 17 Korrikut 2021 ku bazohet thirrja e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të 11 Dhjetorit 2021, vërehet se statuti përcakton dy lloj mbledhjesh të Kuvendit Kombëtar: i) mbledhje e zakonshme; ii) mbledhje e jashtëzakonshme. Lloji i mbledhjes përcaktohet nga mënyra e thirrjes së saj.

Mbledhja e Kuvendit Kombëtar, në përputhje me statutin e 17 Korrikut 2021, ka dy forma për tu thirrur dhe secila mënyre ka dy mënyra. Forma përcaktohet nga kush ka të drejtë të thërrasë mbledhjen:

***1. Thirrja nga organet drejtuese** (forma e zakonshme):*

a. Me vendim të Keshillit Kombetar, bazuar në propozimin e kryetarit të partisë:

b. Me vendim të Kryesisë, bazuar në propozimin e kryetarit të partisë:

***2. Thirrja nga pakica** (forma e jashtëzakonshme)*

a. Me kërkesë të 1/4 së antarëve të partisë:

b. Me kërkesën e 1/4 së delegatëve të Kuvendit Kombëtar,

***Forma e zakonshme e thirrjes**- Kuvendi Kombëtar është organ kolegjial, përfaqësues i anetarëve. Roli i kryetarit të partisë është i kufizuar vetëm në propozimin për thirrje të Kuvendit. Vetëm propozimi nuk mjafton për ta thirrur atë. Statuti i'a ka besuar thirrjen e zakonshme organeve drejtuese, që dalin prej*

Kuvendit (Këshilli Kombëtar zgjidhet drejtpërdrejt nga Kuvendi, ndërsa Kryesia zgjidhet nga Këshilli Kombëtar, pra derivon nga vullneti i Kuvendit Kombetar).

Organet thirrëse e thërrasin Kuvendin për çështje që nuk janë kompetencë e tyre e që statuti ia jep vetëm Kuvendit Kombetar ose u nevojitet legjitimitet i plotë në vendimmarrje. Miratimi ndryshimi i statutit dhe shkarkimi i kryetarit të partisë janë kompetencë e Kuvendit Kombetar sipas nenit 43 të statutit të 17 Korrikut 2021. Statuti, nëpërmjet mekanizmit të dyfishtë të thirrjes (propozimi - vendim), jo vetëm respekton hierarkine statutore të organeve ku Kryetari është organ i varur nga organi përfaqësues, por siguron edhe ndarjen e pushtetit përfaqësues nga ai ekzekutiv që përfaqësohet nga kryetari.

Forma e jashtëzakonshme e thirrjes- *Pushteti epror vendimmarrës, sipas statutit të 17 Korrikut 2021 ushtrohet nga anëtarët vetëm me delegim tek Kuvendi Kombëtar, duke qenë se nuk parashikohej asnjë instrument i ushtrimit të drejtpërdrejtë të vullnetit (referendum i anëtarësisë) për çështje që janë kompetencë e Kuvendit. Statuti njeh parimin demokratik ligjor të ngritjes dhe funksionimit nga poshtë-lart të partisë, për rrjedhojë u njeh anëtarëve të drejtën që të jenë pjesë aktive në vendimmarrjet e rëndësishme. Kjo u njihet anëtarëve nëpërmjet të drejtës për të thirrur Kuvendin Kombëtar dhe vendosur në mënyrë autonome rendin e ditës së tij, jashtë vullnetit të organeve të tjera të partisë.*

Si për çdo organ kolegjial shtetëror, publik apo jopublik edhe statuti i 17 Korrikut 2021 parashikon vetëthirrjen e tij apo thirrjen nga pakica, jashtë vullnetit të organeve drejtuese.

Në të gjitha këto raste, thirrja e organit kolegjial është e detyrueshme kur një kuorum përcaktuar me aktin përkatës (kushtetute, ligi, rregullore apo statut), kërkon thirrjen e organit Thirrja nga ana tjetër është e ndarë nga formimi i kuorumit të mbledhjes dhe zhvillimi i saj.

Në kushte ekstreme, organet drejtuese të partisë, mund të mos vlerësojnë si të nevojshme mbledhjen e Kuvendit dhe vendimmarrjen për çështje të caktuara, në kundërshtim me vullnetin e anëtarësisë. Organet vendimmarrëse mund të jenë në konflikt interesi në raport me ushtrimin e nje kompetence të Kuvendit. Të tilla, do të ishin ndryshimet statutore që do të zvogëlonin apo ndryshonin kompetencat e organeve që kanë të drejtën e thirrjes së zakonshme apo shkarkimi i tyre (psh. kryetarit) nga Kuvendi. Në këto kushte, këto organe do të refuzonin mbledhjen e Kuvendit.

Me qëllim shmangien e bllokimit të vullnetit të anëtarësisë, por nga ana tjetër ruajtjen e një balance, statuti ka vendosur nje kuorum minimal për thirrjen nga pakica prej 1/4 të delegatëve përfaqësues, delegatëve të kuvendit ose 1/4 të anëtarëve me të drejtë vote të partisë. Ky prag kaq i lartë është vënë pikërisht prej faktit se thirrje të tilla duhet të jenë të jashtëzakonshme dhe çështjet për shqyrtim të një rëndësie aq të madhe sa të motivojë një numër të lartë anëtarësh.

Vlen te theksohet fakti se: Statuti në nenin 43 nuk e ka përfshirë të drejtën e pakicës për të thirrur kuvendin në të njëjtën fjali ku rregullohet thirrja e zakonshme. Pra, statuti nuk barazon thirrjen nga 1/4 e delegatëve apo anëtarëve me propozimin për thirrje te kryetarit. Jo vetëm pakica thërret organin e vet, por statuti garanton të drejtën e pavarur të pakicës për të vënë në levizje organin suprem të partisë, pa paragjykuar vendimmarrjen e tij.

Nëse Kuvendi Kombëtar do të kishtë barazuar thirrjen nga pakica me propozimin nga kryetari, duke in nënshtruar vendimmarrjes se Këshillit Kombëtar ose Kryesisë, jo vetëm do të zhbëhej e drejta e

pavarur e pakicës, por do t'i nënshtrohej vullnetit të një organi në konflikt eventual interesi që do ta bllokonte. Në këtë rast formulimi do të ishte në një fjali të vetme.

Vendosja në një fjali të pavarur dhe lidhëza "edhe" bën dallimin që thirrja e Kuvendit nga 1/4 e anëtarëve apo e delegatëve është thirrje nga pakica, siç parashikon doktrina dhe praktika legjislative, është e pavarur nga vullneti i organeve të tjera, është mekanizëm vetëthirrjeje i Kuvendit dhe është forme alternative e thirrjes.

Në të dy format e thirrjes, statuti i 17 Korrikut 2021, ashtu si legjislacioni tjetër i përmendur më sipër, vendos tre elemente të detyrueshëm, caktimi dhe publikimi i :
i) datës për thirrjen e kuvendit;
ii) afati 30-ditor nga momenti i thirrjes deri në datën e caktuar;
iii) rendi i ditës i përcaktuar paraprakisht.

Këto elemente të formës kanë rëndësi jo vetëm për transparencën, por edhe për marrjen dijeni në kohë të mjaftueshme të çështjeve për diskutim nga korpusi vendimmarres, delegatët që ftohen në mbledhje. Thirrja e jashtëzakonshme e ndjekur për mbledhjen e Kuvendit të datës 11 Dhjetor 2021 ndoqi mënyrën e thirrjes nga 1/4 e delegatëve. Kjo lloj thirrje ka dy aspekte themelore:

1. ***Aspekti cilësor** të drejtën e thirrjes e kanë vetëm delegatët, pra ata anëtarë që kanë një funksion që sipas statutit i jep ex officio edhe mandatin e delegatit.*
2. ***Aspekti sasior**-duhet që thirrjen ta kërkojnë jo më pak se 1/4 e delegateve.*

Plotësimi i këtyre kushteve si dhe caktimi i datës në një afat jo më herët se 30 dite nga momenti i thirrjes dhe caktimi i rendit të ditës, janë kushtet e mjaftueshme për të thirrur Kuvendin.

Gjykata e gjen me vend të theksojë se të njëjtat dispozita dhe mekanizma të përshkruara me sipër, për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH gjenden të pasqyruara edhe në statutet e paraardhëse të PDSH, konkretisht atij të 29 Prillit 2018 ku të njëjtat parashikime te formuluara në mënyrë identike, gjendeshin në nenin 47 pika 4 dhe 6 të tij, çka vërteton një mekanizëm të konsoliduar në vite dhe të konfirmuar në tërësi pavarësisht ndryshimeve statutore të viteve të fundit,

b) Procedura e ndjekur për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë së datës 11/12/2021

Rezulton nga materialet e depozituara në dosje, se një grup deputetësh dhe politikanësh të tjerë të Partisë Demokratike, në datën 10 Nëntor 2021 kanë depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PD më shumë se 4200 formularë kërkesash të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në orën 11.00.

Kjo procedurë është zhvilluar në përputhje me pikën 2, të nenit 43 të Statutit të PDSH-së, në fuqi në momentin e thirrjes së Kuvendit Kombëtar, i cili parashikon gjartësisht mbledhjen e organit më të lartë drejtues të Partisë Demokratike të Shqipërisë me kërkesë të një numri anetarësh dhe delegatësh të Kuvendit Kombëtar më të madh se e gjithë përbërjes të tij. Në rastin konkret numri i formularëve të kërkesave të paraqitura (4200) e tejkalon ndjeshëm numrin e kërkesave të nevojshme për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, i cili, për shkak se përbëhet nga 7646 delegatë mund të thirret në mënyrë të ligjshme kur këtë e kërkojnë jo

më pak se 1912 anëtarë të tij, (Gjykata për këtë qëllim administroi dhe vlerësoi provën nr.24 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022)

Në përputhje me të njëjtën dispozitë statutore, nenin 43 pika 2 të Statutit të PDSH, data, ora e zhvillimit të Kuvendit si dhe rendi i ditës, ishin pjesë e kërkesës së delegatëve nënshkrues dhe thirrës së Kuvendit.

Këto të dhëna, të cilat Statuti i PDSH, kërkon në mënyrë të detyrueshme që të komunikohen të paktën një muaj përpara ditës në të cilën thirret Kuvendi Kombëtar, u bënë të njohura për të gjithë publikun me mjetet e informimit publik, njoftime në televizione kombëtare, konferenca shtypi, portale e rrjete sociale menjëherë pas njoftimit drejtuar Kyetarit të Këshillit Kombëtar si më sipër, (Gjykata për këtë qëllim administroi dhe vlerësoi provat nr. 9, nr. 10, nr.11 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022).

Rendi i Ditës i Kuvendit Kombëtar, në përputhje me kompetencat e tij, sipas nenit 43 te Statutit, ishte si më poshtë:

- *Miratimi i ndryshimeve statutore, sipas propozimeve konform nenit 43/4 dhe 60 të Statutit të PDSH për rivendosjen dhe garantimin e demokracisë në vendimarrjen në forumet e Partise Demokratike.*
- *Analiza e qëndrimeve dhe akteve të Kryetarit Basha ndaj parimeve themelore, e normave të statutit dhe ndaj forumeve të Partisë Demokratike*
- *Vendimarrje sipas ndryshimeve statutore të propozuara dhe thirrja e referendumit të antareve të Partisë Demokratike për të miratuar vendimet e Kuvendit Kombetar të Partisë Demokratike.*
- *Përcaktimi i aksionit politik opozitar të Partisë Demokratike të Shqipërisë*
- *Të ndryshme*

Nga sa më sipër rezulton që nga pikëpamja proceduriale dhe e përputhshmërisë së procedurave të aplikuara nga kërkuesit në raport me parashikimet e nenit 43 të statutit të Partisë Demokratike, procedura e ndjekur është në përputhje të plotë me parashikimet urdhëruese statutore, përsa i përket:

- *Numrit minimal të nevojshëm të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të cilët kërkojnë mbledhjen e Kuvendit Kombëtar:*
- *Afatit kohor brenda të cilit duhet paraqitur kërkesa për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar:*
- *Elementet minimale të cilët duhet të përmbajë kërkesa për mbledhje të Kuvendit Kombëtar, si dita, ora, vendi, rendi i ditës....*

Statuti i PDSH në asnjë dispozitë të tij, nuk parashikon organin të cilit kërkuesit mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, duhet t'i drejtojnë kërkesën për mbledhjen e tij, në rastet kur mbledhja e Kuvendit kërkohet nga anëtarësia.

Përsa më sipër, edhe në këtë aspekt, formalizimi i këtyre kërkesave dhe përcjellja e tyre pranë Kryetarit të Këshillit Kombëtar, organ ky i cili në bazë të nenit 44 të statutit përcaktohet si organi më i lartë i cili drejton veprimtarinë politike të partisë në periudhën midis dy Kuvendeve, është në vlerësim të gjykatës i ligishëm dhe i pa kontestueshëm.

Pas verifikimit të aspekteve proceduriale të mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, Gjykata ka hetuar cilësitë e kërkuesve të mbledhjes së tij. Paragrafi i parë i nenit 43 të statutit të PDSH përmban një listë shteruese funksionarësh të cilët përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH.

Për shkak se, në secilin nga mbi 4200 formularët e kërkesave të depozituara për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, nënshkruesit e identifikonin veten, përveçse me gjeneralitetet përkatës, edhe me funksionin të cilin mbanin në strukturat e Partisë Demokratike, gjykata verifikoi në radhë të parë se secili nga funksionet e nënshkruesve përfshihej në listën e funksioneve, të cilat përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH, sipas nenit 43 pika 1 të statutit të PDSH.

Gjithashtu, gjykata verifikoi edhe nëse shtetasit nënshkrues të thirrjes së Kuvendit Kombëtar përfshiheshin në listën emërore të funksionarëve të PDSH te cilët, në momentin e thirrjes së tij, përbënin listën e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Për këtë qëllim gjykata pasi administroi provat shkresore, konkretisht provën nr.3, nr. 4 dhe nr. 22 të bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022, vërejti se, listat bashkëngjitur këtyre dokumentave përbëjnë listë të plotë zyrtare dhe të detajuar të shtetasve të cilët përbënin Kuvendin Kombëtar të PDSH, në momentin e thirrjes së tij nga anëtarësia.

Konkretisht, me shkresat e administruara si provat nr. 3 dhe nr.4 të përcjella me kërkesën e palës kërkuese, respektivisht, kryetarja e LDGSH zj. Albana Vokshi dhe Kryetari i FRPD z Belind Kellici, i përcjellin Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH z. Edi Paloka listën zyrtare të delegatëve në Kuvendin Kombëtar të cilët përcaktohen nga organizatat e tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 43, pika 1 gërma e) e statutit të PDSH. Listat e bashkangjitura përbëjnë dokument zyrtar të LDGSH dhe FRPD si organizata partnere të PD, sipas nenit 58 të statutit të PDSH, dhe si të tilla ato merren parasysh nga gjykata.

Gjithashtu, gjykata administroi me cilësinë e provës nr. 22 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 edhe listën e plotë të delegatëve të Kuvendit Kombëtar, përcjellë zyrtarisht Kryetarit të Kuvendit Kombëtar z. Edi Paloka, në datë 11.11.2021 nga ana e Degës nr.3 të Partisë Demokratike Tiranë.

Shkresës zyrtare të kësaj Dege të PDSH, i bashkëlidhet edhe lista e plotë emërore e delegatëve që përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH, e shkarkuar kjo e fundit nga aplikacioni Blu System, aplikacion zyrtar i PDSH. Lista bashkëlidhur është e përcjellë me shkresë zyrtare dhe e vulosur me vulën e degës 3 të PDSH Tiranë, dhe si e tillë i plotëson edhe elementët formalë për tu konsideruar një dokument zyrtar.

Nga verifikimi i kryer nëpërmjet krahasimit të emrave dhe funksioneve të nënshkruesve të thirrjes së Kuvendit Kombëtar, me listat e sipërcituara rezulton se, nënshkruesit e formularëve të kërkesave të thirrjes së Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 janë anëtarë/delegatë të këtij organi, për shkak të funksionit, që gjithsecili prej tyre mban.

Përsa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike është thirrur në mënyrë të ligjshme nga një numër anëtarësh/delegatësh më i madh se e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij.

Pas verifikimit të ligjshmërisë së thirrjes së Kuvendit Kombëtar, për të vlerësuar ligjshmërinë e mbajtjes së tij dhe të marrjes së vendimeve përkatëse, të cilat kërkohet të regjistrohen, Gjykata administroi provat nr. 18, nr. 19 dhe nr. 23 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 përkatësisht

proces-verbalin e punimeve të Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 të firmosur nga 5 anëtarët e Komisionit Drejtues të Punimeve të Kuvendit dhe 3 anëtarë e Sekretariatit Teknik, materialin e plotë filmik të punimeve të Kuvendit të përmbajtur në një USB, si dhe raportin e plotë teknik të kompanisë së specializuar të IT e cila ka menxhuar sistemin elektronik të identifikimit dhe mbikëqyrjes se aksesit të delegatëve në ambientet në të cilat janë zhvilluar punimet e Kuvendit.

Të tre këto dokumente, të cilat i janë paraqitur gjykatës në formën e kërkuar nga ligji, përbëjnë provë të plotë për të vërtetuar faktin dhe për t'i formuar Gjykatës bindjen se, Kuvendi Kombëtar i PDSH është mbledhur në mënyrë të ligjshme dhe në ambientet e stadiumit "Air Albania", ku janë zhvilluar punimet e tij, në pjesën e dedikuar të delegatëve të Kuvendit, kanë marrë pjesë 4935 delegate, prezenca fizike e të cilëve ka bërë që Kuvendi të ketë kuorumin e nevojshëm që ky organ të konsiderohet i mbledhur dhe të mbajë punime e të marrë vendime në mënyrë të ligjshme në përputhje me dispozitat statutore.

Një vemendje të veçantë, gjykata i ka kushtuar edhe vlerësimit te formalizimit të organit i cili drejton punimet e Kuvendit Kombëtar, për shkak të parashikimit të veçantë, të këtij momenti në statutin e PDSH.

Fjalia e fundit e paragrafit të dytë të nenit 43 te Statutit të PDSH, parashikon se "Punimet e Kuvendit drejtohen nga nje Komision i perbere nga 5 anetare, i cili zgjidhet ne fillim e punimeve te tij, me propozim të Kryetarit të Partisë"

Gjykata e vlerëson këtë parashikim, jo si një të drejtë por si një përgjegjësi, e cila i ngarkohet Kryetarit të partisë, për të propozuar një Komision i cili pasi aprovohet nga Kuvendi drejton punimet e këtij të fundit. Mosushtrimi i kësaj përgjegjësie, në vlerësimin e gjykatës, nuk pengon organin më të lartë drejtues të PDSH, Kuvendin Kombëtar, në ushtrimin e sovranitetit tij dhe në emërimin e një Komisioni me 5 anëtarë që drejtojnë punimet e Kuvendit.

Për këtë nevojitet që, sipas dispozitave satutore, së paku Kryetarit të partisë t'i garantohet mundësia për të propozuar Komisionin drejtues të punimeve. Në vijim, ushtrimi ose mosushtrimi i kësaj përgjegjësie nga ana e Kryetarit të PDSH nuk cënon të drejtën e pakufizuar të Kuvendit Kombëtar, për të përcaktuar me votë komisionin që drejton punimet e Kuvendit.

Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata ka administruar provën nr. 5 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 "Njoftim për ushtrimin e detyrimeve statutore per mbarëvajtjen e Kuvendit Kombetar" drejtuar z. Lulzim Basha nga një grup deputetësh përfaqësues të anëtarëve të cilet thërrasin Kuvendin Kombëtar, si dhe mandatin postar bashkëlidhur

Nga shyrtimi i këtij dokumenti shkresor, i paraqitur nga kërkuesi në formën e kërkuar nga ligji, rezulton së në datën 09.12.2021 një grup deputetësh përfaqësues të anëtarëve që kanë kërkuar mbledhje e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 kanë vënë në dijeni zyrtarisht Kryetarin e PDSH mbi përgjegjësinë e tij për të përcaktuar 5 anëtarë të Komisionit që drejton punimet e Kuvendit, dhe po në të njëjtën ditë, sipas mandatit postar, kjo shkresë është dorëzu pranë punonjësit të protokollit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Pavarësisht kësaj, ashtu si rezulton edhe nga proces-verbali i mbledhjes së punimeve të Kuvendit të datës 11.12.2021 si dhe nga materiali filmik i administruar, deri në çeljen e punimeve të tij, Kuvendit Kombëtar nuk është paraqitur asnje propozim nga Kryetari i PDSH për

përcaktimin e anëtarëve të Komision drejtues të punimeve. Në kushtet e konstatimit të mosushtrimit të kësaj përgjegjësie statutore nëpërmjet mungesës së një përgjigje shkresore si dhe të mospjesëmarrjes së Kryetarit të PDSH në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, Kuvendi Kombëtar me propozim të Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH z.Edi Paloka, i cili çeli edhe Kuvendin, miratoi me votim të hapur dhe me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij një Komision të drejtimit të punimeve të tij të përbërë nga 5 anëtarë, si dhe një sekretariat teknik, sipas përbërjes së reflektuar në proces-verbalin e punimeve të Kuvendit Kombëtar dhe akteve të tjera të dala prej tij.

Në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve të marra, në Kuvendin Kombëtar të PDSH të datës 11/12/2021, Gjykata vlerëson se duhet të verifikojë procedurën dhe mënyrën e marrjes së vendimve për të cilat kërkohet regjistrimi i tyre, veçanërisht i Vendimit nr.1 dt. 11.12.2021 i cili miraton Statutin e ri të PDSH, dhe më pas edhe 6 vendimarrjet e tjera në vijim, veçanërisht, në kushtet kur për miratimin e Vendimit nr 1. Dt. 11.12.2021 baza ligjore dhe procedura e ndjekur janë ato të përshkruara statutin e PDSH të miratuar në Korrik 2021, ndërsa baza ligjore dhe procedura e ndjekur për vendimet e mëpasme është ajo e përcaktuar në statutin e miratuar në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, i cili hyri menjëherë në fuqi për vullnet të Kuvendit Kombëtar, në mënyrë analoge me statutet e mëparshme të kësaj force politike.

Rezulton nga proces-verbali i mbledhjes se punimeve të Kuvendit Kombëtar, nga materiali i plotë filmik i punimeve të Kuvendit, si dhe nga provat e tjera shkresore, veçanërisht ato të administruara së bashku me vendimin nr. 1 dt.11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar, por edhe ato të provave nr. 2, nr.6 dhe nr.7 te bashkangjitura kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 se, Komisioni i drejtimit të punimeve të Kuvendit, administroi një kërkesë të paraqitur në përputhje me nenet 43, dhe 60 te Statutit të PDSH-së, si më poshtë:

- *Kërkesë dhe draft Statutin (ndryshime në Statut) e propozuar nga 1/4 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të PDSH, (firmat mbështetëse të 138 anëtarëve të Këshillit Kombëtar sipas provave nr. 2 dhe nr.6) dhe të mbështetura nga 15% e anëtarësisë së Kuvendit Kombëtar (firmat sipas provave nr.7), i cili u regjistrua nga Komisioni me nr. 1, date 11.12.2021 në proces-verbalin e punimeve të Kuvendit.*

Rezulton se ndryshimet ishin hartuar nga propozuesit dhe vinin në formë të reflektimit të tyre në statutin ekzistues, prandaj dispozitat statutore të propozuara për votim, ishin drejtpërsëdrejti dispozitat statutore të ndryshuara.

Pavarësisht bashkëlidhjes, te propozimet për ndryshimet statutore, të firmave mbështetëse të anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe delegatëve të Kuvendit, gjithsesi Komisioni për drejtimin e punimeve të Kuvendit fillimisht kërkoi mbështetjen publike të delegatëve të Kuvendit Kombëtar për kërkesën për ndryshime në Statutin e PDSH. Në përputhje me pikën 1. të nenit 19 të Statutit, votimi u bë i hapur duke ngritur dorën ose mandatin dhe duke konfirmuar mbështetjen unanime të delegatëve të Kuvendit Kombëtar për ndryshimet statutore.

Komisioni më pas, hodhi në votim në parim, nen për nen dhe në tërësi ndryshimet në Statutin e PDSH, dhe Kuvendi Kombëtar, me shumicë votash, në prani në e më shumë se gjysmës së anëtarëve të

Kuvendit Kombëtar, votoi pro në parim, nen për nen dhe në tërësi ndryshimet në Statut të paraqitura nga një grup anëtarësh të Këshillit Kombëtar të PDSH të cilët përfaqësojnë 1/4 e gjithë anëtarësisë së tij, si dhe me mbështetjen e të paktën 15% të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Në përputhje me pikën 1, të nenit 19 të Statutit, votimi u be i hapur duke ngritur dorën ose mandatin.

Vendimarrjet vijuese të Kuvendit Kombëtar të PDSH, konkretisht Vendimet nr.2-nr.7 u morën sipas parashikimeve të reja statutore të miratuara me vendimin nr. 1 dt.11.12.2021 1 Kuvendit Kombëtar, ashtu si edhe rezulton nga proces-verbali i punimeve të Kuvendit si dhe nga materiali i plotë filmik i punimeve të Kuvendit të paraqitur nga kërkuesi me cilësinë e provës.

Gjithashtu me cilësinë e provës, bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022, kërkuesi paraqiti edhe provat nr. 20 dhe 21, të cilat konsistojnë në prova shkresore përkatësisht të ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Organizimit dhe Kontrollit Operacioneve Elektorale të PDSH sipas statutit të miratuar në mbledhjen e dt. 11.12.2021, si dhe Vendimin nr.5 me nr. Prot.12 dt.19/12/2021, miratuar nga Komisioni i Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale. Ky i fundit ka bashkëngjitur edhe tabelën e rezultateve përfundimtare të referendumit të ratifikimit të Vendimit nr. 6 dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar, për shkarkimin e z. Lulzim Basha nga funksioni i Kryetarit të PDSH.

Provat e mësipërme perfeksionojnë ligjërisht dhe nga pikëpamja statutore Vendimin nr. 6. dt. 11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar të PDSH, pasi për vullnet të shprehur të këtij organi, dhe bazuar mbi statutin e PDSH, kjo vendimarrje ishte përcaktuar për tu miratuar me referendum nga gjithë anëtarësia e PDSH.

Përsa më sipër gjykata vlerëson se, procedurat e ndjekura për propozimin dhe miratimin e vendimeve të Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021, janë në përputhje të plotë me parashikimet statutore në fuqi në momentin e miratimit të tyre, dhe praktika dokumentare shoqëruese e këtyre vendimarrjeve është e plotë dhe e pakontestueshme.

Vendimet e marra në Kuvendin Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021 janë vendime të marra në përputhje të plotë me tagrin dhe kompetencat statutore të Kuvendit Kombëtar të PDSH, si organi më i lartë vendimarrës i kësaj force politike dhe si të tilla ato duhet të regjistrohen në regjistrin e partive politike.

Vendimet e mësipërme përcaktojnë edhe ndryshime thelbësore në formatimin dhe përbërjen e organeve qëndrore drejtuese të PDSH dhe si të tilla përmbajtja e tyre duhet të reflektohet përkatësisht edhe në përbërjen e organeve qëndrore drejtuese të PDSH të regjistruara në regjistrin e partive politike."

V. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

5.1. Mbi ankimin ndaj vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Nga aktet në dosjen gjyqësore, rezulton se Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit ka ushtruar ankim të veçantë ndaj vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim me të cilin është disponuar për:

- *"Pranimin e ankimit të palës ankuese Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga nënkryetari i saj z. Enkelejd Alibeaj, ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- *Kundër vendimit nuk lejohet ankim."*

Në ankimin e veçantë Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, kërkon shprehimisht: *"Prishjen e vendimit nr. 508 akti datë 22.04.2022, duke vendosur "Mospranimin e ankimit të palës ankuese Partia Demokratike e Shqipërisë të përfaqësuar nga nënkryetari z Enkelejd Alibeaj ndaj vendimit nr. 3 datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*

Konstatohet formulim kontradiktor i objektit të ankimit nga ankuesi. Ndërsa ankuesi kërkon shprehimisht "prishjen e vendimit të ankimuar" nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkon gjithashtu shprehimisht që Gjykata e Apelit pasi të shqyrtojë ankimin të vendos për "mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë". Këto dy kërkime janë kontradiktore, pasi disponimi për "mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë" përbën disponim në thelb për ndryshimin e vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kursesi ky disponim nuk barazohet proceduralisht me disponimin "për prishjen e këtij vendimi". Përtej këtij konstatimi, rezultoi se në seancë gjyqësore, pala ankuese kërkoi shprehimisht që Gjykata e Apelit pasi të shqyrtonte ankimin e veçantë, të shprehej për mospranimin e ankimit të ushtruar ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ankim ky i fundit i lejuar me vendimin nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra të disponohej për ndryshimin e këtij të fundit.

Shkaqet ligjore për kundërshtimin e vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim me objekt "disponim ankimi", nga pala ankuese PDSH, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, u parashtruan si më sipër cituar, në rubrikën "I" të këtij vendimi. Referuar natyrës së shkaqeve ligjore të renditura në përmbajtje të ankimit të veçantë, ato rezultojnë të jenë si shkaqe që lidhen me gabime në procedim, ashtu edhe shkaqe ligjore që lidhen me gabime në gjykim, pra me vlerësimin ligjor që Gjykata ka realizuar në vendimin e saj. Këto dy kategori shkaqesh, për nga natyra e tyre, referojnë si në kërkimin për "prishjen e vendimit të ankimuar", ashtu edhe në kërkimin për "ndryshimin e vendimit të ankimuar".

Gjykata e Apelit vlerëson se ka vend për shqyrtimin e *pranueshmërisë së ankimit të veçantë* të ushtruar nga PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit ndaj vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në raport me parashikimet në nenin 450 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësim procedural ky që i paraprin marjes në shqyrtim në themel të ankimit të veçantë dhe shkaqeve ligjore të parashtruara në të. Ky vlerësim ushtrohet bazuar në parashikimin në nenin 450/3 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet se: *"Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi"*.

Rrethanat apo kushtet ligjore që përcaktojnë pranueshmërinë apo papranueshmërinë e ankimit në procesin civil, renditen në nenin 450/1 të Kodit të Procedurës Civile. Këto janë shkaqe, të cilat verifikohen si nga gjykata që ka dhënë vendimin që ankimohet, ashtu edhe nga gjykata së cilës i drejtohet ankimi, madje duke qënë kjo e fundit e pakushtëzuar në vlerësimin e saj ligjor të pranueshmërisë së ankimit nga vlerësimi që gjykata që ka dhënë vendimin ka realizuar. Konkretisht neni 450 i Kodit të Procedurës Civile i titulluar "mospranimi i ankimit" parashikon:

"Mospranimi i ankimit
1. Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin, në dho në këshillimi, menjëherë pas paraqitjes së ankimit, vendos mospranimin e ankimit kur:
a) është paraqitur jashtë afatit;
b) nuk ndreqen të metat në afatin e caktuar sipas nenit 455 të këtij Kodi;
c) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim;
ç) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;
d) është hequr dorë nga ankimi.
2. Kundër vendimit të <u>mospranimit të ankimit</u> mundet të bëhet <u>ankim i veçantë</u>.
3. Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në <u>çdo shkallë gjykimi</u>."

Mjafton ekzistenca e një prej kushteve ligjore nga ato neni 450/1 i Kodit të Procedurës Civile parashikon, për të prodhuar pasojën juridike procedurale të papranueshmërisë së ankimit të ushtruar.

Në rastin konkret, konstatohet se ankimi i veçantë është ushtruar ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë që ka disponuar mbi pranueshmërinë e ankimit të ushtruar ndaj vendimit që po ajo gjykatë ka disponuar, vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rregjistrimin e ndryshimeve statutore. Me konstatimin e këtij fakti, Gjykata e Apelit vlerëson kryesisht, nëse vendimi nr. 508 akti, datë 22.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt "disponim ankimi", është vendim ndaj të cilit mund të ushtrohet ose jo ankim i veçantë, duke verifikuar kështu në drejtim të kushtit ligjor të parashikuar në gërmën "c" të paragrafit "1" të nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile. Për realizimin e këtij vlerësimi ligjor, Gjykata i referohet edhe parashikimeve ligjore në nenet 450/a dhe 452 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 450/a të Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Gjykata, kur pranon kërkesën, i komunikon kopjen e saj palës tjetër, ndërsa aktet e çështjes bashkë me ankimin, ia dërgon gjykatës së apelit të nesërmen e mbarimit të afatit të ankimit për të gjitha palët ose edhe përpara mbarimit të këtij afati, kur nga të gjitha palët janë paraqitur ankimet."

Neni 452 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkalles se parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj."

Nga vlerësimi sistematik i neneve 450, 450/a dhe 452 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Apelit konstaton se:

Vendimi për "pranimin e ankimit" i disponuar nga gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit ushtrohet ankimi në bazë të kompetencës së njohur në nenin 450 të K.P.C., është vendim ndaj të cilit nuk mund të ushtrohet ankim i veçantë.

Neni 450/2 i Kodit të Procedurës Civile ka njohur dhe lejuar ankimin e veçantë vetëm ndaj vendimit që disponon për "mospranimin e ankimit" në shkallë të parë. Ligjvënënësi e ka bërë përjashtimin e ankimit të veçantë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për "pranimin e ankimit" , duke parashikuar në mënyrë të shprehur se në cilin rast lejohet ankim i veçantë, duke e lidhur atë shprehimisht vetëm me vendimin që ka vendosur "mospranimin e ankimit". Në invers apo interpretim "a contrario", ligjvënësi duke bërë këtë parashikim, ka nënkuptuar qartazi se nuk lejohet ankim i veçantë në rast të disponimit të kundërt nga gjykata e shkallës së parë për "pranim ankimi". Ky rregjim i diferencuar juridik, lidhet me natyrën e vendimit ashtu edhe me natyrën pasojave juridike që prodhon ai në secilin nga këto dy raste disponimesh. "Mospranimi i ankimit" përbën disponim me natyrë vendimtare në drejtim të kufizimit të së drejtës së ankimit, disponim i cili mbi të gjitha rezulton nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin, si i tillë ai do të duhet të rivlerësohet nga gjykata e juridiksionit më lart, si një garanci kjo për proces të rregullt ligjor dhe specifikisht për të garantuar drejtën kushtetuese, konventore dhe ligjore të ankimit kundrejt mundësisë së kufizimit të padrejtë të saj (neni 43 i Kushtetutës, neni 13 i KEDNJ-së). Rasti i kundërt i disponimit, për "pranim ankimi" është vendimarje, e cila në raport me të drejtën kushtetuese dhe konventore të ankimit, nuk pasjell kufizimin e saj, përkundrazi efekt juridik i drejtëpërdrejtë i këtij vendimi, është fitimi i juridiksionit kontrollues nga një gjykatë më e lartë ndaj vendimit gjyqësor të themelit, kontroll pjesë e të cilit është edhe ri-vlerësimi i pranueshmërisë së ankimit po sipas rrethanave dhe kushteve ligjore që renditen në nenin 450/1 të K.P.C., vlerësim pa të cilin nuk mund të vijohet me shqyrtimin në themel të ankimit dhe shkaqeve ligjore në përmbajtje të tij nga gjykata e apelit.

Natyra e vendimit të gjykatës së shkallës së parë kur disponon për "pranim ankimi", është e një lloji të veçantë "sui generis", për shkak të këtyre specifikave:

- Vendimi për lejimin e ankimit, përbën vendim menjëherë të ekzekutueshëm, rrethanë e cila rezulton nga përmbajtja e nenit 450/a të K.P.C. në të cilin parashikohet se: *"Gjykata, kur pranon kërkesën, i komunikon kopjen e saj palës tjetër, ndërsa aktet e çështjes bashkë me ankimin, ia dërgon gjykatës së apelit të nesërmen e mbarimit të afatit të ankimit për të gjitha palët ose edhe përpara mbarimit të këtij afati, kur nga të gjitha palët janë paraqitur ankimet"* Disponimi nga gjykata e shkallës së parë për pranimin e ankimit, pasjell zbatimin e tij të menjëhershëm, duke u proceduar me përfundimin e procedurës administrative të njoftimit te ankimit ndaj palës tjetër, ashtu edhe dërgimin e fashikullit të gjykimit të vendimit gjyqësor të themelit së bashku me ankimin në gjykatën më lart (gjykatën e apelit).

- Gjykata pranë së cilës përcillet ankimi, është gjykatë e cila në kompetencën e saj funksionale shqyrton ankimin jo thjesht dhe vetëm në themelin e tij, por edhe në drejtim të pranueshmërisë së tij sipas kushteve ligjore që neni 450/1 i Kodit të Procedurës Civile parashikon. Vlerësimi formal që Gjykata e Apelit realizon ndaj ankimit sipas nenit 450/1 dhe 450/3 të K.P.C. është vlerësim që realizohet në mënyrë të pavarur, pa u përcaktuar dhe pa qënë i detyruar nga vlerësimi që gjykata e shkallës së parë ka realizuar në këtë drejtim ndaj ankimit. Ky vlerësim ligjor procedural i ankimit i paraprin në çdo rast shqyrtimit në themel të tij, duke përbërë kështu një ri-kontroll të lëndës së vlerësimit që është realizuar me vendimin e gjykatës së shkallës së parë me objekt disponimi "pranim ankimi". Pra vetë formati i gjykimit në apel përfshin në të ri-kontrollin e pranueshmërisë së ankimit sipas nenit 450 të K.P.C. në çdo rast dhe për çdo lloj ankimi që është rregjistruar pranë kësaj gjykate, duke konfirmuar kështu mungesën e domosdoshmërisë së ankimueshmërisë së veçantë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë që disponon për "pranim ankimi".

- Shkak tjetër ligjor që pasjell rregjimin juridik të mungesës së ankimueshmërisë së veçantë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për "pranimin ankimi", duke qëndruar brenda nocionit "ratio legis" të dispozitës, në vlerësimin e Gjykatës së Apelit, është edhe natyra e efekteve juridike të menjëhershme ekzekutuese të këtij vendimi, efekte të cilat vlerësohen të jenë kryesisht të natyrës juridike-administrative dhe procedurale. Ky vendim kursesi nuk ka as efektin dhe as potencialin juridik të përcaktojë pranueshmërinë e ankimit nga gjykata më lart

(gjykata e apelit) si gjykatë e specializuar në shqyrtimin e ankimeve. Pasojat juridike që ky vendim sjell janë: *së pari*, pasoja juridike administrative, për sa ai zbatohet dhe i kundërdrejtohet sekretarisë gjyqësore për efekt të vijimit të procedurës administrative të komunikimit të ankimit palëve të tjera ndërgjyqëse në procesin e themelit, si dhe të procedurës së dërgimit të fashikullit të gjykimit dhe ankimit nga gjykata e shkallës së parë në gjykatën e apelit; *së dyti*, janë pasoja vetëm procedurale, për sa mbi bazën e këtij vendimi Gjykata e Apelit fiton juridiksion kontrollues, të drejtën e fillimit të ushtrimit të kompetencës së saj funksionale në drejtim të kontrollit gjyqësor ndaj ankimit, kontroll që realizohet në dy drejtime, kontrolli i pranueshmërisë dhe kontrolli i themelit të ankimit. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për "pranim ankimi" apo shprehur ndryshe alternativisht "lejim ankimi", nuk ka efektin "gjë e gjykuar" sipas nenit 451/a të K.P.C. në lidhje me sa është disponuar në të, kundrejt vlerësimit ligjor që gjykata e apelit mund të bëjë në lidhje me pranueshmërinë e ankimit.

Për shkak të fushës së kufizuar të efekteve juridike që pasjell vendimi i gjykatës së shkallës së parë për "pranimin e ankimit", ky vendim nuk është parashikuar nga ligjvënësi në Kod si vendimarje, e cila në vetvete do t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor posaçërisht nga gjykata e apelit, pra nuk është parashikuar si vendimarje e ankimueshme. Efektet juridike që ka sjellë vendimarja e gjykatës së shkallës së parë për "pranim ankimi", sikurse më sipër identifikuar, janë efekte të cilat kanë ardhur dhe janë ekzekutuar, ankimi i është njoftuar palës tjetër, dosja dhe ankimi janë depozituar dhe rregjistruar në gjykatën e apelit. Efektet juridike të kësaj vendimarje të gjykatës së shkallës së parë vijojnë vetëm deri në momentin që çështja rregjistrohet në gjykatën e apelit, pra deri në momentin që juridiksioni kontrollues i Gjykatës së Apelit fillon të ushtrohet prej saj, duke qënë më pas kjo e fundit përcaktuesja dhe vendimarësja në drejtim të vlerësimit të pranueshmërisë së ankimit sipas nenit 450/1 të K.P.C. Si i tillë vendimi për "pranimin e ankimit" ka tiparet e një vendimi të ndërmjetëm të një lloji të veçantë. Gjykata e apelit mund të disponojë ndryshe prej tij, po sipas nenit 450/1 të K.P.C. dhe në këtë rast vendimi i gjykatës së apelit është vendimtar në pasojat juridike që sjell ndaj së drejtës së ankimit, pa qënë nevoja të kontrollojë dhe të bëjë objekt vlerësimi dhe disponimi të saj vendimin e gjykatës së shkallës së parë "për pranim ankimi/lejim ankimi".

Në vijim të këtij konstatimi, Gjykata i referohet neneve 443, 470 dhe 471 të Kodit të Procedurës Civile, si dispozita ku trajtohet dhe rregullohet instituti i "ankimit të veçantë". Konkretisht në këto dispozita parashikohet se:

Neni 443 i Kodit të Procedurës Civile:

"Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë.
Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë. Afati për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kundërshtimin e të tretit është 30 ditë.
Afati i ankimeve dhe rekurseve të veçanta është 5 ditë."

Neni 470 i Kodit të Procedurës Civile:
"Ankimi kundër vendimeve të ndërmjetme
1. Vendimet e ndërmjetme që jepen nga gjykata e shkallës së parë mund të ndryshohen ose të tërhiqen gjatë gjykimit. Këto vendime mund të goditen me ankim së bashku me vendimin përfundimtar.
2. Megjithatë, në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit ose rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i tyre.
3. Ankimet ose rekurset e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë."

Neni 471/a i Kodit të Procedurës Civile:
"Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve jopërfundimtare
Ankimet dhe rekurset e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë."

Referuar parashikimeve në nenet 443, 470 dhe 471 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se "ankim i veçantë" njihet si mjet ligjor për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të natyrës së ndërmjetme dhe atyre me natyrë jopërfundimtare. "Ankimi i veçantë" nuk është mjet ligjor për kundërshtimin e vendimeve me natyrë përfundimtare. Duke marë shkas nga ky kategorizim mjetesh ankimi në raport me natyrën e vendimit objekt ankimimi, rezulton se fakti që Kodi i Procedurës Civile ka rregulluar dhe parashikuar "ankimin e veçantë" ndaj vendimit të mospranimit të ankimit të disponuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, konfirmon më tej konstatimin e sipërcituar, sipas të cilit vendimi për pranimin apo mospranimin e ankimit të disponuar nga gjykata që ka dhënë vendimin, përbën vendim të ndërmjetëm, por të një lloji të veçantë. Kursesi ai nuk është vendim i natyrës përfundimtare.

Vendimet e ndërmjetme janë vendime, të cilat si rregull kundërshtohen së bashku me vendimin përfundimtar dhe përjashtimisht ato kundërshtohen me ankim të veçantë, vetëm nëse në Kod në mënyrë të shprehur parashikohet "ankimi i veçantë". Në rastin konkret, Kodi në nenin 450/2 ka parashikuar ankimin e veçantë vetëm ndaj vendimit të gjykatës që ka disponuar për "mospranimin e ankimit". Në mungesë të një parashikimi të shprehur "ankimi të veçantë" ndaj vendimit për "pranimin e ankimit" të disponuar nga gjykata që ka dhënë vendimin, rezulton

se ky mjet ligjor ankimimi nuk mund të ushtrohet ndaj këtij lloj vendimi. Mirëpo për shkak të natyrës së veçantë të tij, vendimi "për pranim ankimi" nuk është i ankimueshëm as me ankim të veçantë dhe as së bashku me vendim përfundimtar, pasi vendimi përfundimtar në rastin konkret është vetë vendimi që disponon gjykata e apelit në përfundim të shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit të themelit. Për shkaqet si më sipër cituar, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për "pranim/lejim ankimi", si vendim i ndërmjetëm i natyrës së veçantë, nuk ka arsye ligjore të kontrollohet nga gjykata e apelit, për sa lënda apo fusha e vlerësimit të këtij vendimi gjyqësor, është lëndë gjykimi dhe rivlerësimi posaçërisht në kompetencën funksionale të gjykatës së apelit, pa qënë e detyruar, përcaktuar apo ndërvarur kjo e fundit nga vlerësimi që Gjykata e Shkallës së Parë ka realizuar në vendimin për "pranim /lejim ankimi". Për rrjedhojë pasojat që sjell vendimi i gjykatës së shkallës së parë "për pranim ankimi" nuk përbëjnë "gjë të gjykuar" për gjykatën e apelit, për sa pranueshmëria e ankimit është vlerësim në kompetencën funksionale të gjykatës së apelit. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për "pranim/lejim ankimi" ka synuar vetëm në krjimin e pasojave juridike-administrative dhe procedurale, të cilat janë të ezaruara që me rregjistrimin e ankimit në gjykatën e apelit, pa filluar ende shqyrtimi i pranueshmërisë së ankimit nga Gjykata e Apelit.

Për sa më sipër, në zbatim sistematik të dispozitave të sipërcituara të Kodit të Procedurës Civile nenet 443, 470 dhe 471/a, si dhe në zbatim të parashikimit në nenet 450/2 dhe 452 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se ligjvënësi nuk ka njohur ankim të veçantë ndaj vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim për shkak të natyrës së veçantë të tij, është vendim i pankimueshëm dhe i pakontrollueshëm nga Gjykata e Apelit. Ndodhur përballë kësaj rrethane ligjore, në zbatim të nenit 450/1/ c të K.P.C. dhe 450/3 të K.P.C. Gjykata e Apelit deklaron në vendimin përfundimtar të shqyrtimit të çështjes civile të rregjistruar pranë saj, mospranimin e ankimit të ushtruar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit ndaj vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim.

5.2. Mbi ankimin ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi aktet në dosje, përmbajtjen e ankimit dhe apelit kundërshtues, vlerësoi shkaqet ligjore të paraqitura në to, si dhe dëgjoi shpjegimet e parashtruara në seancë gjyqësore, vlerëson si më poshtë:

5.2.1. Mbi pranueshmërinë e ankimit

Së pari, ankuesi Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar me autorizim të Kryetarit të Partisë nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, gëzon legjitimim në ushtrimin e ankimit ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 442/a të Kodit të Procedurës Civile parashikon:
*"Ankimi është akti me të cilin **palët** ose **pjesëmarrësit e tjerë në proces** parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre."*

Gjykata e Apelit konstaton se kërkues në proces është "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Ankues në këtë proces është "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar me autorizim të Kryetarit të Partisë nga nënkryetari i Partisë. Dukshëm konstatohet se si kërkuesi dhe ankuesi janë i njëjti subjekt i së drejtës, i njëjti person juridik, konkretisht Partia Demokratike e Shqipërisë.

Neni 90 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Palë në një gjykim civil janë personat** fizikë ose **juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi.
Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe."

Neni 91 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Zotësia për të vepruar
***Kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil personat që ushtrojnë lirisht të drejtat, të cilat duhet të respektohen nga të tjerët.** Personat, që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre."*

Subjektet e së drejtës materiale janë personat fizik ose personat juridik, të cilët gëzojnë të drejta dhe detyrime, duke qënë të pajisur kështu me zotësinë juridike ashtu edhe zotësinë për të vepruar në kuptim të ligjit material. Këto subjekte që njihen si të tillë dhe rregullohen nga e drejta materiale, mund të shfaqen në pozitën e "palës" në procesin civil, si subjekte "në emër" apo "kundër" të cilave zhvillohet gjykimi, duke gëzuar kështu secili edhe zotësinë juridike procedurale për të qënë "palë" ndërgjyqëse si dhe zotësinë për të vepruar në procesin civil. "Palë" në procesin civil konsiderohet ai subjekt i së drejtës që përmbush dy kushte ligjore të njëkohshme, *së pari*, është personi fizik apo juridik në emër apo kundër të cilit zhvillohet gjykimi; *së dyti*, është personi fizik apo juridik ndaj të cilit shtrin efektet e tij juridike dhe fuqinë ligjore vendimi gjyqësor i disponuar nga ai proces gjyqësor.

Subjekti i së drejtës në emër të të cilit është zhvilluar gjykimi në shkallë të parë, përfunduar me vendimin nr. 3, datë 25.03.2022 objekt ankimi, është personi juridik "Partia Demokratike e Shqipërisë". Kjo e fundit përbën person juridik të rregjistruar në rregjistrat e partive politike, miratuar me urdhërin nr. 12, datë 19.12.1990 të Ministrisë së Drejtësisë. Është pikërisht ky subjekt i së drejtës, ndaj të cilit synon të sjellë efekte juridike dhe fuqi ligjore vendimi i disponuar nga gjykata e shkallës së parë objekt ankimi, vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndodhemi para të njëjtit subjekt të së drejtës, që shfaqet në pozitën e "kërkuesesit" dhe të "ankuesit", si pasojë e faktit se përfaqësimin e tij e synojnë në procesin civil, si Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, ashtu edhe nënkryetari i Partisë pajisur me autorizim nga Kryetari i Partisë.

Nuk ndodhemi para dy subjekteve të ndryshme të së drejtës apo para dy personave të ndryshëm juridik, por para të njëjtit person juridik, subjekt në lidhje me të cilin paraqiten para gjykatës ***dy pretendues të ndryshëm*** për pozicionin procedural "**të përfaqësuesit**" të tij. Ndërsa Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit pretendon të drejtën e përfaqësimit të PDSH bazuar në ndryshimet statutore të Kuvendit Kombëtar të datës 11 Dhjetor 2021 ende të pavlerësuara këto të fundit në vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e tyre me vendim gjyqësor të formës së prerë, nga ana tjetër nënkryetari i PDSH autorizuar nga kryetari i partisë pretendon tagrin e përfaqësimit të PDSH, bazuar në dispozitat e Statutit të PDSH të rregjistruar në rregjistrin e partive politike për këtë subjekt politik si dhe në nenin 14 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike".

Rezulton se ankuesi PDSH gëzon legjitimim në paraqitjen e ankimit ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi rezulton të jetë personi juridik në emër të të cilit është zhvilluar gjykimi në shkallë të parë, konform përcaktimit që neni 442/a të Kodit të Procedurës Civile realizon. Në ankimin e paraqitur PDSH parashtron kundërshtimet e saj në lidhje me vendimin e disponuar në shkallë të parë, pasi ky vendim ka prekur drejtëpërdrejtë të drejtat dhe interesat ligjore të PDSH. Ky konkluzion për sa më sipër u referua, rezulton të jetë në koherencë edhe me përcaktimet në nenin 90 dhe 91 të Kodit të Procedurës Civile mbi nocionet "palë" në gjykimin civil dhe "zotësi juridike për të vepruar në gjykimin civil", cilësi të cilat i atribuohen në këtë gjykim vetëm një subjekti të vetëm të së drejtës, Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Personi juridik që paraqitet si palë në këtë proces PDSH është "parti politike", si i tillë rregullimi i tij realizohet me ligj të posaçëm, Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike". Për këtë arsye legjitimimi i PDSH në ushtrimin e ankimit ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vlerësohet jo vetëm në raport me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, por edhe në raport me parashikimin në ligjin e posaçëm "Për partitë politike". Rezulton

se legjitimimi i PDSH për të ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar për rregjistrimin e ndryshimeve statutore për subjektin PDSH, buron edhe nga parashikimi në **nenin 15 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike"**, ku përcaktohet se:

*"**Vendimi i Gjykatës për rregjistrimin** apo mosrregjistrimin **e partive politike në rregjistrin e partive politike mund të ankimohet** në gjykatën e apelit të Tiranës, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit"*

Referuar këtij parashikimi ligjor rezulton se:

- Shprehimisht legjislatori në këtë dispozitë parashikon të drejtën e ankimimit edhe ndaj të vendimit "për rregjistrimin", krahas vendimit "për mosrregjistrimin" e ndryshimeve statutore. Ky parashikim i shprehur dhe i qartë, parashikon mundësinë që të kundërshtohet edhe vendimi i rregjistrimit në rregjistrat e partive politike, për sa potencialisht një vendimarrje e tillë mund të prekë apo cënojë të drejtat e subjektit politik.

- Në këtë parashikim ligjor të nenit 15 të Ligjit "Për partitë politike", nuk përcaktohet dhe as nuk kufizohet rrethi i subjekteve që legjitimohen të ushtrojnë ankim ndaj vendimit të rregjistrimit ose mosrregjistrimit.

Referuar këtij parashikimi ligjor të posaçëm nuk evidentohen pengesa apo ndalime ligjore në ushtrimin e së drejtës së ankimit nga PDSH pikërisht ndaj një vendimi gjyqësor rregjistrimi ndryshimesh statutore për subjektin politik PDSH, vendimarje për të cilën PDSH parashtron se ka cënuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të saj si subjekt politik, ndaj të cilit ka synuar të sjellë efekte të drejtëpërdrejta ky vendim. Për sa më sipër, rezulton edhe në zbatim të nenit 15 të Ligjit "Për partitë politike", PDSH legjitimohet në paraqitjen e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar për rregjistrimin e ndryshimeve statutore pikërisht për këtë subjekt politik.

Së dyti, Gjykata e Apelit vlerëson se nënkryetari i PDSH z. Enkelejd Alibeaj pajisur me autorizim nga Kryetari i PDSH, gëzon legjitimim procedural në përfaqësimin e ankuesit PDSH në gjykim, ashtu edhe legjitimim procedural në paraqitjen dhe nënshkrimin e aktit "Ankim" të ushtruar ndaj vendimit nr. 3, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 92 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Personat juridikë marrin pjesë në gjykim me anë të atij që i përfaqëson, sipas dispozitave ligjore."

Neni 96/c të Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Si përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë: c) juristët dhe punonjësit e tjerë ***të autorizuar*** *të institucioneve shtetërore ose* ***të personave juridikë;"***

Kodi i Procedurës Civile përcakton rregullin e përgjithshëm të përfaqësimit të një personi juridik. Referuar këtij percaktimi që realizojnë nenet 92 dhe 96/c i K.P.C. rezulton se edhe pse personi juridik operon përmes organeve të tij, jo çdo organ i tij mund ta përfaqësojë atë në gjykim, por vetëm ai organ që *sipas legjislacionit në fuqi* ka të drejtë ta përfaqësojë kundrejt të tretëve.

Personi juridik që paraqitet si palë në këtë proces PDSH është parti politike, prandaj edhe ligj i posaçëm nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" që gjen zbatim ndaj saj, ndër të tjera parashikon si vijon:

Neni 14 i Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" parashikon:
" Dispozitat e këtij ligji për rregjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në rregjistrimet e mëparshme.
Kërkesa për ndryshime në rregjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompentencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve."

Gjithashtu në nenin 9 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" parashikohet:

"Rregjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranë, e cila mban rregjistrin e partive politike. Në rregjistrin e partive politike shënohet numri rendor i rregjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, ***emri i kryetarit, shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë****, fshirjes ose mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri si dhe nënshkrimin i nëpunësit kompentent.*
Partia njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe rregjistruar atë.
Deri në datën e rregjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë sidomos thirja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike."

Nga këto dispozita, ashtu edhe nga parashikimi në nenin 14 të Ligjit, konkludohet se:

- Partia politike fiton zotësi për të përftuar të drejta dhe për të marë përsipër detyrime nga çasti i rregjistrimit të saj dhe jo nga momenti i krijimit apo themelimit të saj. Ligji i posaçëm vendos si kusht ligjor shprehimisht, faktin se partia duhet të rregjistrohet në

rregjistrin e partive politike, në mënyrë që ajo të njihet nga të tretët si person juridik. Partia politike fiton zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar nga momenti i rregjistrimit të saj sipas ligjit material dhe po ashtu zotësinë juridike procedurale për të qënë palë në gjykim dhe për vepruar sipas ligjit procedural.

- Efektet njohëse ndaj të tretëve në lidhje me partitë politike, sipas Ligjit "Për Partitë Politike", vijnë vetëm nga momenti i rregjistrimit të ndryshimit statutor apo ndryshimeve të organizimit të brendshëm të partisë në rregjistrin e partive politike, pasi janë miratuar këto ndryshime me vendim gjyqësor të formës së prerë. Nën këtë logjikë, as krijimi i Partisë dhe as ndryshimet statutore apo organizative që mund të lidhen me të, nuk njihen nga të tretët para momentit të rregjistrimit të tyre në rregjistrin e partive politike.

Referuar parashikimeve në legjislacionin e posaçëm Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", rezulton se të drejtën e paraqitjes së kërkesave në gjykatë me objekt rregjistrimin e ndryshimeve statutore të Partisë Politike, e ka ai organ, i cili ka kompetencë përfaqësimin e partisë në raport apo ndaj të tretëve. Në këtë parashikim ligjor, rezulton se *i autorizuari* nga Kryetari i Partisë së PDSH, ku ky i fundit rezulton i rregjistruar në rregjistrin e partive politike si organ përfaqësues i PDSH, ka të drejtë të paraqesë ankim në emër të PDSH ndaj një vendimi gjyqësor që prek drejtëpërdrejtë të drejtat dhe interesat ligjore të PDSH.

Vërtetohet nga provat në dosje, konkretisht "Vërtetim" datë 06.04.2022 të Zyrës së Rregjistrit të Partive Politike, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar bazuar në Rregjistrin e Partive Politike, se PDSH ka kryetar të saj të rregjistruar z. Lulzim Basha. Rezulton se rregjistrimet statutore në rregjistrin e partive politike për subjektin PDSH kanë identifikuar si organ përfaqësues ndaj të tretëve për PDSH Kryetarin e saj z. Lulzim Basha. Nuk u vërtetua në gjykim të jetë rregjistruar në rregjistrin e partive politike ndonjë rregullim i ri statutor që të ketë sjellë ndryshim në drejtim të organit të përcaktuar si përfaqësues për PDSH ndaj të tretëve.

Nuk u vërtetua në gjykim që Kryetari i Partisë z. Lulzim Basha të ketë dhënë "dorëheqjen" nga detyra e Kryetarit të PDSH, ndryshe nga sa u prapësua nga "kërkuesi". Sipas "kërkuesit" PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është "fakt i njohur botërisht" se z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen më datë 21.03.2022. Për të vlerësuar bazueshmërinë e këtij prapësimi, Gjykata i referohet institutit ligjor të "faktit të njohur botërisht" në raport me standartin e provueshmërisë që duhet të ketë kjo rrethanë konkrete e pretenduar në gjykimin civil, "dorëheqja e kryetarit", referuar natyrës juridike të saj, rregullimeve që përcakton ligji i posaçëm "Për Partitë Politike" dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 13 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: *"Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen. Faktet, për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga pala në dobi të së cilës është prezumimi."*

"Dorëheqja e kryetarit të partisë" është rrethanë apo ngjarje e cila, materializohet në momentin që ajo formalizohet me një akt të shkruar dhe të pajisur me nënshkrimin e Kryetarit të partisë, si element ky i fundit autentifikues dhe i vërtetësisë së tij. Ky akt do të duhet t'i nënshtrohet verifikimit, si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Ndërkohë "fakti i njohur botërisht" përbën atë kategori ngjarjesh fenomenesh natyrore apo njerëzore, ndodhia dhe përmbajtja e të cilave, kursesi nuk konsiston dhe as barazohet me prodhimin e një akti shkresor, privat apo zyrtar. "Dorëheqja" është një fakt, i cili ndodh dhe zhvillohet vetëm përmes realizimit të një akti shkresor, që përcjell një përmbajtje të tillë, vërtetësia dhe vlefshmëria juridike e të cilit, do të duhet të vlerësohet si në përmbajtje ashtu edhe në formë.

Nuk rezulton gjithashtu që në rregjistrin e partive politike për subjektin PDSH të jetë rregjistruar ndonjë akt dorëheqje të kryetarit të partisë z. Lulzim Basha, i tillë që të ketë sjellë efekte juridike ndaj të tretëve, duke përfshirë këtu edhe gjykatën.

Nga sa më sipër, bazuar në nenet 12, 13, 246 dhe 253 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se "dorëheqja e kryetarit të partisë" mund të provohet proceduralisht në gjykimin civil vetëm përmes "provës shkresore" dhe nuk mund të vlerësohet në statusin e "faktit të njohur botërisht", pasi informacioni që mund të përcillet botërisht nuk arrin të prodhojë efektet juridike të provueshmërisë dhe vlefshmërisë ligjore të këtij fakti juridik, provueshmëria dhe vlefshmëria e të cilit ndjek rregullat e posaçme të përcaktuara në ligjin e posaçëm "Për partitë politike" dhe që lidhen me rregjistrimin e domosdoshëm të aktit të dorëheqjes në rregjistrin e partive politike (nenet 9 dhe 14 të Ligjit). Vetëm prova shkresore sipas nenit 246 dhe 253 e vijues të K.P.C. mund të shërbejë për provueshmërinë e faktit "të dorëheqjes së kryetarit të partisë" në gjykimin civil, referuar klasifikimit të provave sipas K.P.C. në zbatim të kuptimit ligjor që mer ky fakt juridik sipas kërkesave ligjore të Ligjit të posaçëm "Për partitë politike", që lidhen me rregjistrimin e tij në rregjistrin e partive politike, si momenti juridik nga ku akti fillon të prodhojë dhe sjellë efekte juridike edhe ndaj të tretëve, përfshi këtu edhe gjykatën.

Neni 253 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar."

Neni 254 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Aktet zyrtare që dalin nga organet shtetërore dhe që përmbajnë një urdhër, një vendim ose çdo masë tjetër të marrë prej tyre ose që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm ku pretendohet se shkresa është e falsifikuar."

Neni 255 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"Kopjet dhe shkurtimet e akteve të përmendura në nenet 253 dhe 254, të vërtetuara sipas ligjit, kanë fuqi provuese sikundër edhe origjinali."

Në rastin konkret, ***vërtetimi i lëshuar nga rregjistri partive politike***, përbën prove shkresore të llojit "akt zyrtar" me fuqi të plotë provuese për të vlerësuar prapësimin e paraqitur nga "kërkuesi" PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit në lidhje me dorëheqjen e kryetarit z. Lulzim Basha. "Vërtetim" datë 06.04.2022 i Zyrës së Rregjistrit të Partive Politike pranës Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar bazuar në Rregjistrin e Partive Politike, rezulton të jetë akti me fuqi të plotë provuese që u paraqit në gjykim dhe që vërtetoi se kryetari aktual i PDSH njohur nga të tretët për efekt dhe zbatim të Ligjit "Për partitë politike" të PDSH është z. Lulzim Basha. Kundër këtij akti zyrtar nuk u paraqit asnjë provë tjetër me fuqi të njëjtë provuese që të kundërshtonte këtë fakt. PDSH e përfaqësuar nga Komisionin i Përkohshëm i Rithemelimit nuk paraqiti asnjë provë shkresore zyrtare me fuqi provuese për të vërtetuar prapësimin e saj për "dorëheqjen e kryetarit të partisë z Lulzim Basha" sipas kuptimit ligjor që mund të ketë ky fakt juridik referuar Ligjit të posaçëm për "Për partitë politike".

Gjithashtu, Vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka disponuar për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të Kuvendit Kombëtar të datës 11 Dhjetor 2021, ku përfshihet edhe përcaktimi i Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit, si organ drejtues i përkohshëm i partisë, nuk është vendim gjyqësor i formës së prerë dhe as nuk është rregjistruar në rregjistrin e partive politike, si i tillë ai nuk ka arritur të krijojë ndonjëherë efektet juridike të synuara në dispozitivin e tij.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, rezulton se nënkryetari i Partisë z. Enkelejd Alibeaj është "i autorizuari" nga kryetari i PDSH për realizimin e përfaqësimit të PDSH në proceset gjyqësore ku palë është PDSH. Autorizimi i datës 15.09.2021 rezulton të mos jetë revokuar. Gjykata gjithashtu vendos në dukje se autorizimi i datës 15.09.2021 është akt që lidhet vetëm me përfaqësimin e PDSH në proceset gjyqësore dhe në ndërmarjen e akteve apo veprimeve procedurale në gjykime. Tagrat e njohura të përfaqësimit rezultojnë të jenë të përgjithshme, pra për të gjitha proceset gjyqësore, duke përmbushur kështu kriteret ligjore sipas nenit 92 të K.P.C.

Së treti, në vlerësimin që Gjykata e Apelit realizon në lidhje me pranueshmërinë e ankimit të PDSH, sipas kritereve ligjore që renditen në nenin 450/1 të K.P.C., rezulton se nuk evidentohen shkaqe të tjera ligjore nga ato që mund të shkaktojnë papranueshmëri të ankimit, përtej "legjitimimit" të ankuesit, që u analizua më lart.

Neni 450 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:
"1. Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin, në dhomë këshillimi, menjëherë pas paraqitjes së ankimit, vendos mospranimin e ankimit kur:
a) është paraqitur jashtë afatit;
b) nuk ndreqen të metat në afatin e caktuar sipas nenit 455 të këtij Kodi;
c) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim;
ç) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;
d) është hequr dorë nga ankimi.
2. Kundër vendimit të mospranimit të ankimit mundet të bëhet ankim i veçantë.
3. Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi."

Neni 450 i K.P.C. referon në nenin 455, dhe ky i fundit referon edhe në nenet 453 dhe 454 të K.P.C., në të cilët respektivisht parashikohet se:

Neni 453 i Kodit të Procedurës Civile:
"Nënshkrimi i ankimit
Ankimi që i drejtohet gjykatës së apelit duhet të nënshkruhet nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi i pajisur me prokurë."

Neni 454 i Kodit të Procedurës Civile:
"Përmbajtja e ankimit
Në ankim duhet të tregohen: a) palët ndërgjyqëse; b) vendimi kundër të cilit bëhet ankimi; c) shkaqet për të cilat bëhet ankimi; ç) çfarë kërkohet me ankimin."

Neni 455 i Kodit të Procedurës Civile:
" Dokumentet që i bashkëngjiten ankimit
Bashkë me ankimin duhet të paraqiten:
a) kopje të ankimit dhe të dokumenteve të tjera, aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë;
b) prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës.
Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, si dhe ato të neneve 453 dhe 454 të këtij Kodi, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet."

Konkretisht rezulton se:

- Ankimi ndaj vendimit nr. 3, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur brenda afatit ligjor për ankimimin e vendimit, të përcaktuar në nenin 15 të Ligjit "Për partitë politike". Vendimi i ankimuar është shpallur më datë 25.03.2022, ndërsa ankimi i PDSH ndaj tij është rregjistruar më datë 04.04.2022, pra brenda afatit 15 ditor, referuar parashikimit në nenin 15 të Ligjit "Për partitë politike".

- Nuk rezulton që ankimi të ketë të meta, referuar parashikimeve në nenet 453, 454 dhe 455 të Kodit të Procedurës Civile. Ankimi është paraqitur i nënshkruar nga personi i autorizuar nga Kryetari i Partisë PDSH si më sipër analizuar, ashtu sikurse është i pajisur me vulën e personit juridik PDSH, konfiguracioni i së cilës është ai i rregjistruar në rregjistrin e partive politike. Në ankim identifikohen elementët e përmbajtjes sipas nenit 454 të K.P.C. Bashkëlidhur ankimit është autorizimi i datës 15.09.2021 i Kryetarit të PDSH, ashtu edhe aktet e tjera provuese në mbështetje të tij, të cilat janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit që i përket vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka disponuar në shkallë të parë për "pranimin e ankimit të PDSH".

- Ankimi është ushtruar ndaj një vendimi për të cilin lejohet ankim, sikurse më sipër u analizua. Neni 15 i Ligjit "Për partitë politike" parashikon se: "***Vendimi i Gjykatës për rregjistrimin*** *apo mosrregjistrimin* ***e partive politike në rregjistrin e partive politike mund të ankimohet*** *në gjykatën e apelit të Tiranës, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit*" duke cilësuar shprehimisht si të ankimueshëm edhe vendimin për rregjistrimin në rregjistrin e partive politike.

- Ankimi është paraqitur nga personi juridik PDSH, i vetmi person juridik në gjykim, përfaqësuar ky i fundit në ankim nga organi që ka kompentencën e përfaqësimit të PDSH ndaj të tretëve referuar në nenin 14 të Ligjit "Për partitë politike" dhe nenit 92 të K.P.C.

- Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, në cilësinë e pretenduesit për përfaqësues të PDSH, parashtroi se ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga ankimi i PDSH ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo kërkesë në vlerësimin e Gjykatës së Apelit nuk arrin të sjellë efektet juridike që ka synuar në përmbajtjen e saj, për sa rezulton të mos jetë formuluar dhe paraqitur nga përfaqësuesi që ka paraqitur edhe ankimin. Ankimi është paraqitur Kryetari i Partisë në emër të PDSH cilësi përfaqësimi e pretenduar sipas nenit 14 të Ligjit "Për partitë politike", ndërsa konstatohet se kërkesa për heqjen dorë nga ankimi nuk është produkt i vullnetit të këtij organi.

Konstatohet në përfundim, se ankimi ka përmbushur gjithashtu kriteret ligjore për pranueshmërinë e tij, sipas përcaktimit të nenit 450/1 të Kodit të Procedurës Civile.

5.2.2. Mbi shqyrtimin në themel të ankimit

Gjykata pasi u njoh me përmbajtjen e ankimit dhe apelit kundërshtues, vlerësoi shkaqet ligjore të parashtruara në to, provat e administruara dhe vendimin objekt ankimimi, konkludon se vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është disponuar në kushtet e shkeljeve procedurale, si i tillë ai duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rigjykim pranë gjykatës së shkallës së parë me tjetër trup gjykues.

Me fillimin e shqyrtimit në themel të ankimit, Gjykata e Apelit verifikon fillimisht kryesisht "*ex officio*" ekzistencën e mundshme të shkaqeve ligjore që pasjellin pavlefshmërisë absolute të vendimit të gjykatës së shkallës së parë objekt ankimi. Shkaqet ligjore që mund të shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, përbëjnë shkelje të dispozitave procedurale apo gabime në procedim. Për jo çdo gabim procedural pasjell pavlefshmërinë absolute të vendimit përfundimtar. Do të cilësohen të tilla vetëm ato gabime në procedim të asaj rëndësie, për të cilat ligjvënësi në mënyrë të shprehur ka parashikuar pasojën procedurale të prishjes së vendimit të ankimuar, gjithmonë e vlerësuar kjo në kufijtë e nenit 121 të Kodit të Procedurës Civile. Identifikimin i këtyre shkaqeve ligjore që mund të çojnë në prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, realizohet në nenin 467 të Kodi i Procedurës Civile ku parashikohet se:

"Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:
a) gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën;
b) përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt ose vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij, ose është cenuar parimi i paanësisë;
c) gjykata e shkallës së parë ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod;
ç) çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin;
d) nuk është formuar drejt bashkëndërgjyqësia, sipas nenit 162, paragrafi i dytë, i këtij Kodi;
dh) kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit;
e) gjykata e shkallës së parë nuk e ka kryer shqyrtimin gjyqësor të të gjitha kërkimeve lidhur me objektin e mosmarrëveshjeve."

Konkretisht Gjykata e Apelit në lidhje me vendimin objekt ankimi nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konstaton se:

Së pari, vendimi i ankimuar nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendim, i cili është disponuar në **shkelje të parimit të paanësisë**, rrethanë procedurale kjo e cila sipas nenit 467/b të K.P.C. pasjell pavlefshmërinë absolute të vendimit gjyqësor.

Nga provat në dosje rezulton se:

- Gjyqtari i caktuar me short në shqyrtimin e çështjes civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi pranë Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar këto rrethana: "*Unë gjyqtari Agron Zhukri pasi mora çështjen nga shorti dhe u njoha me palët ndërgjygjëse konstatova se: Me datën 26.12.2018 kam paraqitur dorëheqjen time nga gjykimi i çështjes me palë: Paditës: Edi Rama; I paditur: Sali Berisha; Objekt: Shpërblim dëmi; Meqënëse përfaqësuesi im dhe i familjes time me prokure të posaçme, është studio ligjore "KASO &Associates" sh.p.k, me administrator dhe perfaqesues av.z. Oljon Kaso, i cili është vëllai i përfaqesuesit të kërkuesit P.D.SH z. Ivi Kaso, jam në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin e kësaj çështje. Gjithashtu duke bërë prezent faktin publik që bashkëshortja ime Rezarta Zhukri (Kushi), ka punuar për një periudhë të gjatë me të paditurin z. Sali Berisha, fillimisht si Sekretare personale dhe Shefe e Administratës, duke qene njëkohësisht edhe anëtare e Partisë Demokratike dhe është në marrëdhënie të ngushta miqësie. Për të njëjtën arsye në vitin 2004, jam përjashtuar nga shorti për një padi civile ndërmjet ish Kryeministrit Fatos Nano dhe liderit te opozites Z. Sali Berisha, fakt i njohur. Këtë kërkesë Kryetarja e Gjykatës në atë kohë Znj. Enkelejdi Hajro e ka pranuar. Në këto kushte çmoj se në bazë të nenit 72/6 te K.Pr. Civile, kërkoj heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje dhe hedhjen në short të saj. Bashkëngjitur: Prokura e posacme, Kërkesa dhe Vendimi i pranimit të kërkesës për heqje dorë në gjykimin e sipërcituar*"

- Kërkesa e gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes është shoqëruar me prova shkresore në mbështetje të rrethanave të parashtruara në të, konkretisht aktet: Prokura e posaçme nr. 3910 rep, nr. 1313 kol datë 11.11.2021 ku rezulton se gjyqtari i çështjes i kalon tagra përfaqësimi studios ligjore "Kasso& Associates" sh.p.k., Kërkesa për heqje dorë e gjyqtarit e datë 26.12.2018 dhe Vendimi i pranimit të kërkesës për heqje dorë të gjyqtarit të datës 26.12.2018 të disponuar nga Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështje tjetër civile me palë ndërgjyqëse z. Sali Berisha.

- Me vendimin datë 20.12.2021 Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur në lidhje me kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi të gjyqtarit për: *"Mospranimin e kërkesës së gjyqtarit Agron Zhukri për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështje dhe vazhdimin e gjykimit të saj nga i njëjti gjyqtar."* Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi përcaktohet: *" Gjyqtar Agron Zhukri ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje me arsyetimin se përfaqësuesi i tij dhe i familjes së tij është studio ligjore "Kaso& Associates" sh.p.k. administrator i së cilës është vëllai i përfaqësuesit me autorizim në këtë çështje. Gjithashtu gjyqtari më datë 26.12.2018 ka paraqitur dorëheqjen nga gjykimi i çështjes me palë paditëse: Edi Rama dhe të paditur: Sali Berisha me objekt "Shpërblim dëmi" me arsyetimin se bashkëshortja e tij ka punuar më parë me palën e paditur. Sa më sipër pretendimi se i është pranuar më parë dorëheqja nuk mund të qëndrojë pasi çështjet janë të ndryshme dhe vlerësoj se kërkesa e gjyqtar Agron Zhukri për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështje nuk mund të pranohet, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet e bazuara në nenin 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile."*
- Nga provat e paraqitura në gjykim nga "kërkuesi" rezulton se anëtar i Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit është edhe z. Sali Berisha.
- Nga përmbajtja e ankimit të veçantë ndaj vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të PDSH përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit përftohet ky pohim gjyqësor: *"është fakti botërisht i njohur që Komisioni i Rithemelimit, ka në përbërjen e tij dhe identifikohet në opinionin publik me ish-Kryetarin e Partisë Demokratike, z Sali Berisha, nje personalitet politik, i cili për një kohë të gjatë ka qënë në qendër të vëmendjes mediatike në kuadër të shkëmbimit të akuzave të ndërsjellta publike me bashkëshortin e Gjyqtares B. M., kur ky i fundit ka mbajtur pozicione publike, çka e vendos gjyqtaren në kushtet e parashikuara nga neni 72/pika 3 i K.Pr.Civile "kur ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në një konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve ose njërin prej përfaqësuesve"*

Neni 467/b të K.P.C. parashikon: *"Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:* ***b)*** *.... ose* ***është cenuar parimi i paanësisë;"***

"Parimi i paanësisë" si parakusht dhe aspekt substancial i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të K.E.D.NJ, është përcaktuar në mënyrë dinamike nga standartet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: *"2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër*

*tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e **paanshme** e caktuar me ligj".*

Neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikon: *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e **paanshme**...".*

Gjykata e Europiane e të Drejtave të Njeriut, në lidhje me nocionin e Konventës *"Gjykatë e paanshme"* apo "parimi i paanësisë në gjykim", shprehet se:

- *"Gjykata kujton se ka dy aspekte të kërkesës për paanshmëri në nenin 6 § 1. Së pari, gjykata duhet të jetë **subjektivisht e paanshme**, domethënë, **asnjë anëtar i gjykatës nuk duhet të ketë ndonjë paragjykim personal apo të anshëm. Paanësia personale prezumohet nëse nuk ka prova për të kundërtën.** Së dyti, gjykata duhet të jetë gjithashtu e paanshme nga **pikëpamja objektive, domethënë, ajo duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt** (shih, ndër të tjera, aktgjykimin Fey kundër Austrisë, datë 24 shkurt 1993, Seria A nr. 255, f. 12, § 28). ..... **Sipas testit objektiv, duhet të përcaktohet nëse, përveç sjelljes personale të gjyqtarëve, ka fakte të konstatueshme që mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e tyre.** Në këtë aspekt edhe paraqitjet mund të kenë një rëndësi të caktuar. Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik dhe mbi të gjitha te palët në proces." **(Çështja Academy Trading Ltd dhe të tjerë kundër Greqisë 04.04.2000)***

- *"Gjykata rithekson se çështja nëse një gjykatë është e paanshme për qëllimet e nenit 6 § 1 të Konventës duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv, që është në bazë të bindjes personale të një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar, dhe gjithashtu sipas një testi objektiv, pra duke konstatuar nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim (shih Ëettstein kundër Zvicrës, nr. 33958/96, § 42, GJEDNJ 2000-XII). Sa i përket testit subjektiv, paanësia personale e një gjyqtari duhet të prezumohet derisa të ketë prova për të kundërtën (shih Ëettstein, cituar më lart, § 43). Sipas testit objektiv, duhet të përcaktohet nëse, përveç sjelljes personale të gjyqtarit, ka fakte të konstatueshme që mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e tij. **Në këtë aspekt edhe paraqitjet mund të kenë një rëndësi të caktuar.** Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik. Prandaj, **çdo gjyqtar në lidhje me të cilin ka një arsye legjitime për t'u frikësuar nga mungesa e paanësisë duhet të tërhiqet.** Kjo nënkupton që për të vendosur nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye legjitime për t'u frikësuar se një gjyqtari i caktuar i mungon paanshmëria, **qëndrimi i palës në fjalë është i rëndësishëm,** por jo vendimtar. **Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet objektivisht e justifikuar** (shih Ëettstein, cituar më lart, § 44)." **(Çështja Indra kundër Sllovakisë datë 01.05.2005)***

- *"Kur paanshmëria e një gjykate për qëllimet e nenit 6 para. 1 (neni 6-1) është duke u përcaktuar, duhet pasur parasysh jo vetëm bindjen personale të një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar - qasja subjektive - por edhe nëse ai ka dhënë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim - qasja objektive* ***(Çështja Piersack kundër Belgjikës të 1 Tetorit 1982, Çështja Bulut kundër Austrisë datë 22.02. 1996)***

- *"Ky nocion lidhet me paanësinë subjektive dhe objektive dhe lidhur me paanësinë objektive, ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që gjyqtari kryen gjatë procesit gjyqësor."* ***(çështja Gautrin kundër Francës datë 20.05.1998 dhe Fey kundër Austrisë datë 24.02.1993)***

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në jurisprudencën e saj të konsoliduar në lidhje me "paanësinë" përcakton:

- *"Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues që nuk jep garancitë e nevojshme për një gjykim të paanshëm në këndvështrimin objektiv."* (Vendimi Nr. 115, datë 21.09.2022 i Gjykatës Kushtetuese)

- *"Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre.* ***Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur.*** *E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që* ***drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet.*** *Në kuptim të nenit 42, pika 2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste,* ***testin subjektiv,*** *i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu,* ***testin objektiv,*** *i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim.* ***Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi.*** *Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm.... Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë*

demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (shih vendimet nr.6, datë 02.03.2018; nr.46, datë 19.07.2016; nr.49, datë 10.07.2015; nr.21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese)." (Vendimi nr. 49, datë 10.07.2015, vendimi nr.10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

- *"Parimi i paanshmërisë ka në vetevete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si* ***dhe me elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë Gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.***" (Vendimi Nr. 12, datë 13.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese)

Ligji procedurial parashikon mjete ligjore për të siguruar zhvillimin e një gjykimi të paanshëm, mjete të cilat do të duhet të ushtrohen *efektivisht* për të pasjellë garantimin e mos-cënimit të parimit të paanësisë. Ndër këto mjete ligjore renditen:

a) Kërkesa për "heqjen dorë nga gjykimi" që realizon vetë gjyqtari duke e paraqitur pranë Kryetarit të Gjykatës për vlerësim, kërkesë e cila mund të ushtrohet për secilën nga tre kategoritë e shkaqeve si më poshtë cituar: a) rrethanat e parashikuara në nenet 72 dhe 73 Kodin e Procedures Civile; b) në rast të krijimit të perceptimit apo dyshimeve rreth paanësisë se trupës gjykuese në gjykim sipas përcaktimeve të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së; c) në rast të prezencës së rrethanave të konfliktit të interesit parashikuara në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit".
b) Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Shkaqet ligjore për të cilat mund të përjashtohet një gjyqtar nga shqyrtimi i çështjes lidhen me tre kategoritë e shkaqeve si më sipër cituar.

Rezulton se edhe pse "paanësia në gjykim" referohet në Kodin e Procedurës Civile si kriter procedural që çon deri në pavlefshmëri absolute të vendimit përfundimtar, kuptimi i saj nuk përkufizohet dhe nuk elaburohet më tej në Kod në *kriteret e saj përbërëse*, mbi bazën e të cilave të mund të vlerësohet paanësia në kuptim të kompozimit të trupës gjykuese që shqyrton një çështje të caktuar. Këto kritere vlerësimi janë elaburuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, duke u bërë pjesë përbërëse e neneve 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, norma me epërsi juridike ndaj Kodit të Procedurës Civile në zbatim të nenit 116 të Kushtetutës. Këto kritere të elaburuara nga jurisprudenca e GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese përbëjnë përcaktim dhe gjejnë aplikim edhe mbi kuptimin procedural të "paanësisë" në lidhje me kompozimin e trupës gjykuese, të tilla që duhet të respektohen në çdo shkallë të gjykimit në zbatim të Kodit të Procedures Civile apo Penale. Mbi bazën e këtyre kritereve GJEDNJ apo Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar rast pas rasti, nëse përbërja e trupës gjykuese që ka zhvilluar

gjykimin e çështjes ka cënuar paanësinë, duke u evidentuar nëse trupa gjykuese ka pasur ose jo detyrimin për t'u dorëhequr nga gjykimi i çështjes. Gjyqtari do të vlerësohet i paanshëm në rast se paanësia rezulton e garantuar nga rezultatet e njëkohshme të të dyja testeve, atij objektiv dhe subjektiv, mungesa e garantimit qoftë edhe sipas njërit prej tyre, passjell cënim të paanësisë nga përbërja e trupës gjykuese.

Cënimi i parimit të paanësisë, vlerësohet jo vetëm në raport me gjyqtarin e çështjes, pra në lidhje me veprimet apo mosveprimet e tij në kuadër të procesit gjyqësor apo jashtë tij, por vlerësohet edhe në raport me vendimarjen e Kryetarit të gjykatës në lidhje me kërkesën për dorëheqjen nga gjykimi të gjyqtarit, ashtu edhe në raport me vendimin mbi kërkesën për përjashtim trupi gjykues, si vendim, i cili është ndër të tjera është sh.prehimisht i përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile si i ankimueshëm së bashku me vendimin përfundimtar (neni 75[1] i K.P.C.) Kriteret e vlerësimit mbi paanësinë e përbërjes së trupës gjykuese, të përcaktuara nga Gjykata Kushtutuese dhe GJEDNJ, janë kritere të detyrueshme për zbatim në çdo shkallë gjykimi, si nga gjyqtari i çështjes, ashtu edhe nga subjektet procedurale në vlerësimin që realizojnë për kërkesat për heqjen dorë nga gjykimi apo për përjashtim trupe gjykuese.

Në rastin konkret objekt shqyrtimi Gjykata e Apelit vlerëson se:

- Evidentohen shkaqe papajtueshmërie në shqyrtimin e çështjes civile nga trupa gjykuese që e ka shqyrtuar atë në shkallë të parë. Kjo papajtueshmëri nuk ka mbetur në nivelin deklarativ nga ana e gjyqtarit, por është provuar me prova shkresore të paraqitura prej tij bashkëlidhur kërkesës për heqjen dorë. Shkaqet e parashtruara në themel të kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi, janë të tilla që pamundësojnë respektimin dhe garantimin e parimit të paanësisë si nën testin objektiv ashtu edhe në testin subjektiv të saj. Shkaqet e parashtruara në themel të kërkesës për heqje dorë, janë të natyrës së tillë që e bëjnë të pamundur për cilindo vëzhgues objektiv perceptimin si paanshëm të çfarëdolloj vendimi që do të dispononte trupa gjykuese në përfundim të gjykimit, pavarësisht përpjekjeve të saj për t'u perceptuar e paanshme dhe ruajtjes së një niveli sa më bindës në arsyetimin e vendimit gjyqësor.

- Rëndësi ligjore mbart gjithashtu fakti se vetë trupa gjykuese që ka shqyrtuar çështjen, në kërkesën për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, me ndërgjegje ka vlerësuar se ka

[1] Neni 75 i K.P.C. parashikon: "*Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në dhomë këshillimi nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.*"

shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, kompetencë të cilën e ka ushtruar në zbatim me nenin 73[2] të Kodit të Procedurës Civile.

- Në vlerësimin e Gjykatës së Apelit, vendimi i Kryetarit të gjykatës për mospranimin e kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, është i paarsyetuar dhe paargumentuar në raport me parashkimet e Kodit të Procedurës Civile, nocionin e parimit kushtetues dhe konventor të paanësisë, si dhe në raport me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit". Vlera juridike e vendimit të Kryetarit të Gjykatës për pranimin ose refuzimin e kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi, *është ajo e një vendimi gjyqësor*, pasi përbën akt disponimi në emër të forumit gjyqësor (Gjykatës) i njohur dhe rregulluar shprehimisht nga Kodi i Procedurës Civile, i cili sjell të njëjtat efekte juridike sikurse vendimi gjyqësor për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim trupi gjykues. Të dyja këto procese, si shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga kryetari i gjykatës, ashtu edhe shqyrtimi i kërkesës për përjashtim gjyqtari, janë mjete ligjore që kanë të njëjtin status procedural ligjor të njohur nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe që sjellin të njëjtat efekte juridike. Në të njëjtën logjikë, pranimi i kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi, pasjell pushimin e gjykimit të kërkesës për përjashtim gjyqtari. Të dyja aktet, cilesohen vendime të ndërmjetme, të cilat janë të kontrollueshme nga gjykatat më lartë së bashku me vendimin përfundimtar, përcaktim ky që buron nga parashikimi në nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile. Si i tillë edhe vendimi i Kryetarit të Gjykatës për pranimin ose rrëzimin e kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi, duhet të jetë i arsyetuar dhe i bazuar në legjislacionin në fuqi, duke kryer shqyrtimin dhe argumentimin në lidhje me të gjitha rrethanat dhe kërkimet e parashtruara në kërkesën e gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi. Mungesa e arsyetimit apo mungesa e bazueshmërisë së këtij vendimi në raport me legjislacionin në fuqi, përbën shkak për ta cilësuar atë si një mjet jo-efektiv në drejtim të respektimit dhe garantimit të parimit të paanësisë, duke pasjellë cënimin e këtij parimi sipas kuptimit të nenit 467/b të K.P.C.

- Vendimi nr. 191 regj. themeltar datë 04.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka disponuar mbi kërkesën për përjashtimin e trupës gjykuese, nuk rezulton të ketë vlerësuar në themel shkaqet e papajtueshmërisë së trupës gjykuese në shqyrtimin e çështjes. Vendimi nr. 191 rregj them, datë 04.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rrëzuar kërkesën për përjashtim trupi gjykues me argumentimin se: "*Gjykata konstatoi se kerkuesi Partia Demokratike e Shqiperise e përfaqësuar nga Kryetari i PDSH-së Z. Lulzim*

[2] Neni 73 i K.P.C. parashikon: *"Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit."*

Basha nuk eshte pale ne procesin civil Nr.1346/2021 ku si pale kerkuese ne kete proces eshte Komisioni i Perkohshem i Rithemelimit te P.D. per pasoje nuk legjitimohet ne ngritjen e kesaj kerkese per perjashtimin e gjyqtarit Agron Zhukri, nga shqyrtimi i çeshtjes Nr.1346/2021". Duke pasur ky vendim, cilësinë e vendimit të ndërmjetëm në kuadër të procesit gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas përcaktimit në nenin 75 të K.P.C., dhe mos pasur kursesi efektin "gje e gjykuar" ndryshe nga sa prapësoi kërkuesi në gjykim, ky vendim i nënshtrohet kontrollit nga gjykata më e lartë edhe "ex officio" në drejtim të verifikimit të dhënies së garancive të duhura dhe efektive në respektimin e "parimit të paanësisë" në kuptim të nenit 467/b të K.P.C. në raport me ndikimin që ka pasur në dhënien e vendimit përfundimtar objekt ankimi. Gjykata e Apelit konstaton se me vlerësimin që gjykata e shkallës së parë ka realizuar me këtë vendim, nuk është garantuar efektivisht respektimi i "parimit të paanësisë". Rezulton se gjykata e shkallës së parë në këtë vendim nuk ka trajtuar kërkimet dhe shkaqet e parashtruara nga kërkuesi në kërkesën për përjashtimin e trupës gjykuese. Si i tillë ky vendim nuk rezulton të ketë pasur pozitën e një mjeti efektiv në garantimin e respektimit të parimit të paanësisë në raport me vendimarjen përfundimtare objekt ankimimi.

- Evidentohet prezenca e një standarti të dyfishtë të vlerësimit të të njëjtave shkaqe për "dorëheqjen nga gjykimi" të gjyqtarit, nga kryetarë të ndryshmë të gjykatës, ku ndërsa më parë këto kërkesa janë pranuar, rezuton se kërkesa e datës 20.12.2021 për çështjen objekt shqyrtimi nuk është pranuar. Nuk evidentohet asnjë shkak objektiv, sikurse do të ishte ndryshim legjislativ apo ndryshim në jurisprudencë, i tillë që të ligjëronte ndryshimin e vlerësimit prej kryetarit të gjykatës të të njëjtave shkaqe për dorëheqje nga gjykimi për të njëjtin gjyqtar. Ndryshimi i kryetarëve të gjykatës nuk është shkak objektiv që ligjeron ndryshimin e vlerësimit të shkaqeve për dorëheqje, kur ndërkohë rezulton të ketë precedente të mëparshëm në lidhje me të njëjtat shkaqe e aq më tepër në lidhje me të njëjtin gjyqtar.

- Gjithashtu, ndryshe nga sa parashtron Kryetari i Gjykatës në vendimin për mospranimin e kërkesës së gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi, gjyqtari është ndodhur para të njëjtit shkak që krijon papajtueshmëri në gjykim dhe që ka ekzistuar për të edhe në çështjet e mëparshme ku ai është përjashtuar nga gjykimi. Ndërsa në gjykimet e msparshme palë në proces ka qënë z. Sali Berisha, rezulton se edhe në raport me gjykimin aktual z. Sali Berisha është anëtar i Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit dhe identifikohet në opinionin publik si ish-Kryetar i PDSH. Ndërkohë trupa gjykuese në kërkesën për dorëheqje nga gjykimi gjithashtu ka bërë me dije se bashkëshortja e tij është: (i) anëtare e PDSH; (ii) ka qënë në marrëdhënie pune me z. Sali Berisha si Sekretare Personale dhe

Shefe e Administratës së tij; (iii) duke u pohuar gjithashtu nga gjyqtari marrëdhënie të ngushta miqësie mes bashkëshortes së tij dhe z. Sali Berisha.

- Përveç shkakut që ka ekzistuar edhe në çështje të mëparshme, trupa gjykuese në kërkesën e saj për dorëheqje nga gjykimi, ka evidentuar edhe një rrethanë tjetër që krijon papajtueshmëri dhe cënon dukshëm parimin e paanësisë, konkretisht faktin se gjyqtari personalisht ka një (iv) marrëdhënie përfaqësimi me prokurë me studion ligjore të avokatisë së vëllait të përfaqësuesit të kërkuesit, z. Ivi Kaso. Ky i fundit rezulton jo vetëm të jetë paraqitur si përfaqësues i kërkuesit, por rezulton të jetë edhe anëtar i Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit.

- Të vlerësuara këto rrethana në raport me parashikimet ligjore në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit", rezulton se konfirmohet prezenca e konfliktit të interesit privat, që ka mbartur trupa gjykuese personalisht dhe personi i lidhur me të bashkëshortja e tij, në raport me detyrën publike, ushtrimi i funksionit të gjyqtarit në gjykimin e çështjes civile. Konkretisht katër rrethanat e sipërcituara të parashtruara nga trupa gjykuese si shkaqe për heqjen dorë nga gjykimi, gjejnë klasifikim sipas nenit 5/1/ b dhe 5/1/dh/v të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit", në të cilin parashikohet se: *"Interesat private të zyrtarit janë interesa për përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: b) **nga çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; dh) marrëdhënie** ...v) **të njohura të miqësisë** apo armiqësisë"*. Në nenin 3/1 dhe 3/11 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit" parashikohet: *"1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike."* dhe *"11. "Person i lidhur me një zyrtar" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin."*. Në nenin 4 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit" parashikohet se: *"1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga: a) çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për: ii) akte të organeve gjyqësore, noteriale, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga organet e përmbarimit dhe akte të organeve të prokurorisë; 2.Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit; b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit; c) një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit."* Nga zbatimi sistematik i këtyre normave rezulton se ligji për parandalimin e konfliktit e interesit gjen

fushëzbatimi edhe në veprimtarinë gjyqësore. Konflikti i interesit i evidentuar në rastin konkret, gjen vend si në raport me gjyqtarin vetë ashtu edhe me personin e lidhur me të, situate kjo e cila vlerësohet se duket se ndikon në përmbushjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive publike nga ana e trupës gjykuese.

- Të vlerësuara rrethanat për papajtueshmëri më sipër evidentuar në raport me "parimin konventor dhe kushtetues të paanësisë" dhe nocionit të elaburuar prej tij nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ-ë, rezulton se: *së pari, testi subjektiv i paanshmërisë*, rezulton se vetëdeklarimi që gjyqtari ka bërë në kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi është tregues i pamundësisë së vlerësuar me ndërgjegje nga gjyqtari sipas nenit 73 të K.P.C. për të shqyrtuar çështjen në kuptimin e gjykimit subjektivisht të paanshëm. Prezumimi për paanësi subjektive apo personale bie në rastin konkret nga vetë pohimet e trupës gjykuese në kërkesën e saj për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. *Së dyti, në aspektin objektiv të paanësisë,* rezulton se me prezencën e katër shkaqeve apo rrethanave të sipërcituara të papajtueshmërisë dhe të provuara, trupa gjykuese ka qënë në pamundësi objektive për të ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në drejtim të paanësisë. Faktet që ligjërojnë dyshimin për anshmëri janë të konstatueshme, të vërtetuara me prova dhe të pohuara nga vetë trupa gjykuese përmes kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes. Vetë trupa gjykuese ka vlerësuar se ka arsye legjitime, për të cilat do të duhet të tërhiqet nga gjykimi, tre arsye prej të cilave (ato që lidhen me bashkëshorten e tij) janë vlerësuar edhe më parë të arsyeshme dhe të ligjshme nga kryetarë të gjykatës dhe pikërisht këtë pritshmëri dhe konsideratë kanë përftuar palët në gjykim më parë në lidhje me to dhe në lidhje me trupën gjykuese, duke krijuar te palët sigurinë juridike nga raste të vlerësuara dhe gjykuara më parë. Edhe vetë qëndrimi i palës PDSH, e cila ka kërkuar përjashtimin e trupës gjykuese, për të njëjtat shkaqe që janë paraqitur nga gjyqtari në kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi, mbart rëndësi në rastin konkret, pasi frika e palës për mungesë paanësie te trupa gjykuese, konsiderohet objektivisht e justifikuar në rastin konkret në provat dhe pohimet që vetë trupa gjykuese ka paraqitur në kërkesën për heqjen dorë dhe provat bashkëlidhur saj.

- Gjykata e Apelit vlerëson se trupa gjykuese është gjendur në papajtueshmëri për të zhvilluar gjykimin edhe sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, ndryshe nga sa parashtron në vendimin e tij kryetari i gjykatës për refuzimin e kërkesës për dorëheqjen nga gjykimit të gjyqtarit, pasi rrethanat e parashtruara dhe vërtetuara me prova prej trupës gjykuese: cënojnë parimin e paanësisë në aspektin objektiv dhe subjektiv të tij, duke u vlerësuar ky kusht procedural sipas kritereve të elaburuara të jurisprudencës si më sipër cituar (neni 467/b i K.P.C,), rrethanat e parashtruara kanë pasur mundësinë të krijojnë premisa objektive për arsye serioze njëanshmërie edhe sipas

kuptimit të nenit 72/6 të K.P.C., vlerësuar kjo në unitet edhe me nenin 73 të K.P.C. ku trupa gjykuese ka vlerësuar me ndërgjegje domosdoshmërinë e zëvëndësimit të saj në gjykimin e çështjes me tjetër trup gjykuese.

- Përveç prezencës objektive të shkaqeve që lidhen me trupën gjykuese të deklaruara prej saj dhe që cënojnë "parimin e "paanësisë", mbajtja e një standarti të dyfishtë të vlerësimit të të njëjtit shkak për "dorëheqjen nga gjykimi të gjyqtarit" nga kryetarë të ndryshëm të gjykatës, ku më parë në raste të tjera ky shkak është pranuar, ndërsa në kërkesën e datës 20.12.2021 në këtë çështje nuk është pranuar, ka cënuar përfundimisht në mënyrë pakthyeshme "parimin e paanësisë" ashtu dhe sigurinë juridike apo pritshmëritë e ligjshme të palëve në gjykim, të cilat nuk presin të gjykohen nga trupa gjykuese, të cilat janë vetë-deklaruar, gjykuar dhe vlerësuar më parë të papajtueshme për të gjykuar çështje me ato palë.

Cënimi që ka pësuar parimi i paanësisë, si element i procesit të rregullt ligjor, pjesë e cilit është jo vetëm gjykimi që zhvillon gjyqtari, por edhe procedura e shqyrtimit nga kryetari i gjykatës së kërkesës së tij për dorëheqje nga gjykimi ashtu edhe procedura për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, pasjell pasojën juridike procedurale të pavlefshmërisë absolute të vendimit përfundimtar objekt ankimimi, të parashikuar në nenin 467/b të K.P.C. Bazuar në nenin 467/b të K.P.C. kjo shkelje procedurale pasjell prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë.

Së dyti, shkelje tjetër procedurale e konsumuar nga gjykata e shkallës së parë, edhe pse në vetvete nuk arrin të prodhojë pasoja pavlefshmërie absolute ndaj vendimit përfundimtar nr. 3, datë 25.03.2022 është revokimi i vendimit të ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit pa ekzistuar ende kushtet ligjore për vazhdimin e gjykimit. Pavarësisht argumentimit që Gjykata e Shkallës së Parë ka aplikuar në ndërmarjen e vendimit të ndërmjetëm të pezullimit, Gjykata e Apelit vlerëson se kanë qënë kushtet ligjore për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të 11 Dhjetor 2021, derisa të gjykoheshin me vendim gjyqësor të formës së prerë vlefshmëria dhe ligjshmëria e ndryshimeve statutore të datës 17 Korrik 2021 për subjektin PDSH.

Nuk mund të pretendohet rregjistrimi i ndryshimeve të mëpasshme statutore (të mëvonshme në kohë) pa u realizuar dhe përfunduar më parë rregjistrimi i ndryshimeve të mëparshme statutore të subjektit politik në rregjistrin e partive politike. Rregjistrimi i ndryshimeve statutore në rendin kronologjik të ndodhjes së tyre, mbart në vetvete një domosdoshmëri të natyrës dhe rëndësisë logjike dhe ligjore, për vetë faktin se ndryshimet e mëpasshme statutore mbështeten më së shumti në ndryshimet më të hershme statutore. Vlefshmëria dhe ligjshmëria e ndryshimeve

statutore të mëvonshme bazohet në prezumimin ligjor, të ligjshmërisë dhe vlefshmërisë së ndryshimeve statutore më të hershme, në të cilat është bazuar ndryshimi i radhës, prezumim ligjor që zbatohet vetëm nëse ndryshimet më të hershme janë miratuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe janë pasqyruar në rregjistrin e partive politike. Kjo ndërvarësi ligjore që ka ekzistuar mes gjykimit të inicuar per rregjistrimin e ndryshimeve statutore të 17 Korrik 2021 të PDSH me gjykimin e inicuar për ndryshimet statutore të 11 dhjetor 2021, ka përcaktuar prezencën e kushteve ligjore për pezullimin e gjykimit të kësaj çështje, deri në përfundimin e shqyrtimit me vendim gjyqësor të formës së prerë të rregjistrimit të ndryshimeve statutore të datës 17 korrik 2021 për PDSH, sipas nenit 297/a të K.P.C. në të cilin parashikohet se: *"Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative."*

Kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur për revokimin e ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit të çështjes civile, vendimi gjyqësor i datës 18.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që kishte disponuar për rregjistrimin e ndryshimeve statutore të datës 17 Korrik 2021 për PDSH, ende nuk arsyetuar, për pasojë ende nuk kishte marë formë të prerë dhe as nuk ishte pasqyruar si i tillë në rregjistrin e partive politike, duke mos arritur ende të prodhonte efektet juridike të synuara në dispozitivin e tij. Rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar drejtë nenin 297/a të K.P.C., duke vijuar me gjykimin e çështjes, edhe pse ende nuk kishte rënë ende shkaku objektiv pezullues për gjykimin, duke vepruar në shkelje të kësaj dispozite.

Së fundmi, në rigjykim, Gjykata e shkallës së parë, duhet të mbajë në konsideratë faktin se ndodhemi para një gjykimi të një lloji të veçantë, i cili rezulton si i tillë për shkak të specifikave që paraqet objekti i gjykimit. Kërkesa për gjykim është ushtruar bazuar në nenin 9 të Ligjit "Për partitë politike", ku përcaktohet pasqyrimi në rregjistrin e partive politike të ndryshimeve që mund të bëjë një subjekt politik në lidhje me "konfiguracionin e vulës ose të kryetarit të partisë". Edhe pse personi juridik (subjekti i së drejtës) që paraqitet para gjykatës është një i vetëm PDSH, rezulton se përfaqësimin e saj e pretendon si Kryetari i Partisë që rezulton i regjistruar në rregjistrin e Partive Politike për PDSH duke u bazuar në nenin 14/2 të Ligjit për "Partitë Politike", ashtu edhe Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, i cili pretendon të njihet si përfaqësues i PDSH për shkak të vendimarjeve të Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021. Një situatë e tillë procedurale specifike ndodh për shkak të vetë lëndës së gjykimit, ku objekt vlerësimi janë vlefshmëria dhe ligjshmëria e vendimeve të Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021, vendimarje pjesë e cilave ka qënë edhe zgjedhja e një organi të ri drejtues të subjektit politik. Për shkak të kësaj specifike, Gjykata e Shkallës së Parë në rigjykim duhet të njoftojë si Komisionin e Përkohshëm të Rithemelimit, ashtu dhe Kryetarin e Partisë e të autorizuarit prej tyre, si dhe të ftojë ata të shprehen në lidhje me pozicionimin e tyre procedural. Më pas Gjykata e Shkallës së Parë duhet të disponojë në lidhje me to me vendim. Në këtë vlerësim si dhe në

vlerësimin në tërësi, Gjykata e Shkallës së Parë duhet të mbajë në konsideratë raportin pajtues mes normave të Kodit të Procedurës Civile dhe normave të ligjit të posaçëm nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike".

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë, duhet të mbajë në konsideratë gjithashtu administrimin e vërtetimit të përditësuar nga rregjistri i partive politike në lidhje me subjektin PDSH, ku të verifikojë sërisht të dhënat e përditësuara në lidhje me vijimin e përfaqësimit e subjektit politik nga kryetari i partisë (nga ky organ), personin që rezulton i tillë i shënuar në rregjistër, si dhe ndryshimet e fundit statutore të rregjistruara në të për këtë subjekt politik.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 466/ç dhe nenin 467/b të K.P.C. Gjykata vendos për prishjen e vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Për këto arsye:

Gjykata bazuar në nenet 450/1/c, 450/2, 467/b të Kodit të Procedurës Civile,

Vendosi:

1) Mospranimin e ankimit të ankuesit Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të ushtruar ndaj vendimit nr. 508 rregj them, datë vendimi 22.04.2022 me objekt "Disponim ankimi" të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim.
2) Prishjen e vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues.
3) Kundër këtij vendimi lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall më datë 03.03.2023

ANËTAR	ANËTARE	KRYESUESE
ASTRIT KALAJA	IRIDA KACERJA	ELONA MIHALI
d.v.	d.v.	d.v.

Vërtetohet njësia me origjinalin
K/Sekretare
Rudina Kapexhiu